

## BISEDË E PROF. CHRISTIAN VOSS DHE BELFJORE QOSES ME NIKOLA MADŽIROV



### POEZIA METAFIZIKE NË KORNIZËN BALLKANIKE DHE UNIVERSALE

#### "BOOKLAND LIBRARI" - TË TRONDIT ME NOVATORIZMIN E SAJ

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 8)

#### SHËNIME MBI LIBRAT

Zejnullah Rrahmani: *Deti i zi*

#### GJENEZA: MJALTI E PELINI

nga Nysret Krasniqi

(fq. 6)

"Liria ime", roman, "Onufri", Tiranë 2021

#### EPIDEMIA E LIRISË

#### TE MEHMET KRAJA

nga Arbër Ahmetaj

(fq. 7)

#### VISAR ZHITI - NË KËRKIM TË

#### BRITMËS SHQIPTARE

Nga Ali Aliu

(fq. 14)

Mbresa nga një rilexim pas 30 vjetësh i romanit  
të mirënjohur të Besnik Mustafajt

#### RIKTHIM TE "VERA

#### PA KTHIM"

Nga Artur Spanjoli

(fq. 11)

Adnan Ismaili: "Jusufti dhe Zelihaja në letërsinë shqipe"

#### SINTEZA E VËSHTRIMIT

#### ANALITIK DHE KRAHASIMTAR

Nga Sali Bashota

(fq. 12)

Botime të reja nga "Schnell"

#### VËLLIMI ME TREGIME

#### "I RA MJEGULLA BUENËS"

I ARBEN PRENDIT

(fq. 15)



#### KONGRESI I DREJTSHKRIMIT, PA GRIM

nga Mehmet elezi

Duket se 50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 20 - 25 nëntor 1972) nuk po afrohet në zoom ashtu siç është, me dritëhijet e veta. Njihet si kuvend shkencor, pritet me u vështruar në mënyrë shkencore. Emocionet gjithsesi janë ftohur, njerëzit e sotëm janë më pak të indoktrinuar. Është rasti që ngjarja të pastrohet nga grim i një shtëpie politike me drita të kuqe e të trajtohet ashtu siç është, me bukuritë dhe vrugat e fytyrës. Të paraqitet në një dritë natyrore, pa regji. (S)ja po ndodh?

(fq. 8)

#### Festivali letrar ndërkombëtar i të rinjve "TIRANA GATE 2022"

(fq. 16)

#### MIEKO KAWAKAMI: Pikërisht për atë çast



(fq. 21)

#### BIBLIOTEKË

Visar Zhiti

(fq. 15)

*Lulet e Sanremos*

Vlad Zografi

(fq. 18)

*Po intabulohem*

Xhelal Tosku

(fq. 19)

*Për shkak të hënës*

#### GEORGIA O'KEEFFE: NJË FORCË E NATYRËS

Nga Rachel Corbett

(fq. 22)

Në vitet e fundit të jetës së Georgia O'Keeffe në New Mexico u pa një rinovim i punës së saj artistike dhe zhvillimi e një miqësie të rëndësishme.

#### ASPEKTE TEORIKLE HISTORIKE DHE KRITIKE TË PËRKTHIMIT

Nga Zija Vukaj

(fq. 20)

Kjo bisedë është pjesa e VI-të e serisë “Letërsitë ballkanike-botërore”, e nisur nga Belfjore Qose dhe Christian Voss në vitin 2021. Është dhënë në formë të shkruar nga Nikola Madžirov, poet nga Maqedonia e Veriut.

## Poezia Metafizike në kornizën ballkanike dhe universale

# NIKOLA MADŽIROV

diskuton me

## BELFJORE QOSE dhe CHRISTIAN VOSS

*“Nuk i kam përkitur askujt për shekuj me radhë  
Si një monedhë e rënë nga cepi i një ikone të vjetër  
Jam shpërndarë mes trashëgimive dhe betimeve të rrepta  
Prapa perdeve të fateve të rënë në short.  
Historia është kufiri i parë që duhet të kapërcej.”  
“Zbulesa”, N. Madžirov*

### Përmbledhje

Nikola Madžirov-i është një nga poetët më të spikatur bashkëkohorë nga Ballkani, i krahasuar nga “Der Spiegel” me Tomas Tranströmer-in dhe i çmuar nga shumë kolegë bashkëkohorë poetë dhe kritikë<sup>1</sup>.

Poezia e tij është një pikë referimi për Poezinë e Re Evropiane, duke krijuar një dualizëm ngërthyes midis nderimit të traditës dhe thyerjes së paevitueshme të kanonit. Në këtë intervistë, poeti eksploron disa prej temave dhe motiveve më të rëndësishme të poezisë së tij, si dhe disa nga çështjet më të diskutuara për poezinë bashkëkohore, si përkthimi dhe përkthyeshmëria e poezisë, identiteti dhe poezia, rëndësia e kanonit dhe influencat letrare/artistike, ngjashmëritë me shkrimtarët bashkëkohorë, marrëdhënia e realitetit të jashtëm me gjuhën poetike etj. Thuaje gjithçka që diskutohet bazohet mbi realitetin aktual, duke qenë në të njëjtën kohë universale – e tillë është dhe natyra e poezisë së Madžirov-it. Stili i tij poetik mund të vërehet edhe në këtë intervistë, ku lirika dhe ligjërimi filozofik shkrihen në një botëkuptim origjinal, të thellë dhe mendjehollë. Në besojmë se në poezinë e tij ka ndjeshmëri, dhimbje, dhembshuri dhe thellësi të veçantë, rrënjët e saj janë në origjinën ballkanase dhe në të qenit pasardhës i refugjatëve të Luftërave Ballkanike. Adam Zagajewski ka shkruar: “Poezitë e Madžirov-it janë si pikturat ekspresioniste: plot me ravijëzime të trasha energjike që duket se zënë fill në imagjinatë dhe kthehen menjëherë po aty, si kafshë nokturne të mbërthyer nga drita e fenerëve të një makine.” Ndërsa Mark Strand-i ka thënë se “Poezia e Madžirov-it është si zbulimi i një planeti të ri në sistemin diellor të imagjinatës.”

### Për autorin

Nikola Madžirov-i (lindur në 1973 në Strumicë) është poet, eseist dhe përkthyes nga Maqedonia e Veriut. Poemat e tij janë përkthyer në mbi dyzetë gjuhë. Me përmbledhjen poetike “Guri i zhvendosur” (2007) ai fitoi çmimin për poezinë e Evropës Lindore “Hubert Burda” si dhe çmimin më prestigjioz maqedonas për poezinë “Vëllezërit Miladinov”, në Mbrëmjet Poetike të Strugës. Çmime të tjera përfshijnë “Gjethja e Argjendit”, “Xu Zhimo” për poezinë evropiane në Kolegjin e Mbretit, Kembrixh, çmimin “Studentski Zbor” për debutimin më të mirë në Maqedoninë e Veriut dhe çmimin “Aco Karamanov” për librin “Diku Askund”.

Kompozitori amerikan i xhazit dhe bashkëpunëtor i Bjork-ut dhe Lou Reed-it – Oliver Lake-u, si dhe Michael League dhe Becca Stevens-i kanë kompozuar muzikë duke u bazuar mbi poezitë e Madžirov-it. Nikola Madžirov-i ishte redaktori poetik i gazetave elektronike “Blesok” dhe “Diversity”. Ai ka fituar mjaft bursa ndërkombëtare<sup>3</sup> dhe poezitë e tij, esetë dhe kritikë për poezinë e tij janë botuar në “Die Zeit”, “Der Spiegel”, “Tagesspiegel”, “Neue Zürcher Zeitung”, “Sinn und Form”, “American Poetry Review”, “Modern Poetry in Translation” (MPT), “London Times” (TLS), “World Literature Today”, “El Pais” etj.

Nikola Madžirov është përkthyes i Louise Glück-ut, Yehuda Amichai-t, Slavenka Drakulić-it, Georgi Gospodinov-it, Li-Young Lee-së, Vasko Popa-s, Vaclav Havel-it, Faruk Šehić-it, Ana Ristović-it, mes të tjerësh. Ai është një nga koordinatorët e rrjetit të poezisë ndërkombëtare “Lyrikline”, me bazë në Berlin dhe redaktor i një prej revistave më të vjetra letrare maqedonase “Stremež”. Ai ka redaktuar botimin maqedonas të “Antologjisë së Poezisë Botërore: Shekulli XX dhe XXI”. Në gjermanisht libri i tij me poezi “Versetzter Stein” u publikua në botimin e Lyrik Kabinett nga Hanser Verlag-u.

1 Madžirov, Nikola: Mbetjet e një kohe tjetër, Përkthyer nga maqedonishtja nga Peggy dhe Graham W. Reid, Magdalena Horvat dhe Adam Reed, BOA Editions Ltd., Rochester, NY, 2011, fq. 39.

2 Disa prej emrave që kanë shkruar për poezinë e tij janë: Adam Zagajewski, Mark Strand, Charles Simic, Michael Krüger, Tomaz Šalamun, Bei Dao, Kapka Kassabova, Simon Armitage, Carolyn Forché, Li-Young Lee, George Szirtes.

3 “DAAD” dhe “LCB” në Berlin; “Villa Waldberta” në Mynih; “International Writing Program (IWP)” në Universitetin e Iowa-s në USA; “KulturKontakt” në Vienë; “Landis & Gir Stiftung” në Zug; “Marguerite Yourcenar” në Francë; “Civitella Ranieri” në Itali; bursat “Traduki” me rezidencë për shkrimtarët në Split (“Udruga Kurs”), Tiranë (“Poeteka”) dhe Beograd (“Krokodil”).

### Atdheu dhe pozicionimi rajonal i poezisë maqedonase

**Belfjore Qose:** Do të doja ta hapja diskutimin me raportin poetik me atdheun dhe shtëpinë. Duke qenë se jemi nga Ballkani, ne e dimë se si atdheu lihet, por gjithmonë me idenë për t’u rikthyer. Tashmë, po largohen përherë e më shumë emigrantët nga Ballkani Perëndimor, pa e kthyer kokën pas. Në këtë kontekst të ri të njerëzve që lënë shtëpitë e tyre për shkak të luftës, si në Ukrainë, poezia na kujton rëndësinë e shtëpisë dhe atdheut për ndërtimin e identitetit individual. Çfarë domethënie ka shtëpia si qendër e marrëdhënies suaj me kujtesën? Çfarë është në fakt ‘shtëpia’ e poetit dhe si e mbart ai atë brenda tij?

Sot, jemi endacakët e frikës. Perspektiva e të lënit të shtëpisë ka ndryshuar – tani të qëndruarit në shtëpi është mërgimi modern,

dinamikat e ekzistencës kolektive. Bota sot jeton me lokalizma dhe largësi të reja – në vend të kilometrave, horizontet e pranisë tonë maten me kilobajt. Mbyllja ne vetvete që më parë konsiderohej si patologjike, sot po kthehet në një tipar të ri të jetës. Në konfigurimin e sotëm të përbysur të botës, ndoshta Glenn Gould-i nuk do të kishte shfaqur koncerte aq herët, dhe ndoshta Nick Drake-u nuk do t’i kishte dhënë fund jetës duke jetuar me frikën e syrit të mprehtë të medias.

Megjithatë, ka një hendek të madh midis vetmisë si një vendim kolektiv dhe vetmisë si një impuls vetjak. Qindra vite më parë, nostalgjia konsiderohej sëmundje në Evropë dhe njerëzit me një dëshirë të fortë e të pandalshme për t’u kthyer në shtëpi trajtoheshin me opium, shushunja ose pushime të gjata në klimë malore. Tani, malet dhe oqeanet janë futur në shtëpitë tona, bashkë me shtysën për të notuar

përtej kufijve të sëmundjeve dhe luftërave. Elizabeta Sheleva shkruan se “nostalgjia është malli për një kohë tjetër – kohën e fëmijërisë tonë, ritmin më të ngadaltë të ëndrrave tona. Në një kuptim më të gjerë, nostalgjia është rebelimi ndaj idesë moderne për kohën...”

Fëmijëria është banesa më e sigurt për kujtimet tona. Vetëm pasi na lind një fëmijë, ndërgjegjësohemi për numrin e madh të objekteve të mprehta që kemi në shtëpitë tona. Ndoshta lindja e një refleksi të ri mbijetese do të na ndihmojë t’i heqim të gjitha thikat e mprehta brenda nesh. Nga Wittgenstein-i te Miłosz-i flitet për gjuhën si e vetmja shtëpi e vërtetë. Do të më pëlqente të flisja për shtëpinë si për një gjuhë, dhe t’i imagjinajoja muret si pikësimi në fund të ndjenjës së mallit (përkatësisë). Dritarja e hapur e realitetit më lejon të prek ëndrrat dhe frikërat e mia, të ndiej dinamikën e botës edhe kur nis të besoj te rrënjët e



Belfjore Qose është Profesoreshë e Letërsisë Botërore të shekullit XX pjesa 1 dhe e Letërsisë Ruso-Sllave në Universitetin e Tiranës. Ajo është anëtare themeluese e Akademisë së të Rinjve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si dhe poete e mirënjohur.



Christian Voss është profesor dhe përgjegjës i departamentit për Studimet e Sllavëve të Jugut në Universitetin Humboldt të Berlinit dhe drejtor themelues në Qendrën “Crossing Borders”.

padukshme të përkatësisë. Mbiemri im do të thotë “emigrant” (nga turqishtja *muhacir*) dhe këtë e zbulova pasi nisa udhëtimet e mia intensive. Ky zbulim më trembi, kështu që nisa t’i emëroj me kujdes gjërat që shoh, prek, rizbuloj... Gjithmonë hulumtoj nëse emrat e rrugëve ku jetoj janë marrë nga librat e historisë apo janë emra që u përkasin historive personale të qytetit.

Në një nga intervistat e tij të fundit, Mahmoud Darwish-i tha se në epokën moderne të gjitha betejat e botës ndodhin për ndryshimet e toponimeve. Ai pyeti se ku e ndiejmë më fort hapësirën: në gjuhë apo në gjeografi? Shtëpitë e mia të përkohshme gjallojnë nëpërmjet gjuhëve që unë nuk i kuptoj dhe kujtimeve tek të cilat nuk do të kthehem kurrë. Në vend të monumenteve rreth hotelit, u bëj foto dhomave prej të cilave largohem. Rudhat mbi çarçafin e krevatit në dhomat sterile të hotelit dhe mbresat e thella të këmbëve të karriges mbi tapetin e trashë – janë prania e dikujt që mund të kthehet. Struktura e sendeve në dhomë është sistemi i qarkullimit të gjakut të shtëpive ku banoj dhe lë pas. Kur shkoj diku më duket sikur jam duke u kthyer. Punëtorët e ndërtimit që jetojnë nëpër kabina të përkohshme rreth karabinasë janë zakonisht ata që qëndrojnë atje përjetësisht. Për Ballkanasit, ikja është më tepër një çështje e matjes së kohës se sa një kalendar mungese hapësinore. Pas kaq shumë luftërash, besoj më shumë te hashtja e njerëzve se sa te zëri i lartë i monumenteve.

Mitologjia e fëmijërisë ishte streha ime e parë ndaj frikës së realitetit të parashikueshëm. Ikja shpesh nga shtëpia kur isha fëmijë, i veshur me pizhame dhe me këpucët e tim eti që ishin tri herë sa këmba ime. Udhëtimi ishte veprimi më i sigurt derisa i vumë emrin “braktisje”. Michael Krüger-i në poezinë e tij “Migrimi” shkruan:

“Tani dhomat janë të zbrazëta, valixhet / përvijojnë korridorin

bashkë me kutitë nevrastenike / ku librat kacafyten me gazetat.” Librat që kisha për të lexuar më jepnin shpresë për t’u kthyer. Leximi ka qenë përherë karburanti i lëvizjes sime kur isha i rrethuar nga luftëra dhe rregullore vizash. Kujtoj se si ëndërroja të harroja gjithçka, në mënyrë që të mund t’i lexoja të njëjtët libra sërish e sërish. Pasi ndjeva se harresa nuk do të më avitej kurrë, nisa të shkruaj. Kjo është mënyra se si jetoj me gjërat për të cilat shkruaj; përipiqem të ndërtoj një godinë me fjalë dhe lëvizje. Zagajewski thotë që të shkruarit e poezive është si të fluturosh me balona – më shumë se tek timoni, mbështetesh tek erërat. Unë e shoh poezinë si një trup që zhvendoset me çdo lexim të ri. Edhe pse fjala “poezi tingëllon shumë e brishtë dhe e pafajshme, ajo mund të shkaktojë kaos në shoqëritë rreptësisht të kontrolluara. Diktatorët u tremben metaforave dhe hijeve të shumëfishuara të fjalëve sepse duan të ndërtojnë semantika absolute jete, ku çdo gjë, edhe mobiliet, edhe frika, ka vetëm një kuptim.

**Christian Voss:** Përkthyesi juaj në gjermanisht është Alexander Sitzmann-i, i cili është gjithashtu edhe përkthyesi i Georgi Gospodinov-it. Shkrimtarë si ju marrin pjesë në debatin e përshkallëzuar politik lidhur me njohjen dhe kundërshtimin e gjuhës letrare maqedonase ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. Kjo më sjell ndërmend pyetjen: Mendoni se mund t’i shërbeni kanonit kombëtar që thekson dallimet nga Bullgaria, apo veprimi juaj dhe pozicionimi si një intelektual publik janë të orientuara drejt konvergencës nëpërmjet veprimit brenda një fushe të ngjashme letrare dhe të bazuara mbi të njëjtin ndërtekstualitet si poetët bullgarë dhe nëpërmjet rrjeteve socializuese ndërkombëtare, si Traduki?

**Nikola Madžirov:** Sa herë që shkruaj për lindjen time dhe frikën ndaj vdekjes, unë përdor gjuhën amtare. Cilën gjuhë mund të përdor nëse shkruaj për vdekjen? Vitin e shkruar, luftova një betejë të gjatë e të ashpër kundër Covid-19-ës. Përreth dhomës sime të spitalit, njerëzit që ishin duke vdekur flisnin e këndonin në gjuhën e dialekteve të fëmijërisë së tyre, edhe kur ishin duke rënë në koma. Kam lexuar se si gjatë shembjes së Kullave Binjake, personat brenda ndërtesave përdorën pa vetëdije vetëm gjuhët e nënave dhe të fëmijërisë në telefonatat e tyre plot frikë dhe lamtumira. Unë përdor gjuhën maqedonase kur nuk dua të them gjithçka, prandaj shkruaj poezi. Ajo më jep sigurinë e një luleje të harruar. Njerëzit duhet t’i transformojnë frikërat dhe pasiguritë e tyre të zakonshme, sidomos në Ballkan, dhe ndalojnë së përdoruri ato si armë.

Georgi Gospodinov-i është një mik shumë i mirë i imi dhe disa prej librave të tij i kam përkthyer në maqedonishtë, duke u rrekur t’i afroja fjalët e tij me fëmijërinë time të brendshme, kur ende nuk përdorja fjalë për të kuptuar botën. Përkthyesi ynë, Alexander Sitzmann-i, na futi të dy së bashku nën çatinë e gjuhës gjermane, dhe Traduki na bashkoi në sheshin e hapur të letërsisë, mbi telat metalikë të historisë. Përkthimi është një ritual, lutja e lutjeve, era që bart flakën, mishërimi i një zëri që nuk të përket dhe që flet me fjalët e tua të pafolura. Simone Weil-i tha që “të gjitha mëkatet janë përpjekje për të mbushur zbrazëtitë”, dhe përkthimi është një mënyrë e heshtur për të mbushur zbrazëtitë tona. Sot, si ndryshimi i shtëpive, edhe frika e humbjes së themeleve të qenies, prodhojnë nxitjen për ruajtjen e gjuhës. Që të mund të gresh diçka, duhet fillimisht ta humbasësh. Humbja nuk është zhdukje, por ndryshim i hapësirës. Ndonjëherë fjalët humbasin

në areale gjuhësore të reja, si një fëmijë kureshtar që humbet në rrethina.

Përkthimi nuk pushton hapësira të reja, por i zbulon ato. Kurdoherë që lexoj poezi në gjuhë të ndryshme nga ajo e fëmijërisë sime, instinktivisht nis t’i përkthej. Megjithatë, nuk bëhet fjalë për një përkthim intim apo të brendshëm të “Google”-it të kujtesës sime nga një gjuhë në një tjetër; por më shumë për zbulimin e hapësirave të reja të përjetimit të gjuhës dhe pranisë, një arkeologji të re të realitetit emocional. Dikush do të thoshte se poetit i duhet një kafaz që të mund të shkruajë për lirinë dhe liri që të mund të shkruajë për kafazin. Në të dyja rastet, poeti sheh përmes hekurave. Autori bashkëkohor nuk sheh kufij dhe hija e tyre bie mbi të vetëm kur oficeri i doganës krahason me dyshim fytyrën e tij dhe foton në pasaportë. Gjuha është vatra e tij e vetme, ndërsa atdheu është vetëm një vend ku të kthehet dhe iluzionit i një vdekjeje paqësore.

### Korniza e religjionit, traditës dhe fqinjësisë

**Christian Voss:** A ju ka formësuar fakti që keni lindur gjatë Jugosllavisë? Në këndvështrimin tim, korniza jugosllave e ka penguar marginalizimin dhe provincializimin e kulturës maqedonase – shembull i spikatur i kësaj mund të jetë ritmi me të cilin klasikë si Judith Butler-i dhe Edward Said-i u përkthyen në gjuhë të ndryshme të Ballkanit. A mund të komentoni, ju lutem, për këtë kornizë jugosllave të Maqedonisë së Veriut?

**Nikola Madžirov:** Unë jam pasardhës i refugjatëve të Luftërave Ballkanike të para 100 vjetësh, të cilët fshiheshin dhe rrinin të heshtur në qilar për të mbijetuar. Heshtja ishte gjuha e tyre amtare. Unë isha tetëmbëdhjetë vjeç kur në Jugosllavi nisën luftërat e reja. Politikanët në pushtet vendosën një uniformë ushtarake mbi pizhamet e mia të pafajësisë mbi shtratin tim. Një sistem politik u ndërrua me një tjetër. Të dyja ndryshimet ndodhën në të njëjtën kohë, duke i shkatërruar muret e qelqta të fëmijërisë sime dhe perdet e trasha të sigurisë së premtuar. Papritmas, autorët e librave për t’u lexuar në shkolla u deklaruan ose armiq të shtetit, ose klasikë dhe kjo pati një domethënie të vetme: askush nuk i lexonte më. Mua m’u desh ta prisja vetë kordonin e këthizës dhe të

integrohesh në kornizën më të gjerë të letërsisë evropiane. Që atëherë, e gjithë jeta ime u kthye në arratisje – jo një arratisje nga diçka, por drejt diçkaje. Kam më shumë besim tek vrazat e kohës mbi lëkurën tonë se sa te xhinglat e spikatura të uniformave. Kur ushtari vritet, uniformën e tij e merr dikush tjetër dhe i flak tutje gjithë fotot e letrat e familjes së tij nga xhepat. Unë vetëm sa po përsëris historinë e paraardhësve të mi të cilëve iu desh të braktisnin shtëpitë e tyre për shkak të luftës, por morën çelësin me vete – një çelës që do të hapte vetëm portat e kujtesës. Kur udhëtoj unë nuk i marr me vete çelësat. Gjuha ka mbetur pragu im i vetëm i sigurisë. Shpesh kujtoj fjalët e Charles Simic-it, i lindur në një Jugosllavi të ndryshme nga ajo ku u rrita unë, i cili tha se të qenit refugjat nuk e bëri poet, por e bëri atë poet që është. Rënia e Jugosllavisë dhe pavarësia e Maqedonisë më mësoi se asnjë simbol shtetëror nuk është i përjetshëm – të gjithë luanët, shqiponjat, yjet, diejt, gjethet, mund të fluturojnë nga flamuri si një qese plastike që kërkon një erë më të fortë. Midis cigareve më të pëlqyera nga klasa punëtore në ish-Jugosllavi ishin ato që quheshin “Jugosllave me Filtër”, ndërsa ata që ishin “më të barabartë se të tjerët”<sup>1</sup> tymosnin “Lord Extra”. Meqë përmendëm Edward Said-in, ai thajse e parashikoi rënien e ish-Jugosllavisë: pas ndarjes, “Jugosllave me Filtër” u riemëruan “Orientale me Filtër”. I njëjti tym tashmë udhëtonte nga Jugu (Jug) drejt Lindjes (Orient), ndërsa sytë e duhanpirësve qenë kthyer nga Perëndimi. Ballkani është plot të vërteta të ndryshme zyrtare, me të njëjtin intensitet dhimbjeje personale në të dy anët e cilitdo kufi. Luftërat zyrtare ekzistojnë në mënyrë që të numërohen heronjtë. Ndërsa në të gjitha luftërat jozyrtare ka vetëm viktime.

Ndihem si një vetë-refugjat në kohërat e një paqeje të rreme. Në kohën e Luftës së Ftohtë mësova të gjej ngrohtësi midis dy heshtjeve. Nuk besoj se poezia mund ta ndryshojë botën, por poezia mund të ndryshojë largësinë nga e cila shohim plagët e hapura të botës. Poezia mund të mbjellë një farë brenda plagëve kur askush nuk e ka mendjen. Gjithsesi, më mirë të them që natyra e poetikës është ndryshuar nga bota. Ka ndodhur që në emër të kudondodhjes botërore një poet mund të jetë duke shkruar për tenda plot me njerëz të pashtëpi, me

<sup>1</sup> Referencë për “Fermën e Kafshëve” të G. Orwell - “Të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa kafshë janë më të barabarta se të tjerat”.

sy ku banon dëshpërimi, ndërkohë që vetë rri ulur në kolltukë të butë. Brodsky na ndërjegjësoi për këtë me pemën e tij “Melodi Boshnjake”: “Ndërsa vështron se si shënojnë atletët, / kontrollon statusin tënd të fundit, apo / i këndon fëmijës tënd një ninullë, / njerëzit vdesin.” Zgjimi i poetit nuk varet nga kudondodhja e tij. Para pak kohe, përktheva në maqedonishtë disa poezi të shkruara nga poetët ukrainas, miq të mi, të cilat qenë të mbushura me alarme bombardimesh dhe çati të shkatërruara. Luftërat, për fat të keq, nuk të shpien kurrë në periferi, në një kohë padukshmërie paqësore. Megjithatë, poezia shërben për të dëshmuar realitetin me sy të hapur e të thatë, meqenëse lotët rrjedhin ndër venat e poetit, sikurse do të thoshte Cioran-i. Sikurse shpartallimi dhe fitorja nuk mund të përcaktohen me terma ushtarakë, sikurse theksoi Darwish-i, ashtu dhe universalizmi i fjalëve nuk mund të matet me numrin e “like-ve” por me thellësinë e plagëve në trupin e fjalëve. Ingeborg Bachmann shkruan: “Medalja jepet / kur nuk ndodh më asgjë, / kur artilleria hesht, / kur armiku është bërë i padukshëm.” Poeti nuk ka nevojë për medalje për të treguar të vërtetën. Heshtja e paqes është e mjaftueshme. Gjatë luftërave dhe diktaturave poezia duhet domosdomshëmrisht të kthehet në një brishtësi të fuqishme, një shenjë jashtë instrumenteve të fuqisë. Librat shkollorë jugosllavë ishin plot me rreshta revolucionarë që u zhdukën bashkë me portretet e udhëheqësve. Poezia si shenjë udhëton ngadalë, por rrugëton gjatë në kohë dhe në hapësirë, si një letër brenda një zarfi pa adresë.

**Christian Voss:** Në Gjermani, disa vite më parë, kolegu ynë Christian Prunitsch nga Dresdeni, i cili është ekspert për minoritetin e vogël sllav në Gjermaninë lindore, nisi të shkruante një libër për konceptualizimin specifik të “kulturave të vogla”<sup>2</sup> - për shembull, ai mund të vërtetonte se metaforat, si deti, fari, dhe vijat e baticës janë thelbësore për shprehjen e frikës së sorbëve nga asimilimi. A do ta vlerësonit të shkruarin tuaj prej autori maqedonas si rast tipik të një “kulture të vogël”?

<sup>2</sup> Prunitsch, Christian: Konzeptualisierung und Status Kleiner Kulturen. München 2009; ders.: Zur Semiotik kleiner (slavischer) Kulturen. In: Zeitschrift für Slavische Philologie 63 (2004) 1. S. 181-211; ders.: Kulturelle Kleinheitskonzept. In: Bulletin der deutschen Slavistik 12 (2006). S. 11-15.





**Nikola Madžirov:** Të gjithë endemi rreth qerthullit të kohës për të gjetur muzeun e pafajësisë së botës. Ravgimi është hapi i parë i të kthyerit diku - në dhomën tënde apo në fëmijëri. Nuk mund ta imagjinoj trupin tim në asnjë kontekst absolutizmi. Hija më e madhe e realitetit tonë të qëndrueshëm në Ballkan është uria për udhëtimin pas në kohë. Njerëzit braktisin shtëpitë dhe kujtimet për shkak të luftërave dhe varfërisë së imponuar dhe çfarëdo sendi që marrin me vete bëhet një objekt i çmuar ose simbol, një zë i mekur i ritualizmit personal. Gjysha ime mbante çelësin e shtëpisë së saj të braktisur në të njëjtin raft ku mbante dhe ilaçet e saj, duke menduar se ai çelës ndonjë ditë mund të hapte derën që nuk ekzistonte më. Në dhomat tona kemi sende që na mbajnë larg vdekjes. Nëna ime ruante gjithë rrobat e fëmijërisë sime, duke më thënë pa zë se dëshironte që të bëhej gjysha e t'i jepte fëmijës sime ende të palindur rrobat e mia, që kur unë nuk i kuptoja ende fjalët e botës. Nëna ime mbante të gjitha furçat e përdorura të dhëmbëve, pasi mendonte se ato mbartin një grimë të shpirtit të atyre që i kishin përdorur. Ajo vdiq tre vjet më parë dhe tani im atë e pastron foton e saj bardh-e-zi mbi gurin e varrit me furçën e saj të përdorur të dhëmbëve, po aq me kujdes sa dhe një arkeolog para një zbulimi me rëndësi planetare. Kam shkruar një ese për obsesionin e njerëzve me sendet dhe metamorfozën e tyre utilitare gjatë krizës ekonomike në komunizëm. Sendet kapërcenin çdo kufi sistemesh dhe matjesh të njohura simbolike. Imagjinata empirike e krijuar me dhunë për kotësinë e jetës, pa dashur, i ktheu në novatorë autoktonë njerëzit që besonin ende te sistemi ku jetonin.

Zbulimi i pragmatizmit polisemantik ishte një zbulim jo më pak e rëndësishme se estetika e "jetës së fshehtë të sendeve" të De Chirico-s. Mungesa e parave i bëri njerëzit t'i kthenin kutitë e mëdha prej teneqeje, që përdornin për të mbajtur djathin, në vazo për të mbjellë limona, pa i ricikluar. Kanoçet e zbrazura të pijeve me gaz u kthyen në mbajtëse stilolapsash. Fletët ku mbaheshin llogaritë dhe të tjera me përmbajtje burokratike u kthyen në kausha letre për të shitur në rrugë fara kungulli dhe kikirikë; monedhat 1 ose 2-dinarëshe

përdoreshin për të hapur kavanozat; doreza e derës përdore si një pajisje për të hapur shishe e birrës; kapakët e shisheve të birrës dhe Koka Kolës ishin niveluese të shkëlqyera për këmbët e tavolinave dhe karrigeve të paqëndrueshme; kutitë e këpucëve ktheheshin në vende për të ruajtur kasetat dhe librat. Duket paradoksale, por del që pikërisht Socrealizmi riprodhoi pragmatikisht vizatimet surreale të René Magritte-it - *Ceci n'est pas une pipe* (Kjo nuk është lullë). Pak javë më parë, marketeve iu ndalua shitja e qeseve plastike klientëve të tyre. Që ditën tjetër, në disa ballkone, vura re çanta të vjetra plastike "Lidl" të lara e që po thaheshin, ndoshta të sjella nga faresti që punojnë jashtë shtetit. Ditën tjetër, në një mur u shfaq një shkrim anonim: "Njerëzit që lajnë qeset e tyre plastike, nuk do të jenë kurrë në rrezik zhdukjeje".

### Metafizika e kohës dhe e tingullit

**Belfjore Qose:** Poezitë në "Mbetjet e një epoke tjetër" për mua qëndrojnë përtej kohës dhe hapësirës së veçantë kur janë krijuar, edhe pse ka shumë detaje që dëshmojnë natyrën teknologjike ose dhe antropologjike të kohës sonë, të tilla si antenat, kabllot, plastika, automjetet, etj. Por, në përgjithësi, poezia juaj është qëllimisht e painteresuar për dimensionin social, horizontal, ndërsa theksohet kërkimi metafizik, i dëshmuar disa herë me vargje, si "Jam i zbrazët si një qese plastike e mbushur me ajër"<sup>1</sup> (Poezia "Hija e tokës kalon"). Ka shumë poezi në të cilat përkohshmëria i kalon emocionet, përpjekjet, gjithçka prej së cilës përbëhet jeta tokësore dhe më duket se kjo na jep një qetësi të thellë e të justifikuar. Por poezia juaj nuk është kalimtare, përkundrazi ajo kanonizon poezinë<sup>2</sup> përtej Maqedonisë së Veriut. Si e arrijnë poetët detyrën e lartë të përdorimit të efemeres

<sup>1</sup> Madžirov, Nikola: Remnants of another age, Translated from the Macedonian by Peggy and Graham E. Reid, Magdalena Horvat and Adam Reed, BOA Editions Ltd., Rochester, NY, 2011, pg. 35.

<sup>2</sup> Poezia e Madžirov-it është përkthyer në shumë gjuhë dhe ka arritur lexueshmëri botërore, si dhe ka tërhequr shumë studiues dhe kritikë, duke qenë një poet i mirënjohur bashkëkohor. Aftësia e tij për të përfaqësuar poezinë moderne të Maqedonisë së Veriut dhe për të qenë njëkohësisht pjesë e Letërsisë Botërore bazohet te vetë natyra e poezisë së tij që angazhon lexues përtej lexuesve në gjuhën e tij amtare.

për të kuptuar të përjetshmen? A besoni në misterin e krijimit artistik?

**Nikola Madžirov:** Më pyesin shpesh - ju jeni nga Ballkani dhe nuk ka gjak në poezitë tuaja? Po, nuk ka gjak midis fjalëve, por ka gjak që rrjedh në kujtesën time. Shpesh, frikërat e trashëguara dhe të dëshmuara të luftës më bëjnë që sa herë që shoh një pemë të vetmuar, të mendoj për kufomën e një ushtari nën rrënjët e saj. Shpesh pohoj se nuk kam iluzionin se po them diçka të re, sepse çdo gjë ekziston edhe pa qenë e dokumentuar, si minerali në një minierë ende të pazbuluar. Më shumë besoj te lodrat e fshehura, se te sekretet më të mëdha të luftës. Ndonjëherë, që të mund të shkruash, është e nevojshme që të rrih në një vetmi që nuk sjell frikëra dhe kujtime më të rënda se vetë vdekja. Mënyra më e sigurt për të kujtuar ëndrrën e fundit është që të mos shohësh nga dritarja kur zgjohesh. Unë besoj se nxitja për të (ri)treguar do të ekzistojë përderisa ekziston ende misteri i ikjes dhe kthimit. Shumë shpesh ndihem më i sigurt kur flas në ëndrra dhe hesht në realitet.

Kritikët e cilësuan John Donne-in "metafizik", se gjëja e parë që duhej mbajtur mend për të është që ai ishte katolik, dhe e dyta që ai e tradhtoi fenë e vet. Mendoj se ky është mallkimi që ndjek pas hapat e heshtur të çdo shkrimtari: të tradhtojë përkatësinë në momentin kur ndien sikur ka nisur të përkasë. Në një nga intervistat e tij të fundit, të titulluar "Unë jam një katolik i dështuar, por jam ende katolik", Adam Zagajewski tha: "Të kërkuarit qëndron te kërkimi, jo te përcaktimet e forta." Shumicën e kohës ndihem si një nomad, edhe pa e lëvizur trupin tim nga një realitet gjeometrik në një tjetër. Kam udhëtuar dhe kërkuar intensivisht për më shumë se njëzet vjet, e megjithatë, gjysha më thoshte se ajo kishte qenë në gjithë ato vende, edhe pse ishte gjithmonë ulur në kolltukun e saj të vjetër në dhomën e ndenjes. Ballkani shpesh t'i mundëson këto udhëtime të pafundme nëpërmjet ideologjive, mbretërive dhe republikave, edhe duke qenë ulur në karrigen tënde. Mjafton të ulësh e të presësh që të tjerët të ndryshojnë kufijtë.

"Një shkrimtar është bota e ngjuar te një person", shkruante Viktor Hygo. Ndhim i sigurt në shpellën e hapur të

përkatësisë. Misteri i krijimit artistik fle në themelet e metamorfozës befasuese, kur e amshuara kthehet në efemere dhe e anasjellta - kur një engjell ka nevojë për maskë oksigjeni që të hyjë në spital për të ndihmuar një pacient në hjekje apo kur një top i flakur mbi çati bëhet pjesë e një yjesie të pazbuluar. Joachim Sartorius shkruan: "Çdo gjë ndryshon trajtë. Shkrimi ynë/mishi ynë, edhe dashuria. Prej gjithë kësaj/dhe prej asaj që s'ndihemi kurrë si në shtëpi/lind poezia". Një metamorfozë moderne po ndodh teksa flasim, kur njerëzit hapin perdet e jetës së përditshme, duke hequr maskën për të shfaqur një fytyrë të rreme. Dubravka Ugrešić i hoqi maskën realitetit aktual duke thënë: "Pjesëmarrësit në një karnaval në kohët para-digjitale mbanin maska. Sot, të gjithë bëjnë të pamundurën për të shfaqur fytyrën." Gjatë fëmijërisë sime të hershme, para se të mësoja shkronjat dhe papërsosmërinë e fjalëve, shkruaja në muret e dhomës. Prindërve të mi u duhej ta rilyenin dhomën me të bardhë çdo verë. Duket absurde por muret qenë palimpsesti i parë i lirisë sime. Nisa të shkruaja poezi kur mësova shkronjat, por nisa ta kuptoj poezinë kur mësova heshtjen. Sigurisht, kjo ndodhi para se të niste lufta në Jugosllavi. Kjo luftë më ndihmoi të kuptoj nevojën për të bërë titur nëpërmjet letrës, kur gjithçka e gjithkush përreth bërtet. E di që sot duket patetike kur dëgjon se si një poet përdori gjakun e tij në vend të bojës për të shkruar vargjet e tij të fundit, por në hapësirën ku jetoj, disa njerëz përdorin gjakun e njerëzve të tjerë për të shkruar histori të reja dhe mite të imponuara.

**Belfjore Qose:** Kur flasim për poezinë, sidomos nëse i referohemi gjuhës poetike, ka një lidhje të veçantë midis realitetit dhe fiksonit. Po zgjedh ta shmang parantezën për konceptet strukturaliste lidhur me gjuhën poetike dhe do ta drejtoj diskutimin kah vargjeve tuaja. Poezia juaj shqyrton nëse rrethanat na bëjnë ata që jemi dhe idenë që çdo gjë ekziston brenda nesh. "Asgjë nuk ekziston jashtë nesh"<sup>3</sup> është vargu i parë i poezisë "Sendet që duam të prekim", ndërsa në poezinë "Ishte pranverë" gjejmë vargjet "Shumë gjëra e kanë ndryshuar botën/qysh atëherë, bota ka ndryshuar/shumëçka te ne."<sup>4</sup> Ku qëndroni ju midis këtyre dy citimeve dhe si ndihmon poezia për të reflektuar rreth përjetimit dhe imagjinatës?

**Nikola Madžirov:** Poezia mund të jetë një shtëpi me dritare të hapura kanat më kanat: ndihesh i mbrojtur por dhoma nuk ngrohet kurrë - era e botës po të pastron nga të gjitha idetë e përkatësisë së përcaktuar. Udhëtoni përmes të çarave në murin e historisë zyrtare, që është mbjellë në fushën e harresës personale. Duhet ta harrosh kapakun e historisë tënde personale që të mund të hysh në foto-albumin e historisë kolektive. Besoj se emërtimi i gjërave e fut historinë në qelizat e tyre të gjakut. Kur isha fëmijë mendoja se në Detin e Kuq gjallonin vetëm peshq me ngjyrë të kuqe dhe se Deti i Zi shfaqej vetëm në mesnatë... Mbiemri im Madžirov do të thotë i pashtëpi, dhe unë udhëtoj shumë, pa ndonjë çelës në xhepin e kujtesës sime. Për shkak të gjithë luftërave dhe varfërisë së madhe në Ballkan gjatë sundimit të Perandorisë Otomane, sikurse dhe në kohën e Luftërave Ballkanike, emrat personalë mbetën i vetmi thesar i trashëguar përmes kohërave.

Emrin Nikola e trashëgova nga gjyshi im dhe nëpërmjet atij emri pritej që të trashëgoja gjithë ëndrrat dhe dhimbjet e tij. Emri personal mbetej përbërësi bazë i ndërtimit të ndërgjegjësimit dhe pritshmërive jashtë historisë së përcaktuar. Murgjit ndërrojnë emrat e tyre kur hyjnë

<sup>3</sup> Madžirov, Nikola: Remnants of another age, Përkthyer nga maqedonishtja nga Peggy and Graham W. Reid,

<sup>4</sup> Ibid, pg. 41.

në komunitetin monastik dhe këtu çdo pushtues ndërron emrat e qyteteve, ndërsa njerëzit përlëshen për historinë e tyre personale duke përdorur emrat e vjetër të rrugëve dhe objekteve. Luftërat nisin me fshirjen e emrave dhe kujtesës - pastaj vjen plumbi. Në Ballkanin ku jetoj, njerëzit shpesh e glorifikojnë historinë në mënyrë të gabuar sepse kanë frikë se mos gjuhët e tyre mund të zhduken e të mbeten vetëm në faqet e historisë. Gjuha në të cilën shkruaj flitet prej vetëm 2 milionë njerëzish që po emigrojnë përditë në kërkim të një vendi të sigurt për të jetuar, duke i lënë kujtimet e tyre në hapësirat e reja para mobilieve. Mes këtij paniku nga zhdukja, shumë kombe e udhëheqës të përkohshëm në Ballkan i janë kthyer historisë që u ofron hapësirë dhe zjarrin rreth të cilit mund të tregojnë historitë e zakonshme (të frikshme). Poezia u ngrit mbi estetikën e zhdukjes së Paul Virilio-s dhe u ushqye nga rrënjët e asaj që ishte folur por nuk ishte shkruar ende. Në Ballkan, jemi bashkë në luftë dhe të vetmuar në poezi. Klaustrofobia është bërë filozofia kryesore e të jetuarit - apartamente me ballkone të vogla dhe tavane të ulëta për të ruajtur më mirë pasigurinë e vetvetes. Në çdo shtëpi fle fragmentarizimi i kujtesës.

Të parët e mi ishin refugjatë lufte dhe nuk shkruan poezi ndërsa kalonin kufirin dhe malet në këmbë, as nuk morën ndonjë libër me vete kur po vendosnin se çfarë mund të mbartnin me vete ndërsa po iknin nga shtëpitë e tyre. Nga ana tjetër, ka qark shumë libra të shkruar për eksodet, sa besoj se gjithë shtëpitë e braktitura të botës nuk do të mund t'i nxinin. Në rrethana të tilla, e konsideroj veten si një dëshmitar të padukshëm, si dikush që vjedh libra të vjetër, apo si dikush që vjedh historitë dhe fotot nga albumet e familjes. Të shkruarit është një mënyrë për të shtyrë mungesën tonë. Në botën virtuale qysh tani mungojmë; në këtë mënyrë ndiejmë më pak përgjegjësi për gjërat që emërtojmë apo vëmë në pah. Pas ekranit mund të bërtasim me buzë të mbyllura. Interneti ka një ndikim të veçantë po aq të fuqishëm sa dhe një fjalim politik euforik: edhe kur ndodhesh në mes të një turme ndihesh sikur udhëheqësi po të drejtohet vetëm ty. Me një ndërgjegjësim të tillë për oqeanin e stërmadh të informacionit, çdo autor shpreson se teksti i tij është një ishull mbi të cilin dikush mund të ndalojë për të marrë pak frymë para se të vijojë kroçerën, një term që, ndryshe nga lundrimi, lë më shumë hapësirë për përthithjen meditative të letërsisë. Poezia është liri edhe kur është e kyçur në një raft. Bei Dao shkroi se liria s'është veçse largësia midis gjahtarit dhe presë. Kur shkruan je gjahtar dhe pre njëkohësisht, ndërsa poezia është ajo distancë e bukur e lirisë. Kuptova se studioja e piktorit është më sublime se galeritë e ekspozitave, se procesi i të shkruarit është shumë më thelbësor se zhvendosjet e trupit tim. Unë shkruaj si një fëmijë që e fsheh fletoren me një dorë, e që lejon vetëm zogjtë dhe të vdekurit të shohin ç'është shkruar.

**Belfjore Qose:** Drita është element qendror në poezinë tuaj, e shumëpranishme dhe e ngarkuar emocionalisht, ajo mund të jetë një metaforë e gjurmëve të jetës njerëzore<sup>5</sup>, e pastërtisë<sup>6</sup>, shpirtit ose hirit<sup>7</sup> etj. Kjo dritë lidhet me nivelin metafizik të poezisë suaj dhe më kujton dritën në ikonografinë ortodokse, e cila buron nga interpretimi biblik i Krishtit si drita e Fjalës.

5 "Ne jemi drita e një shkrepseje të djegur që kthehet në pluhur kur e prekin." (Poezia "Dritë dhe pluhur") Ibid, pg. 81.

6 "Gjithmonë e bardhë për shkak të dritës." (Poezia "Kthimi") Ibid, pg. 83.

7 "Ndërmjet ijes dhe kafazit të saj të kraharorit drita derdhej përnatë." (Poezia "Dy hëna") Ibid, pg. 79.

Ndonëse shkruar në një zhanër dhe stil krejt ndryshe, "Tundimi i fundit i Krishtit" i Niko Kazanzaqisit përdor të njëjtin simbolizëm për të përshkruar dritën që buron nga Krishti; ndërsa në pikurat e El Grekos, drita që transformon figurat e tij në trajtat ekstazike autentike të tij nuk vjen nga lart, por nga subjekti më i shenjtë, qoftë ky fëmija i shenjtë, pëllumbi apo shenjtorët. Si përcaktohet poezia juaj nga kjo dritë simbolike? Mendoni se poezia mund t'i shërbejë diçkaje më të madhe se vetes?

**Nikola Madžirov:** Kur ndodhem përpara oxhakut dhe ndiej acarim e erës dhe kur ndodhem larg shtëpisë dhe ndiej dritën e oxhakut - atëherë mund të flas për dritat dhe hijet e të mospërkuturit të bukur. Carolyn Forché, në poezinë e saj "Ruajtësi i Dritës" (The Light Keeper) shkruan: "Shko përherë drejt dritës, edhe pa anije." Të ndjekësh dritën do të thotë një gjendje e përhershme e të qenit zgjuar, edhe po të jesh poet - një somnambul me sy të hapur. Kur përpëlitesha për të marrë frymë në spitalin e Covid-it, përnatë prisja rrezen e parë të agut që hynte poshtë shtratit tim nga një dritare e vogël, që të mund të flija pa frikën se vdekja vjen e veshur vetëm me hijen e natës. "Zgjuhesh dhe qirinjtë ndizen si vetvetiu, / yjet mblidhen, ëndrrat derdhen mbi nënkresat tuaja, / dhe dërgojnë buqeta të ngrohta ajri.", shkruan Mark Strand te "Lindja e Dritës".

Edhe një element tjetër më mahnit dhe më tremb në të njëjtën kohë - uji. Kam dashur përherë të jem afër ujit, të vëzhgoj lëvizjet e tij valëzuese si një metaforë e përkryer për kardiogramën e jetës sonë. Te "Vigjilja e

Vitit të Ri", Josif Brodskij dëshironte të ishte përherë pranë ujit, të shihte "një dallgë që godet bregun në mesnatë. Ajo, për mua, është koha që del nga uji." Drita ka hijen e vet në ujërat e thella. Trupi ynë është më së shumti ujë dhe, si kur vdesim, ashtu dhe kur thahet një liqen, mund të shohësh me qartësi se çfarë ishte mbledhur dhe hedhur brenda nesh dhe në liqen. Unë e pranoj që drita vjen nga brenda nesh dhe vetëm në këtë mënyrë mund të ngadhënjëm mbi historinë e errët që ndodhet tani në Ballkanin plot diell. Junichiro Tanizaki te "Lavdërimi i Hijeve" shkruan: "Nuk e shohim bukurinë te vetë sendi por te modeli i hijeve, drita dhe erësira që krijon një send ndaj një tjetri." Pena në dorën time më duket si një fener në labirintin e errët të së shkuarës së parashikueshme. Kur isha fëmijë, ëndërroja që një ditë të shihja hijen e diellit, dhe të qëndroja nën këtë hije, pa prituri askënd, i vetëm, pa fjalë, sikurse do të thoshte Paul Celan-i. Këto ditë, ndiej vetëm hijen e luftërave që më ndjekin si qen endacakë të uritur...

**Belfjore Qose:** Heshtja dhe ritmi i ngadaltë i poezisë suaj na shtyn të mendojmë, ta përjetojmë thellësisht cilëndo situatë. Të njëjtën atmosferë perceptoj te novelat e L. Krasznahorkai-t, në kinematografinë e A. Tarkovskit ose në muzikën e Arvo Part-it. Si ndikoheni ju dhe poezia juaj nga muzika dhe heshtja?


**Nikola Madžirov:** Muzika ka trupin e vet, sikurse dhe teksti ka zërin dhe tingullin e vet. Coltrane-i e kishte zakon të thoshte se në gjuhën e muzikës ai donte të shkëlqenin fjalët. Kurse unë mendoja se nëpërmjet

fjalëve mund të bëja të shkëlqente heshtjen. Arkitekti Peter Zumthor kërkonte lloje të ndryshme heshtjesh por edhe "tingullin anonim" të një qyteti ku është e mundur edhe të gesh qetësi brenda "një oqeani mbrojtës prej tingujsh". Emily Dickinson-i shkroi "Heshtja është pafundësi". Gjyshja ime më thoshte se kur vdesim bëhemi të pafundmë. Kështu, për mua, të jetuarit dhe fjalët janë të barabarta, sepse besoja se heshtja lidhet vetëm me vdekjen dhe simetrinë e varreve. E megjithatë, në varre bërtitet më shumë. Kam pasur jetuar, si shumica e njerëzve në Ballkan, në një shtëpi ku tre breza bashkëjetonin me nja 100 botëkuptime. Fjalët luftonin për të fituar statusin e rëndësisë - ndërsa disa fisnin për kujtime dhe shanset e humbura të jetës, përgjigja nga ana tjetër ishte plot me pritshmëri dhe dëshira të palindura. Në këtë luftë të përditshme me bajonetat e fjalëve, vetëm të dëgjuarit e Arvo Part-it me zë të lartë më krijonte hapësirën për heshtjen e të menduarit.

Duke shkruar, pohoja heshtjen e fjalëve. Paraqitja me shkrim e një imazhi nuk do të thotë ta vesh në kornizë, dhe të paraqitësh me shkrim një tingull nuk do të thotë ta regjistros - është një përpjekje për të ruajtur dinamikën e botës. Grisja e fletëve mund të mbetet demonstrimi më i fuqishëm pamor dhe dëgjimor i luftës së shkrimtarit me vetëcensurën, ndërsa djegia e librave në sheshe do të na kujtonte për fundin dramatik të ndonjë ideologjie. Tani, me një të shtypur butoni, novela e memuarë të tëra, adresa dhe premtime zhduken pa zë... Poezitë e mia i lë mënjanë për një kohë para se të botohen apo përkthehen, ndoshta sepse druaj apo dyshoj se diçka që e ke bartur për një jetë të tërë mund të nxirret brenda pesë apo 10 minutash. I lexoj heshturazi, me zë, në aeroporte, në dhoma të pastra dhe sterile hotelesh, duke u përgatitur për ndarjen me to. Shumë poetë nga Bosnja më kanë treguar se gjatë rrethimit të Sarajevës, në një nga luftërat më mizore të shekullit të kaluar, në mungesë të letërës, i shkruanin poezitë e tyre në anët e gazetave të vjetra, në peceta letre apo letër higjienike, të cilat të gjitha përshkoheshin lehtësisht nga pena, sikurse the trupat përshkoheshin lehtësisht nga plumbta. Kam ndjesinë se poezitë kurrë nuk nisin brenda meje por gjithmonë vijojnë. Çdo varg është lëmuar nga vitet si një gur që lëmohet nga deti.

Megjithatë, për mua, gjeografia më e pastër e pranisë është zëri i pashkruar. Tradita gojore e shtyn tmerrin e historisë zyrtare. Heshtja e traditës gojore është burimi thelbësor i besimit, ndërsa heshtja e mëvonshme u kthye në një pasojë dyshimesh. Besoj se zogjtë heshtin vetëm mbi parvazet e dritareve të njerëzve të cilëve u besojnë. Ose kur ndiejnë se do të nisë bombardimi. Në shkrimet e mia ka një jehonë të largët të gjithë historive dhe këngëve që kam dëgjuar nga gjyshërit para dhe pas ëndërrimit. Fjalë të pashkruara jetojnë në kujtesën time si fluturat që ngordhin kur i prekin.

Heshtja nuk është mungesë. Stockhausen-i në një nga intervistat e tij tha që nuk ka heshtje absolute në botë, që dëshironte të ngjyroste heshtjen, "përpigje përherë të zgjeror marrëdhënien midis tingullit që mungon dhe tingullit që dëgjohet." Ilya Kaminsky shkruan: "Të gjithë poetët e refuzojnë mësymjen e gjuhës. Ky refuzim manifestohet nëpërmjet heshtjes së ndriçuar nga kuptimësitë e leksis-it poetik - jo kuptimet e asaj që shpreh fjala, por të asaj që fsheh." Për këtë arsye, do ta krahasoja të shkruarin e poezive me rënien e rërës në një orë rëre më shumë se me vizatimin e kornizave të kohës. Preferoj më mirë të shkruaj për heshtjen e ndërgjegjësimit të përhershëm sesa të flas për të, duke qenë se të flasësh me zë për heshtjen është si të mbjellësh pemë në oqean. Kur ndalon së foluri mund t'i dëgjosh rrahjet e zemrës.



Në shqip nga Milena Selimi

## 1. Pikëpyetja

Kur njeriu e kap mërzitja dhe habia ekzistenciale domosdo do të meditojë për infinitin e universit, kaosin e kosmosin, sferat qiellore, diellin si burim drite, planetet, e sidomos Tokën tonë, dhe domosdo do t'i përthyejë mendimet në qenien e vet për jetën personale, pra kalimtare, si dhe raportin racional e mistik njëkohësisht me paanësinë e të Krijuarës dhe Krijuesit.

Mendimet e tilla janë aq të vjetra, të themi primordiale, sa që shumë vonë i kap kujtesa e shkrimi njerëzor.

Këto mendime sublimohen në *sofinë* se duhet të ketë pasur një Dashuri, ta quajmë madhështore, që nga *ex-nihiloja* të Krijohet Universumi, relacionet e magjishme të të cilit ende si kap racionalja. Si rrjedhojë, Njeriu në Tokë, si qenie me burimësi nga kjo Dashuri, mbetet gjithnjë në botën e misterit.

Pikëpyetja themelore që bën Zejnullah Rrahmani, për mua, në prozën e tij, *Deti i zi* është pikërisht *aporia* se çfarë relacioni, ndikimi, presioni e pasioni krijon e ushtron Dashuria si Universalitet në Dashurinë njerëzore, personale, në këtë rast në raportin gjenerik mashkull-femër, e cila domosdo për *mjeshttrin e vetmisë* (autorin) përkethehet në dhembje si udhë jetësore e krijimtare.

A është dashuria zanafilla e mirësisë dhe e ligësisë që në Krijim?

A përcillet mjalti dhe pelini i Gjenezës në brezat e pafund të Adamit e Evës?

Nëse miti biblik thotë se mollën e ndalueme e hëngri Eva, mos letërsia që e krijon Zejnullah Rrahmani e përmbys mitin e thotë se mollën e hëngri Adami, si rrjedhojë autori letrar, i cili vuan e shkruan për fajin e pafaj?

A u krijua natyra, toka me të gjitha bukuritë e saj, Kopshti për ta hijeshuar jetën e brezave të Adamit e Evës apo Eva e Adami në mëkatën e tyre i japin kuptim ekzistencës së Kopshtit?

## 2. Deti

Dashuria si Universalitet që sublimohet në personazhet-simbole *Ai* dhe *Ajo* i japin kuptim Kopshtit, si simbol i të gjitha misterve të natyrës.

Nëse mimetika tradicionale natyrën e shihte si shëmbëllim të Dashurisë së Krijuesit, proza simboliste e Zejnullah Rrahmanit dashurinë njerëzore, në gasin e helmin e saj, e sheh si kuptimësim të natyrës. Çfarë vlen natyra, krijimi i natyrës me dashurinë e Krijuesit pa dashurinë e brezave të Adamit, të cilët te kjo prozë e shohin konspirimin e krejt Universit në jetësimin e saj individual si relacion imanent ndërmjet Atij e Asaj! Dashuria në këtë rast është zemra njerëzore, e cila shihet si alter-ego e Kosmosit.

Mirëpo, ku ka dashuri ka edhe dhembje dhe krejt kjo prozë luan me tone të shkëlqyeshme *metonimike* në dualitetin filozofik: natyrë-kulturë, shpirt-trup, dashuri-urrejtje, prani-mungesë, shkrepitja lumturie e dominancë vuajtjeje, tashmë të sublimuara në simbolin e *Detit të zi* jetësor e jo në detin e kaltërt si metaforë tradicionale. Në këtë konceptualitet domosdo teksti do të ruajë shenja biblike e kuranike, dialogim platonian, pikëpyetje filozofike religjioze e mistike, kredhje ekzotike romantike e deri te shenjat e individualizuara letrare, të cilat prozën e shndërrojnë në një *psalm*, në kuptimin e poezisë e hymnizimit të Dashurisë. Dhe më interesantja të gjitha këto të dhëna me relativizëm, ngase autori Zejnullah Rrahmani sikur thotë se të gjitha i njoh, por feja ime është dashuria, si rrjedhojë letërsia, një ngjashmëri e transcendencave me poetin pers Xhelaledin Rumi!

Zejnullah Rrahmani: *Deti i zi*, Onufri, Tiranë, 2022

# GJENEZA: MJALTI E PELINI

nga Nysret Krasniqi

## 3. Simbolikat komplementare

*Pylli i zi* është figurimi i *gjenezës*, ku ndodh grishja, malli, tundimi e pësimi, i cili jepet në formë atemporale nëpër trajtat e objektivimit të natyrës sipas kosmosit të zemrës. Pra, krejt muzika e natyrës merr dritë e kuptim nga reflektimi që i jep dashuria. Një ode sa personale, po aq universale, gjithsesi me tingull specifik të zërit autorial. Mirëpo, simbolika e pyllit sado që lidhet në zinxhirët e bukurisë së natyrës, si intencë nuk ka semantikë të gjelbërimit, ngase pylli është i zi, (vaj e mërzi), pra analog me detin e zi, një parashenjë e përbashkimit të gëzimit me pësimin, me imanencën e Dashurisë. Lexuesi këtu vetëm sa thirret të bëhet dëshmitar e pjesëmarrës në bukurinë e dhembjes, e cila letërsinë e bën me shije, me aromë, me mister, por pa *eidos*, ngase format e racionalitetit janë pushtuar tërësisht nga misteri tejrracional i *erosit*.

*Kroi i bardhë*, gjithsesi duke përbashkuar toposin dhe simbolin, ku semantika e parë jep Prishtinën, ndërsa e dyta mitin religjioz si *krua-rrjedhë* të ekzistencës, figuron *jetën*, e cila diktohet nga trajtat e dashurisë. Kjo e fundit do të bëhet përcaktuese e çdo forme të ekzistencës, ngase shihet si *bosht imagjinar rreth së cilës leviz e merr kuptim çdo gjë*.<sup>1</sup> *Kroi i bardhë* do të poetizojë shfaqjet e mistershme, iracionale të mbretërisë së dashurisë tek individi, gjithnjë duke e shqiptuar intencën autoriale se bota njerëzore do të ishte jashtëzakonisht e varfër po të dominohej tërësisht nga racionaliteti dhe se helmi e gasi i dashurisë në iracionalitetin e vet e bën jetën mozaik ndjesimesh, të cilat e arsyetojnë jetën, pra ekzistencën.

*Illuminimi*, si figurim i procesit të *formimit shpirtëror e intelektual*, jep

1 F. 96.



indicie të tekstit letrar metonimik më të personalizuar. Personazhi-simbol nis e definohet, gjithsesi i mbuluar nga mbretëria e figurës, për të dhënë trajtat e raportit të ndërliqshëm me Dashurinë. Kjo e fundit, inicohet si mister, empiri, veprimtari, objektivim, raport human, impresion e pasion dashuror, ku personazhi-simbol, i cili afrohet me botën lirike të autorit shpeshherë duke qëndruar edhe si alter-ego e intencave të tij, nëpërmjet dhembjeve të ndryshme, e ushtron mjeshturinë e dashurisë e të intelektit, për t'u veçuar, për t'u bërë zë, në jetë e në arte. Këtë singularitet e mbërrin vetëm nëpërmjet përsosjes së mjeshtërisë së dashurisë. Dashuria në këtë proces të pakthyeshmë mbulon sferat metafizike dhe fizike të personazhit-simbol, i cili të gjitha krizat shpirtërore i filtron me mirësinë e dashurisë, pra kjo e fundit e konceptuar si burimësi nga Krijuesi dhe e identifikueshme me Të. Personazhi-simbol duket se është lojtar, herë i vetëdijshëm e herë i pavetëdijshëm, në botën e misterin e dashurisë, ngase që më parë, ndoshta që në udhën metafizike të shpirtërave, e ka pranuar dominimin e saj.

*Tungjatjeta* figurë për stinët e jetës, udhëtimin, ku dashuria bëhet shok i gëzimit dhe i idhnimit duke marrë tipare të ideo-identifikimit. Qoftë si kujtesë, qoftë si empiri apo si përbashkim i gëzimit me hidhërimin, koncepti i mbryjtjes me Dashuri formon e përvijon personalitetin njerëzor, në rastin konkret të personazhit-simbol, të udhëtarit në hapësirat e pamatshme të meditacionit të qenies, i cili duke qenë *shpirt inteligjent* (Platoni) gjithnjë jeton në pelinin e *Detit të zi*. Dashuria është e vërtetë, po aq sa vdekja, dhe domosdo habia për fuqinë e saj përngjasohet me habinë për misterin e vdekjes:

*E kuptojmë që në dashuri jemi si zogu i detit: i lindur për të fluturuar në det. Deti i zi i saj është më i pafund se secili oqean dhe nëpër të janë të shpërndara kontinentet e panjohura: ëndërrimet, pasionet, kurthet, lumturia, magjia dhe vdekja.*<sup>2</sup>

Në fluturimin e përhershëm mbi apo në Oqeanin e saj, personazhi-simbol tashmë ka krijuar besimin personal në madhësinë e saj, besim i cili është përbrendësuar nëpërmjet dhembjeve, krizave, dromcave të lumturisë e vajit të shpirtit, dhembje që domosdo ka krijuar një simfoni shpirtërore, e cila pavarësisht vuajtjeve e ka ruajtur tingëllimin e saj duke u bërë Vepër singulare, e cila i shpërndan jehonat e saj në misteret e jetës si universalitet: Nëpërmjet paradoksit, Zejnullah Rrahmani i falet dashurisë, qoftë e cilësuar edhe si *Deti i zi*, si forcë ndriçuese, divine, madje si udha e vetme e bisedimit e ngushëllimit me Zotin, i cili domosdo për mjeshturinë e vetmisë do të skalitet në vepër letrare:

2 F. 232.

ZEJNULLAH  
RAHMANI



Onufri Tregime

*Ti Dashuri më ndriçove rrugën. Në Dritën tënde kam krijuar, me kujdes filigrani, fjalët të cilat i kam lidhur në varg nëpër libra dhe tash, në fund, me guxim, mund të shikoj në sy secilin që lexon shqip dhe me bindje të them që e kam kënduar Këngën Time të dashurisë...*<sup>3</sup>

Tungjatjeta, simbolika për Librin e jetës së Zejnullah Rrahmanit, pra për Librin e dashurisë së tij, një simbol për Shenjën e tij, qoftë si empiri, qoftë si thirrje për dialogim me të.

Molla është figurim për fuqinë e dashurisë si *pelin*, e cila beftë të rikthen në rini! Ndoshta si validim i filozofemës *njeriu vdes i ri*, apo i *rikuptimësimit të mitit të mollës të Evës*. Krejt teksti metonimik i kësaj pjese narrative-lirike të librit të Zejnullah Rrahmanit ka për reflektim *ringjalljen*, e cila prapë ka për burimësi dashurinë që e mund mërzinë, qoftë edhe me praninë e saj të shkurtër. E poetizuar si forcë e dërguar, divine, me efekte të madhërisme për qenien, qoftë në rikthimin e gëzimit apo të hidhërimit, dashuria këtu *lamentohet*. Hapësira universale dhe mosha atemporale e dashurisë e shfaqur dhe ndërjet në trajtat e sublimuara të bukurisë së trupit dhe shpirtit – është intenca autoriale lamentuese e autorit. Elegji për dashurinë si testament, si rikthim, si kujtesë e si filozofemë e mollës-mëkatit biblik, si një mall i përhershëm i diktuar nga Qiellorja...

A është mëkat ajo që zbret, si në ëndërr, nga forca hyjnore dhe shpirtin e përfshin në *detin e zi* të shpirtit? Mëkati i pamëkat apo faji i pafaj do të tregohen e përshkruhen me stil të hapur dhe emocional për të dëshmuar se edhe *mëkati* është njohje me Zotin!

#### 4. Rrethi

Gjeneza, jeta, njohja e vetnjohja qoftë si universalitet, qoftë si sagë individuale e përbëjnë një rreth të pashpallur kompozicional të kësaj veprë të gjatë në prozë, kur pjesët apo kapitujt janë projektuar si rrrathë planetesh, si figurim me tone të theksuara lirike, të cilët sillen në boshtin e menduar të Dashurisë. Kjo e fundit si shëmbëllim me Diellin; pse jo edhe me Krijuesin.

Si rrjedhojë, leximi i veprës *Deti i zi*, në dukje pa tendencën e sforcimit të ideve, megjithatë ndërton një strukturë implicite, e cila si etikë të saj e figuron idenë e autorit për imanencën e dominancës së Dashurisë dhe të trajtave të saj në honet e Zembrës individuale, por edhe njerëzore në përgjithësi, si thirrje për më pak gjykim e më shumë dashuri. Asnjë njeri i lirë nuk e do robninë e shpirtit, si rrjedhojë kërkesa për lirinë shpirtërore, e sublimuar në fenomenin e Dashurisë, për sq sa është referenciale-autoriale, po aq është edhe universale. Këtu, tashmë dalim te aftësia dhe përgjegjësia e formës e pyesim: Në çfarë forme na e dha Zejnullah Rrahmani në prozën letrare *Deti i zi* konceptin dhe konceptimin e tij për Dashurinë? Duke e përimtuar në lexim këtë formë domosdo do të identifikohemi me të si dhe do të gjejmë shpërtimet tona shpirtërore, të cilat do të mbërrijnë deri në *shkallë katharsisi*. A nuk u tha që nga bota e vjetër aristoteliane se arti i mirë shtron pyetje e kulmon me *katharsis*? E burim i këtij *katharsisi*, për ne, është stili rrëfimtari, përplot lirizëm, që e ka kjo prozë, i cili të mahnit me intimitetin e përjetimit dhe habitjet imagjinative. Po stili është vetë Njeriu, Zejnullah Rrahmani, i cili na mëson të mos frikësohemi *me e hangër mollën e dashurisë!*

“Liria ime”, roman, “Onufri”, Tiranë 2021


# Epidemia e lirisë te Mehmet Kraja

nga Arbër Ahmetaj



Mehmet Kraja, në këtë roman të Mfundit, fillimisht duket sikur po shkruan tregime. Të gjata, disa shumë të gjata. Një qen i vogël në aeroport, i humbur, i pashpresë dhe një mori personazhesh, që qendër gravitacioni kanë aeroportin, si “no man’s land”, por që tërhiqen nga një fuqi tjetër e errët, po aq e enigmatike sa ajo e gravitacionit, pësia e kujtimeve, e së shkuarës së tyre. Aeroporti shërben si nyje apo si pikë nisjeje drejt së ardhmes, e cila aq pashpirtshëm i ngjan së shkuarës. Ikin

deri në Irlandë, Gjermani, Zvicër, veç si te skena e fundit e pjesës së *Becket*, “Duke pritur Godonë”, ku personazhet duan të nisen, të ikin, ngrejnë një hap e ngrijnë, gozhdohen aty. Presin zotin. Po personazhet e këtij romani çfarë presin? Liria ka ardhur. E shkuara e tyre rikthehet jo veç në të tanishmen e tyre, por përbën edhe horizontin e së nesërmes. Jeta e Halil Demajt, Sabit Ymerit, Hysen Ramës, Nazlijes, Bujar Sylës, Muharrem Marmelushës, Selim Krasniqit, burrit të Sanijes, Afërditës



së qenit dhe e vetë atij qenushi vjen në roman me një intensitet e ngjyra të forta, por duke qenë se jeta e tyre ka qenë krejtësisht e pavlefshme, lexuesit i duket herë-herë se jetë të tilla s’meritojnë jo të sillen në letërsi, por as të jetojnë. Po, siç kuptohet gjatë leximit, ky është kurthi stilistik, kjo është mjeshtëria e autorit, pasi duke sjellë përbuzjen që ata kanë për jetët e tyre, na kujton se shpesh në jetë bëjmë edhe ne si ato personazhe: u dorëzohemi iluzioneve, ideologjive, ndjesive të trupit e kënaqjes së tyre të pafre. Nganjëherë hedhim në letër ato që jetojmë e na kap deliri se jemi autorë të ndonjëfarë dorëshkrimi me vlera të përbotshme e herë tjetër, ajo që na ndodh ta jetojmë, na duket aq e jashtëzakonshme sa mendojmë se të gjitha enciklopeditë e botuara të nesërmen do ta përmendin me domosdo emrin tonë. E nuk dorëzohemi asnjëherë në udhën e mrekullueshme të budallallëkut e të kotësisë. Ka personazhe që kanë bërë edhe vepra heroike, kanë marrë pjesë në ngjarje të mëdha, për të cilat as që i bie kujt ndërmend. Dëshpërimi i tyre na bën të qeshim, pasi autori s’ka dashur t’i mbështjellë me tragjizëm, madje e ka shmangur me shumë finesë gjykimin për ta. Janë personazhe me të cilët s’do të donim të identifikoheshim si lexues, por që, gjithsesi, na tërheqin e na mësojnë shumëçka nga palumturia e tyre (e jona). “Liria ime” nuk është roman i rrëfimit të një ngjarjeje që të mahnit, por i një stili që të përpin. Edhe pse diskrete, prania e autorit futet në rrëfim duke hutuar lexuesin, i cili, deri në ato çaste, mendonte se ka një narrator. Kjo bëhet aq e këndshme, sidomos kur në rrëfim vijnë emra konkretë figurash publike të botës shqiptare, të cilët, ashtu papritmas, përmbysin situatën e trishtë të personazheve e vezullojnë në një çast humori të këndshëm, pasi emri i përmendur, në shumicën e rasteve, as që ka lidhje me ato që rrëfohen. “...thuhej se udhëzimet për demonstratat e vitit 1981, organizatorët i kishin marrë nga një profesor i Tiranës, Androkli Kostallari... por, nuk e kishte të qartë se çfarë lidhjeje kishte kjo me Aidën, që nuk kishte qenë e virgjër natën e parë të martesës”. Një personazh është i bindur që *Zoti është fashist*, ndërsa një tjetri i duket se *jeta e tij kishte qenë e shkurtër dhe e komplikuar, si epitaf mbi varrin e një komunisti*. Keqkuptimet e këtyre personazheve janë vërtet të trishta për ta, por lexuesit i mbeten në mend, pasi një lloj humori i lehtë, i paqëllimshëm, krijohet gati në çdo faqe. E kjo është një cilësi shumë e mirë e shkrimit të Mehmet Krajës. Gjithë ajo zymti s’do ishte përballuar dot pa këtë element elegant të shkrimit. Ekonomia e dritës, mungesa e ngjyrave, lëvizja e somnambulët e karaktereve, ritmi i brendshëm i shkrimit, fjalitë e gjata dhe thyerjet e befta e shndërrojnë këtë tekst në një skenar filmik të konceptuar për të shkaktuar drithërima. Kjo mjeshtri shkrimi s’vjen si habi, pasi Kraja ka shkruar katërmbëdhjetë romane, pesë libra me tregime e disa pjesë teatrore. Nganjëherë kam dëshirë ta reduktoj numrin e fjalëve për një libër, në një fjali të thjeshtë: Lexova një libër të bukur! “Liria ime” është roman që kënaq shijet estetike, që e bën mendjen të reflektojë e zemrën të ndjekë me drithërima rrëfimin: tri përmasa që bashkohen rrallë në tekstet e letërsisë shqipe.

Duket se 50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 20 – 25 nëntor 1972) nuk po afrohet në *zoom* ashtu siç është, me dritëhijet e veta. Njihet si kuvend shkencor, pritet me u vështruar në mënyrë shkencore. Emocionet gjithsesi janë ftohur, njerëzit e sotëm janë më pak të indoktrinuar. Është rasti që ngjarja të pastrohet nga grim i një shtëpie politike me drita të kuqe e të trajtohet ashtu siç është, me bukuritë dhe vratat e fytyrës. Të paraqitet në një dritë natyrore, pa regji. (S)a po ndodh?

Ata që shohin përkryerjen të Kongresi, mbulojnë me terr të vërteta të rëndësishme.

### Thonë 1:

Ngjarje historike madhore, Shqipëria u bë me "gjuhë të njësuar", me "gjuhë letrare". Me terminologjinë e parapëlqyer sot, me gjuhë të standardizuar.

U bë me "gjuhë të njësuar"?

Por Shqipëria e kishte tashmë "gjuhën e njësuar". Të pranuar mirashejtaz prej të gjithë shqiptarëve, në Veri e në Jug. Themelet qenë shtuar fill pas pavarësisë, nga Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1918). Vepër e mendjeve më të ndriçuar nga Veriu dhe Jugu i Shqipërisë. Me këshilltarë dy dijetarë europianë, albanologun e mirënjohur Maximilian Lambert, i Vjenës (1882-1963) dhe Rajko Nachtigal (1877-1958), akademik i Gracit, me ndihmesë edhe në albanologji. Për shkak të rrethanave politike të kohës, nuk merrnin dot pjesë përfaqësues nga Kosova.

Ani pse emrat më të njohur të Komisionit ishin nga Shkodra e Komisia u mblodh në Shkodër; ani pse shkodranishtja, me një gegnishte të afërt me të, rrinte në krye për traditën më të gjatë të lëvrimin; ani pse austriakët e kishin për zemër Shkodrën me katolicizmin si fe e si kulturë; Komisia prapëseprapë si bazë të drejtshkrimit nuk përzgjedhi shkodranishten. Ajo përzgjedhi të folmen e Elbasanit. Ishte një zgjidhje pajtuese, bashkuere. E folmja e Elbasanit do të ishte urë lidhëse ndërmjet toskërishtes e gegnishtes. E hapur për vlerat e të dy dialekteve.

Për kah kapacitetet ditore dhe vepra që kreu, Komisia mund të quhet e para akademi shqiptare e shkencave. Me anëtarë meritore, jo të emëruar. Standardin e Komisionit e mbështeti Zogu (dekreti i vitit 1923 e më pas), e mbështetën qeveritë nën fashizmin (Instituti i Studimeve shqiptare, 1940-1944). Deri në 1972 ky standard përdorej edhe në Kosovë, në administratë, në shtyp e në radiotelevizion, në shkollë. Madje, shkruan akademik Rexhep Ismajli, "Ajo që flasim në Kosovë... në shoqëri, në familje, në situata formale, më shpesh gjysmëformale, nuk është e folmja lokale e akcilitit prej nesh... por thjesht një gegërishte relativisht e standardizuar...".

Pse u shemb projekti i gjithëpranuar i Komisionit?

Ata që vazhdojnë duartrokitjet për Kongresin, nuk pipëtojnë rreth kësaj pse-je. Nuk thonë një fjalë për ç'arsye u gremis ngrehina gjuhësore e konsoliduar e Komisionit. Ku kishte ngecur, çfarë nuk shkonte në të, pse duhej rroposur për të filluar rishtazi nga e para.

Para se me planëzue shtëpi të re në një truall, duhet shpjeguar pse u dashka prishur shtëpia që është në atë truall; për më tepër vepër arkitektësh në zë, ku banorët ndihen fare mirë.

Pse pra?

Nuk mund të gjejnë argumente për të përligjur rrënimin e standardit të Komisionit. Zgjedhin heshtjen, e kalojnë sikur s'ka ndodhur gjë.

### Thonë 2:

Përzgjedhja e bazës dialektore të "gjuhës së njësuar" pas Luftës së Dytë u bë për arsye gjuhësore dhe jashtëgjuhësore.

Si arsye gjuhësore përmendet trajta letrare e toskërishtes. Thonë ajo ka qenë më e përpunuar.

Mbi ç'kriter mbështetet ky pohim? Më së pakti, për të qenë të kujdesshëm, mund të thuhet se shkalla e përgatitjes së njërit ose tjetrit dialekt për të shërbyer si bazë e një shqipeje të standardizuar, është çështje e diskutueshme. Gegnishtja, a s'kishte mbërri kulmin me Fishtë, Mjedën, Migjenin, Koliqin, Arshi Pipën, Martin Camajn? A s'e kishte një traditë shkrimi pesëqindvjeçare? Një gegnishte më e përgjithshme, ajo e Komisionit, a nuk pati zënë rrënjë si kurrnjë tjetër në krejt hapësirat shqiptare? Në Kosovë qe shtrirë edhe në letërsinë artistike.

# KONGRESI I DREJTSHKRIMIT, PA GRIM

nga Mehmet Elezi



Si arsye jashtëgjuhësore, për herë të parë përmendet një statistikë e vitit 1927 për vijimin e shkollave. Aty del se numri i njerëzve të shkolluar në bashkitë e Jugut ishte më i madh se numri i njerëzve të shkolluar në bashkitë e Veriut; kësaj, procesi i zhvillimit të "shqipes letrare" pas luftës, thuhet, nuk ishte pasojë e ndonjë shtrëngimi, ai ishte pasojë e natyrshme e gjendjes kulturore-arsimore.

Këtij "argumenti" i dridhen gjunjtë në mënyrë të pashërueshme, ai rrëzohet përballë një qasjeje serioze, profesionale. Nuk dihet ndonjë vend i botës, ku përzgjedhja e bazës dialektore për standardin e gjuhës kombëtare është bërë duke krahasuar numrin e llogaritave, teknikëve e togerëve. Këqyret e shqyrtohet diçka thelbësore: sa numri i njerëzve të shkolluar është përkthyer në lëvrimin e gjuhës amtare, në përhapjen e dijes, në zhvillimin e letërsisë, në botime artistike e shkencore, në shtyp, në kulturë. Argumente mund të kërkohen te përgjigjja e kësaj pyetjeje, jo te statistikën e nxënësve që ndjekin shkollën (në Shqipëri s'kishte shkollë të larta).

Këtij "argumenti" i dridhen gjunjtë në mënyrë të pashërueshme, ai s'përballon dot një pyetje të vetme: a nuk ishte e njëjta gjendje kulturore arsimore e vitit 1927, kur standardi i Komisionit, mbi një bazë dialektore geqe (elbasanishtja), mori hov e po shkonte drejt konsolidimit përfundimtar? Natyrshëm, i gjithëpranuar pa kurrfarë shtrëngimi?

Dhe e fundit, vetë statistika e cituar është e paplotë, e mangët. (S)a janë përfshirë në të shkollat katolike? Në shkollat katolike është formuar një elitë e tërë, pa të cilën krejt kultura shqiptare do të ishte e gjymtuar. Në krye të kësaj elite shkelqejnë emra të mëdhenj të mendimit, të dijes e të letrave shqipe, që dihen prej gjithkujt.

Njerëzit e dijes përballen me të vërtetat, nuk i zbukurojnë e nuk i hijeshojnë, nuk i shtrembërojnë.

Faktet dëshmojnë se projekti i Komisionit u shemb me vendim politik. Ani pse kish qenë mjaft i suksesshëm. Me gjuhën amtare u luajt si me kampionatet e futbollit, numrimi i të cilave mbas Luftës së Dytë nisi nga zeroja. Se para "çlirimit" futbollit s'kishte qenë futboll! Gegnishtja kishte "biografi të keqe". Ajo kish marrë trajtë kryesisht në krijimtarinë letrare të priftërinjve katolikë, që luftonin për një Shqipëri perëndimore. Ishte lëvruar kryesisht në Shkodër, qytet qëndrestar kundërkomunist. Shkodrën e Malsinë e saj, fill pas "çlirimit", i kishte pushtuar Mehmet Shehu me urdhër të Enver Hoxhës, duke i kaluar formacionet luftarakë nëpër Jugosllavi, në marrëveshje me Jugosllavinë, për t'i goditur prapa shpine shqiptarët në Shqipëri. E folmja e Elbasanit nuk ishte shkodranishtja, por për shkak të trajtave

të përbashkëta geqe, nuk mund të kishte tjetër fat.

Në veprën "Në gjuhë dhe "për gjuhë" (Dukagjini, Pejë, 2002) akademik Rexhep Ismajli i bën një skaner të ftohtë pistës, nëpër të cilën makineria e Tiranës mori hov drejt "gjuhës letrare". Vërehet se në dy sesione gjuhësore të Institutit të Shkencave, mbajtur njëri pas tjetrit brenda tetë muajsh (janar dhe shtator 1952), flitet më fort politikisht e më pak shkencërisht. Në sesionin e parë: "Veprat e shokut Stalin mbi gjuhësinë dhe problemet tona gjuhësore në dritën e këtyre veprave" (26-29 janar 1952) u deklarua se "juga nxori udhëheqësit kryesorë e më të shumtë të lëvizjes, ajo i dha kuadrat më të shumta", ndaj përparësinë do ta kishte dialekti jugor. "Fakti që fjala e Partisë sonë të Punës gjatë luftës nacl. çl. u tha në toskërisht... fakti që sot i tërë populli është mobilizuar me këtë fjalë të Partisë n'akcione të mëdha për ndërtimin e bazave të socializmit... vetë këto fakte tregojnë se populli ynë, me gjithë dialektet që flet, ka një gjuhë kombëtare të përbashkët që përfaqësohet prej toskërishtes".

Në referat e në diskutime u vlerësua se:

- gjuha e "Buzukut e e Budit me shokë" i përkiste "feudalizmit e fiseve";

- shkodranishtja ishte "gjuhë e klerit reaksionar", që synonte "zëvendësimin e një pushtuesi me një tjetër";

- udha e hapur prej Komisionit Letrare Shqipe ishte "vepër e Austrisë, e Zogut (!) dhe e Italisë". Po tejkalohet edhe vetë Stalini, që kishte thënë se gjuha s'ka karakter klasor!

Duke parë se argumentet profesionale nuk po hynin në punë, A. Xhuvani rreket me përdorë të njëjtat armë, që po përdornin zëdhënësit e pushtetit. "Sikurse ka thënë J. V. Stalini, thekson ai, "marksizmi nuk pranon eksplozione të papritura në zhvillimin e gjuhës". Me "eksplozion" ka parasysh ndërrimin e menjëhershëm të bazës dialektore të gjuhës zyrtare, pas vitit 1945. Në një imtë dëshpërimi, Xhuvani shpërthen: gegnishten "nuk asht kollaj me e qasë më njanë si gunë të vjetër ose me e çue në muze!"

Në vitet që pasuan, deri në Kongresin e Drejtshkrimit, retorika zyrtare u moderua, por politika gjuhësore jo. Politika gjuhësore mbeti e njëjtë.

Çështja nuk është pse u vu në bazë toskërishtja. Si toskërishtja, si gegërishtja, janë gjuhë shqipe, ato janë njësoj të çmuara për çdo shqiptar. Çështja është është pse për gegnishten u gjyka politikisht e jo gjuhësisht; dhe pse vlera të pazëvendësueshme të gjuhës shqipe në dialektin gegë, u përjashtuan artificialisht.

Rrekja me u kapë te numri i nxënësve, që kanë ndjekur shkollën, është rihedhje në treg e

tezës jo aq atdhedashëse për "epërsinë jugut ndaj veriut". Tashmë nëpërmjet një alibie kulturore, që shtërzen prej sforcimit. Nëpërmjet një "look-u" modern, produkt klinikash (jo)estetike.

### Thonë 3:

Përcaktuese ishin relievet e dialekteve. Me fjalë të tjera: ndryshimet ndërmjet nëndialekteve të gegnishtes, më të theksuara se ndryshimet ndërmjet nëndialekteve të toskërishtes, e largonin mundësinë e një standardizimi të gjuhës shqipe mbi bazën e dialektit gegë.

Të dhënat tregojnë tjetër gjë për ndikimin e këtyre relieveve.

A nuk është i njëjti dialekt gegë me relief më të përthyer, që u tregua elastik e i hapur, u standardizua nga Komisia dhe po ecte për bukuri? Kurrfarë ngecjeje nuk pati.

"Ortografia e gjuhës shqipe" e Prishtinës (1964) është tjetër dëshmi kryefortë. Në hartimin e saj bashkëpunuan edhe gjuhëtarë nga Maqedonia, ku gegnishtja përthyeret më fort se kudo me diftongimin e zanoreve. Në Dibër, në Tetovë e më gjerë, thuhet *majr* për *mirë*, *moj sajjëz* (kujtojmë grupin *Elita 5*) për *moj syzezë*. Ia dolën përsëri, kurrfarë ngecjeje.

Elasticiteti dhe hapja e gjuhës shqipe në dialektin gegë spikatin qysh në fillimet e shkrimit shqip. Çabej shkruan se te autorët e vjetër shqiptarë "me Gjon Buzukun në krye", vihet re "më një anë një shkallë mjaft e përpunuar e gjuhës, një gjuhë letrare, më anë tjetër një formë gjuhësore me tipare mjaft të përbashkëta...". Ai nxjerr përfundimin se "këta autorë nuk kanë shkruar në dialekt me kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Ata kanë shkruar në një formë mbidialektore të gjuhës...". Bogdani (1625-1689), hasian i rrethit të Prizrenit, nuk i rri besnik asaj që quhet kosovarishte. Ndjek gjedhen e shqipes letrare të përdorur në Shkodër e rrethe, duke e pasuruar me kosovarizma e me krijimet e veta. Shkruan se i është dashur që "me djersë të mëdha" të nxirrte në dritë "shumë fjalë plaka e të harruara" dhe po ashtu të shtinte në përdorim fjalë që përdorshin "në dhë të Shkodrës". Gjuha e autorëve të vjetër, shkruan Idriz Ajeti, përbën një farë "koineje" të Shqipërisë veriore. Çabej del me përfundimin se gegërishtja e shekujve të 16-të - 17-të ka qenë "më unitare dhe më afër toskërishtes".

### Thonë 4:

Së fundi këmbëngulin: gjithçka u vendos në një kuvend shkencor, në Kongresin e Drejtshkrimit.

Por a është kështu?

Nuk di sa mund të quhet shkencor një tubim, ku kurrkush nuk mund të shprehë një mendim ndryshe. Delegatët nuk kishin aty të drejtë me shpalue ndonjë qasje tjetër, sado modeste. Kongresi u thirr pas faktit të kryer. Rregullat e drejtshkrimit ishin përcaktuar, për to ishte bërë edhe "diskutim popullor". Duhej vetëm vula. Pjesëmarrësit ishin thirrur për ta duartrokitur. Telekranit oruellian vëzhgonte prapa zverkut të secilit.

Në Kongresin e Manastirit (1908) qenë paraqitur dy alfabetet. Atje organizatorët dhe pjesëmarrësit ishin njerëz të lirë. Ndërsa në Kongresin e Drejtshkrimit nuk u lejua një projekt alternativ, as sa me la gojën. *Ortografia e gjuhës shqipe* (1964), e hartuar nga akademikët në Prishtinë, ishte vepër shkencore e mirëfilltë. Përfaqësonte vazhdimësinë, pa "eksplozione". Në gjurmët e Komisionit, rregullat e *Ortografisë* bazohen në dialektin gegë, por afrohen me toskërishten më fort se çdo projekt parandej. Një sy nuk iu hodh. As sa për sy e faqe. Nuk u përmend kund qenia e tij.

Nuk di sa mund të quhet shkencor një tubim, ku pjesëmarrësit nuk ishin ftuar sipas ndihmesës e kapacitetit shkencor, por sipas kredencialeve politike. Kongresi i mbylli me gjakftohtësi dyert për emra të shquar të dijes, që jetonin në Shqipëri në hije. Midis mungestarëve të mëdhenj spikat një personalitet si Selman Riza. Mendje e rrallë, që Tirana e Beogradi ia gjuanin shoqi-shoqit nga burgu në burg, si top futbollit. Mbasi qe lëshuar mbi të një rrungajë (ortek) përmblytëse fletërrufesh në universitet, profesori i madh qe degdisur ciceron muzeu në një rreth, pa të drejtë fjalë si shkencëtar.

As që bëhej fjalë me u ftue dijetarë me vepra nga mërgata, si Martin Camaj, Arshi Pipa, Namik Resuli, Atë Zef Valentini, Karl Gurakuqi.







I riktheva me dëshirë këtë verë, pas rreth 30 vjetësh, romanit të Mustafajt. Duke e shndërruar, ma lejoni këtë lojë fjalësh, në Verë me kthim, atë që ishte pa kthim. Dhe isha kurjoz për shumë arsye. Doja të kuptoja nëse i kish rezistuar kohës. Gjithashtu çdo të mendoja tani, duke e rilexuar librin me këtë formim, me këtë pjekuri, me këtë sistem shijesh të tanishme, me këtë eksperiencë jete. 30 vjet janë 30 vjet. Shumë libra, që dikur më mahnisin, rileximi i tyre më kishte zhgënjyer disi.

Fillova ta lexoj me një nostalgji të sinqertë. Ndoshta nga fakti se aty brenda përshkruhen edhe ngjarje, sjellje, mendime si atëherë, kur jetonim në një tjetër ambient, në një tjetër shoqëri, në një tjetër kontekst social, ekonomik dhe shoqëror. Mu ngjit në shpirt një melankoni e çuditshme për kohën që ikën. Kohën pa kthim të asaj epoke aq të largët. Po më dukej si një botë, të cilën e kisha parë veç në ëndërr.

Që në fillim, si dikur, filloi të më bënte përshtypje ngjeshja, dendësia stilistike, kërkimi i fjalës, bukuria e frazave plot harmoni, detajet e goditura, shqipja e bukur dhe e rrjedhshme. Dhe sidomos loja. Ky roman ka një lojë të çuditshme. Një lojë delikate, ku lexuesi zbavitet duke ecur gjatë leximit, si mbi majën e një filli peri fare të brishtë. Mjafton një shkarje e vogël, një humbje drejtpeshimi dhe gjithçka rrënohet. Aq me kujdes ecet aty pra, si të ecje mes jetës dhe vdekjes. Mes të vërtetës dhe trillimit. Mes ëndrrës dhe realitetit.

Me dukej sikur edhe unë vetë po ecja buzë një gremine.

Njëloj si një pararojë, e cila me kujdes eksploron, vëzhgon, shkel çdo shteg, hulumton çdo rrugë, çdo cep, çdo dimension të mundshëm. Po ashtu edhe autori ka eksploruar me kujdes gjithçka përreth universit të tij. Si dhe raportit të çuditshëm, që lidh të dy protagonistët: Sanës dhe Gorit.

E para, Sana, gruaja e lodhur së prituri besnikërisht një të fejuar, bashkëshortin e ardhshëm, që ajo e dashuronte marrëzisht. I dyti. Gori i cili kthehet ta takojë, por është një kthim i çuditshëm, fare i pazakontë, por edhe intrigues dhe i mbushur plot me të papritura.

Tek lexon romanin, lexuesit i duket sikur autori orvatet të eksplorojë gjithashtu edhe marrëdhënjet misterioze mes dy botësh. Ai nuk lë pas dore asnjë detaj. Nuk lë pa vëzhguar me vëmendje asnjë grimcë jete. Duket qartë që kujdesi i autorit gjatë shkrimit ka qenë ekstrem.

Me një precizjon gati manjakal, shkrimtari loz bukur me këtë lidhje mes dy botësh. Asaj onirike, fantastike, misterioze, dhe asaj të të gjallëve, që njohim.

Gori ka të gjitha karakteristikat e njeriut hije. Njeriut të përtej jetës, krejt të zhveshur nga pasjonet njerëzore. Autori e trajton me shumë përqendrim dhe mençuri figurën e çiftit gjithnjë në evolucion.

E pranon a nuk e pranon lexuesi këtë lloj mardhënie të çuditshme dhe të parregullt mes tyre, kjo është një nga çështjet e librit. Ajo imponohet mbas çdo faqeje, mbas çdo kapitulli. A është e besueshme ngjarja? Si do të vazhdojë? Sa do të na bëjë kurjozë? Ku do të dalë autori? Ç'do vallë të transmetojë ai te lexuesi? Ç'kumt? Ç'ide? Ç'iluzion fantastik? Ndoshta do të thotë se botët

Mbresa nga një rilexim pas 30 vjetësh i romanit të mirënjohur të Besnik Mustafajt

## Rikthim te “Vera pa kthim”

Nga Artur Spanjoli



janë aq afër njëra tjetrës? Apo dashuria mposht gjithçka?

Kjo ishte edhe një nga sfidat më të vështira të librit, të cilën autori besoj e ka kaluar me sukses.

Loja mes të pranueshmes dhe të pa pranueshmes, reales dhe fantastikes, të besueshmes dhe të mosbesueshmes, bindëses dhe jo bindëses është një lojë delikate, e cila jo vetëm nuk i ndahet për asnjë çast lexuesit, por e intrigon, e josh, e nxit dhe e mbush atë me kureshtje. Por edhe duhet kujdes. Shumë kujdes. Ideja është e bukur. Gjetja artistike është e rrallë, fantastike. Në fund ajo bëhet edhe bindëse.

Gjuha është e pasur. Ecuria e ngjarjes është e ngadaltë, e qetë, e pandërprerë. Si ritmi i jetës së dikurshme, kur jetonim

nën dhunë. Edhe nga ana stilistike, romani është ndërtuar mirë.

E vetmja kritikë që mund t'i bëj romanit është, ndoshta, se autori, mund t'i thjeshtonte sado pak disa kalime përshkrimesh, për t'i dhënë ngjarjes, historisë më dinamizëm, më ritëm narrativ. Herë herë tensioni bie dhe lexuesi rrezikon të futet në një zonë gri, të njëtrajtshme. Por më pas, kjo përshtypje tretet krejt.

Për si e shihnim ne letërsinë aso kohe, ky roman dalë nga shtëpia botuese “Naim Frashëri” në 1989, ka qenë një ngjarje vërtet e rëndësishme për letërsinë shqipe të atyre viteve.

Mënyra e shkrimit sillte një koncept fare të ri dhe surreal në botën e letrave shqipe, dhe ishim akoma para rënjes së

diktaturës.

Romani, i shkruar në vitin 1985, ishte vërtet një sfidë e vështirë edhe nga pikpamja letrare. Një roman me një tematikë delikate për t'u trajtuar, sepse mungonin krejt si bazat, po ashtu edhe tradita për kësi lloj subjektsh kryekëput fantastike, surrealistike, ekzistencialiste. Ndaj gjithçka duhej krijuar nga e para, me fantazi, me intuitë, me një logjikë të ftohtë, duke u mbështetur mirë në folklor.

Loja nuk ishte thjesht për një personazh kaq absurd, kaq të tjetërlojtë. Personazh hije, i cili kthehet nga përtej jeta... Shkrimtari pra edhe mund të dështonte. Sfidë ishte e qartë. Duke i mëshuar fort idesë së kthimit, plotësimit të dashurisë së porealizuar, dhe sidomos pritjes pa fund të protagonistes. Gjejmë në libër, si elemente të baladës së mbajtjes së fjalës së dhënë, por edhe elementë të mitologjisë greke. Ajo e pritjes. Sana e ka pritur me devocion burrin e saj. Krejt si një Penelopë e vërtetë.


Jam i sigurt se ky roman do t'i mbijetojë harresës.

Jo vetëm për kujdesin, dashurinë dhe përkushtimin, që autori i ka kushtuar çdo faqeje të librit, por mbi të gjitha për tematikën dhe idenë e madhe të Realizimit të Dashurisë. Dashuria mund edhe vetë ligjet e vdekjes si në baladën e vjetër shqiptare. Ajo e kthen të pamundurën në të mundur. Absurden në realitet.

Metaforë e ëndërrës, e dëshirës së zjarrtë të dashurisë dhe besnikërisë, ajo e tejkalon, mposht pra deri edhe tretjen e mishit.

“Vera pa kthim” është gjithashtu edhe metafora e realizimit të një ëndërrë. Është balada e Kostandinit, parë me sytë e kohërave tona moderne. Është vazhdimësia e mitit të Penelopës, ku Gori, në vend të hakmarrjes prej Uliksi kundër bukëshkalëve proçë, na sjell në libër një ekzistencë të dykuptimtë dhe fare të çuditshme. Indiferent si i Huaji i Kamysë, i ftohtë si ndonjë personazh i Shekspirit. I çuditshëm si personazhet e Kafkës, ky roman është një libër delikat dhe i zhdërvjellët. Aty fantastikja i bashkangjitet reales në çdo çast, dhe ku autori di të lozë si në teh të briskut. Ngjarja shkon natyrshëm, sa drejt magjikes dhe absurdes, po aq dhe drejt së përditshmes dhe monotones.

Ky libër, në mos i pari, ishte një nga librat e parë që i dhanë një drejtim të ri, më modern dhe bashkëkohor letërsisë shqiptare fill mbas rënjes së diktaturës. Gjithashtu e prezantoi shkrimtarin në atdhe dhe në botë si një nga personalitetet më të spikatura në universin e letrave shqiptare.



## Për autorin

Adnan Ismaili njihet në disa fusha krijuese dhe akademike të cilat ndërlidhen me veprimtari të shumta dhe të suksesshme, falë përkushtimit dhe kontributit të tij të pakursyer. Në radhë të parë, Adnan Ismaili, është autor tekstesh të arabishtes, përkthyes, themelues i Katedrës së Orientalistikës në Universitetin e Tetovës, ku vazhdon punën e profesorit.

Gjithsesi, kurorëzimi i veprimtarisë së tij në fushën e botimeve është funksionalizuar në Shtëpinë Botuese "Logos-A", pa dyshim, një nga ndërmarrjet botuese më të njohura në Ballkan e cila shquhet me vlerën e botimeve sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare.

## Për strukturën e veprës

Çdo studim qëllimin kryesor e funksionalizon në analizën dhe sintezën e vlerave letrare, estetike, stilistike, gjuhësore, figurative, etj., e veprave të veçanta, por edhe në trajtimin e fenomeneve të ndryshme të letërsisë, duke i detajizuar kërkimet në nivelin shkencor, pikërisht me shenjat e avancimit të metodave më produktive të cilat e nënkuptojnë vlerësimin shterues.

Vepra studimore "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe" e Adnan Ismailit shquhet me artikullimin e qartë të koncepteve kritike të cilat paraqiten në rrafshin e ideve, domethënies dhe përbërësve të tjerë që kanë të bëjnë me mbarështrimin e përmbajtjes duke iu referuar një njohjeje të dëshmuar në një plan më të gjerë, aty ku ndërtohet modeli i qasjes për të na ofruar të dhëna të reja.

Në këtë mënyrë është arritur të realizohet një projekt i rëndësishëm i cili ka për qëllim kryesor të ofrojë informacione të rëndësia me shembuj përkatës gjithnjë në funksion të zbrëthimit të problematikës së shqyrtuar deri në kërkimin e thellësive kuptimore që kanë të bëjnë edhe me terminologjinë, gjuhën, stilin, por edhe me dimensione e domethënie të tjera në kuadër të perspektivës së studimit.

Shpjegimi i esencave të veprës studimore "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe" parashtrrohet përbrenda tetë pjesëve të sistemuara qartë dhe saktë, pikërisht aty ku takohen teoria e interpretimit me specifikën e letërsisë. Prandaj në këtë mënyrë shpjegohet tërë tematika e ndërlidhur me Jusufin dhe Zelianë, filluar nga konteksti historik për të mbërritur deri te ndikimi në vepra të caktuara të autorëve, siç janë veprat e Muhamet Çamit, Çajupit, Hafiz Ali Korçës, etj.

Me kërkimet e tij, Adnan Ismaili, e ka përcaktuar qasjen përbrenda kontekstit tematik dhe estetik, për t'i parashtruar pikat e veçanta duke i gjetur pikat e përbashkëta, kryesisht përmes dy metodave: metodës analitike dhe metodës krahasimtare, madje duke i vështruar përkimet dhe dallimet përbrenda një sfondi të gjerë të shqyrtimit të përmbajtjeve dhe domethënies që bëhen pikë referimi në secilën fazë të interpretimit. Kjo i hap udhë studiuesit për të vazhduar me konkretizimin e analizës letrare nga kapitulli në kapitull.


Tri pjesët e para të veprës "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe", përqendrohen në tematikën e caktuar, kryesisht të ndërlidhura me përshkrimin e jetës së Jusufit dhe të familjes së tij, si dhe me rolin e Jusufit përbrenda rrethanave shoqërore-historike në Egjipt. Më tutje, shtjellohet tregimi për Jusufin, duke iu referuar Librave të Shenjtë. Aty ku ka evidencime ngjarjesh dhe veprimesh, saktësohen karakterizime e tipizime personazhesh.

Pjesa e tretë e ka për objekt studimi interesimin e popujve të Lindjes për tregimin e Jusufit dhe Zelihasë, përkatësisht praninë e kësaj tematike në letërsinë arabe,

Adnan Ismaili: "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe", Alsar

## SINTEZA E VËSHTRIMIT ANALITIK DHE KRAHASIMTAR

Nga Sali Bashota



persiane dhe turke, ndërkaq në pjesën e katërt shqyrtohet letërsia islame me alfabet arab.

Në pjesën e pestë të veprës studimore "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe", argumentohen kërkimet e studiuesit për të saktësuar më qartë problematikën e shqyrtimit të motiveve dhe temave që paraqesin relacione interesante me veprën "Jusufi dhe Zylejhaja" të Muhamet Çamit në letërsinë shqipe. Për më tepër, janë një varg çështjesh që e përcaktojnë modelin e qasjes, por edhe praninë e kësaj vepre, si dhe ndikimin estetik në rrjedhat dhe zhvillimet e letërsisë.

Në këtë rrjedhë të vlerësimit kritik, pikëpamjet e studiuesit fuqizohen në kontekst me temën kryesore, siç është tema erotike. Analiza letrare për poemat "Jusufi e Zulejhaja" të Muhamet Çamit,

"Jusufi me Zelianë a më e bukura e ngjarjeve" të Hafiz Ali Korçës dhe poezia "Zolejka" e Çajupit, paraqesin shembuj të qëlluar dhe të realizuar përmes të cilëve funksionalizohet kodi apo shenja letrare ku atribut kryesor është modaliteti i rrëfimit nga këndvështrimi perspektiv i studiuesit.

Pjesa e shtatë dhe e tetë janë mbarështruar kryesisht në tregimin për Jusufin me Zelianë. Në këtë drejtim, studimi krahasimtar i ka dhënë një mundësi me efekt dobiprurës në mënyrë që studiuesi të merret më konkretisht me vepra të caktuara që e kanë tematikën e përqendruar të tregimit për Jusufin dhe Zelianë. Po kështu, pikënisjet dhe përfundimet i bashkon krahasimi i zgjedhur, si te Çami, si te Korça, si te Çajupi. Jepen shumë shembuj, por edhe variante të pjesëve të zgjedhura të poemave në të cilat trajtohet jeta e Jusufit dhe Zelihasë,

pastaj ëndrra, pafajësia, zilia, zhdukja, burgosja, vuajtja, martesë me Zelianë, etj. Nga rendi përshkruar i ngjarjeve shenjohe karakterizimi dhe tipizimi i personazheve në raport me përbërësit e tjerë të veprës, siç janë: gjuha, stili, rrëfimi, etj.

Konceptimi i veprës studimore në tetë pjesë është bërë me një gjeturi, meqë në mënyrë kronologjike është ndërtuar metoda dhe vizioni për t'i trajtuar veçoritë kryesore të veprave të cilat e paraqesin rrëfimin për Jusufin dhe Zelianë. Në këtë drejtim, relacionet tematike funksionalizohen në pika të përgjithshme dhe të veçanta, aty ku kërkohet ideja dhe renditen çështjet dhe fenomenet përbrenda kodit fetar mysliman, kodit historik dhe kodit letrar. Në fakt, shtresat kuptimore të tekstit e ndërtojnë funksionin kryesor të veprës së trajtuar, ku triumfon funksioni i letërsisë që bëhet praktikë dominante për t'i konkretizuar më qartë edhe përbërësit e tjerë të veprës së analizuar.

## Për rezultatin e studimit

Në studimin e tij, Adnan Ismaili, ka arritur t'i studiojë fenomenet letrare dhe estetike të cilat ndërlidhen me tregimin për Jusufin dhe Zelianë. Një studim i tillë e ka afirmuar qasjen e argumentuar të autorit duke filluar nga zgjedhja e temës, mbarështrimi i fakteve dhe argumenteve deri te rezultati i kërkimit shkencor. Prandaj veçoritë kryesore të motiveve dhe të temave të veprave të zgjedhura në këtë studim, gjithsesi, e kanë një emërues të përbashkët që ka të bëjë me njohjen dhe afirmimin e kësaj letërsie.

Studiuesi i ka dhënë përparësi ofrimit të shembujve karakterizues që kanë të bëjnë me praninë e një tematike të tillë në një rrafsh më të gjerë, qoftë historik, fetar, letrar, psikologjik, estetik etj. Vepra të tilla, siç është studimi i Adnan Ismailit, synojnë dhe arrijnë ta fuqizojnë një lexim dhe një interpretim të kujdesshëm. Përmes analizës përmbajtësore dhe estetike autori ka arritur te esenca e konstatimeve të qarta kritike të cilat bazohen në argumentime të sakta dhe të thukta. Kështu është mbarështruar një lëndë e pasur, qoftë me gjerësinë e preokupimeve të strukturuar përbrenda profilit kritik të autorit, qoftë për mundësitë shprehëse që e favorizojnë dinamikën e kërkimeve, sidomos kur krahasohen çështjet dhe fenomenet letrare apo kur ato paraqiten në relacion me variantet e teksteve të ndryshme që për objekt trajtimi e kanë legjendën për Jusufin dhe Zelianë.

Rëndësia e teksteve të tilla që kanë një përmbajtje gjithëpërfshirëse e cila strukturohet përbrenda rrethanave historike dhe kulturore e avancojnë më tutje kureshtjen e studiuesit për t'u marrë me dimensione të caktuara të veprës. Para së gjithash, receptimi i tillë i funksionalizuar në relacion me Kur'anin, Dhiatën e vjetër dhe Dhiatën e re, dëshmon qasjen e përkushtuar të Adnan Ismailit për të nxjerrë sa më shumë vlerësime të qëndrueshme me interes duke përzgjedhur karakterizimet në planin analitik dhe krahasimtar.

Vepra studimore "Jusufi dhe Zelihaja në letërsinë shqipe" e Adnan Ismailit është rezultat i një pune të admirueshme e cila është konceptuar me të dhëna të shumta, në radhë të parë, me përdorimin e një literature të zgjedhur dhe mjaft të pasur, si në gjuhën shqipe, po ashtu, edhe në gjuhën turke, gjuhën arabe dhe në disa gjuhë të tjera. Prandaj rëndësia e veprave të tilla, siç është vepra e Adnan Ismailit, tregon për seriozitetin e pikëpamjeve kritike, sikurse edhe për thellësinë e njohjes së problematikës së trajtuar dhe për një varg treguesish të tjerë që e afirmojnë përkushtimin e autorit në arritjen e rezultateve duke dëshmuar vlerën e kësaj vepre në përgjithësi.

I

Ashtu si artet figurative dhe poezia gojore, edhe përkthimi është një veprimtari shumë e vjetër. Përkthimet kanë ekzistuar gjithmonë: përkthimi në greqisht i Dhjatës së Vjetër hebraike i përket shekullit të dytë para Krishtit dhe në Romën e lashtë skllëvërit grekë përgatisnin antologji për bijtë e padronëve të tyre. Megjithatë, deri në fundin e shekullit të nëntëmbëdhjetë, studimet teorike mbi përkthimin janë në një numër më të paktë në krahasim me sasinë e madhe të përkthimeve dhe pak të rrepta në pikëpamjen shkencore e metodologjike, sepse ishin të bazuara sidomos mbi të dhëna empirike dhe përvoja personale. Susan Bassnet Mc Guire vëren se është e nevojshme të ballafaqohemi me studimin mbi përkthimin, duke filluar nga një këndvështrim historik: vetëm kështu është e mundur të kuptohet se si roli dhe funksioni i përkthimit kanë ndryshuar përgjatë shekujve dhe sa i janë borxh përkthimit historia e letërsisë dhe kultura e njerëzimit. Dhe në fakt, falë përkthimeve veprat e mëdha të artit kanë arritur të transmetohen, të kenë sukses dhe të mbijetojnë. Një nga studimet më interesante në këtë drejtim është eseja e George Steiner, në të cilën, përmes veçimit të proves së njëzet shekujve histori, paraqiten në mënyrë shumë të qartë e të ndriçuar teoritë e shkrimtarëve më të mëdhenj që janë marrë me përkthimin nga antikiteti e sot. Steiner e ndan letërsinë mbi historinë, teorinë dhe praktikën e përkthimit në katër periudha, gjatë të cilave pikëpyetjet dhe problemet që lidhen me natyrën e përkthimit janë, më së shumti, të njëjtat. Mark Tul Ciceroni, në "Libellus" është i pari që ngulmon në përkthimin jo fjalë për fjalë, por kuptim për kuptim dhe Kuint Horac Flaku i pohon këto teza pak vite më vonë në Ars Poetica. Por duhet kujtuar se koncepti romak i përkthimit përkon me atë të imitimit: të gjithë romakët e kulturuar dinin t'i lexonin tekstet greke në original dhe përkthyesi nuk ishte i detyruar ta riprodhonte në gjuhë e vet tekstin original, por të jepte prova në kapacitetin e tij krijues dhe në rivalitetin me të mëdhenjtë e së kaluarës. Është vetë Ciceroni që krijoi dikotominë mes shkronjës dhe shpirtit, në debatin e përjetshëm mes mbështetësve të përkthimit literal dhe atij të lirë. Me ardhjen e Krishterimit, përkthimi u bë një mjet efikas për të shpërndarë mes gjithë njerëzve fjalë dhe mesazhet e Krishtit përmes Shkrimeve të Shenjta. Përkthimi i Biblës zuri një vend të skajshëm në historinë e kulturës perëndimore, mbasi kontibui në mënyrë përcaktuese në afirmimin e gjuhëve vulgare dhe në lindjen e zhvillimin e hermenautikës (metodologjia e interpretimit të teksteve të shkruara). Pas formimit të shteteve kombëtare dhe dobësimit të pushtetit të kishës, vështirësitë e hasura në përkthimin e teksteve të shenjta rriten ndjeshëm, sepse shpesh përkthimet shndërroheshin në armë politike dhe përkthyesit rrezikojnë të dënohen në turrë të druve për herezi. Kemi këtu rastin e John Wycliffe.

II

Humanizmi është një nga periudhat më intensive të përkthimit: përkthimet bënë të njiheshin vlerat e klasikëve greko-latinë, që u panë si model dhe ndikuan dukshëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Gjatë viteve të Reformës, përkthimi i Biblës favorizoi lindjen e protestantizmit në Evropë; në mënyrë të veçantë përkthimi i Biblës nga Luteri u bë shkak i shizmes mes kishës gjermane dhe asaj të Romës. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, Xhon Dryden, në parathënien e përkthimit të "Letrat e Detit të Zi" të Ovidit, duke u frymëzuar nga Institutiones Oratoriae të Kuintilianit, flet për tre tipa përkthimesh: metafrazën- kur teksti është bërë fjalë për fjalë; metafrazën- kur përkthehet sipas kuptimit, siç sugjeronte Ciceroni; imitimin- kur përkthyesi largohet lirisht nga teksti original. Megjithatë ai sugjeron kriterin e moderimit, të rrugës së mesme, dhe thotë se respekton atë mes metafrazës dhe parafrazës, por duke u përpjekur të modernizohet gjuha e tekstit të nisjes. Këto teori u rimorën nga Aleksandër Pope (1688-1744) dhe ushtruan ndikim të njohur në brezat pasardhës të përkthyesve: tekste të mëparshme, si ato të Rasinit e Shekspirit u rishikuan aq shumë dhe u përshtatën shijes dhe gjuhës së bashkëkohësve.

Në epokën romantike, kundërshtimi i racionalizmit solli në ekzaltimin e imagjinatës dhe të fantazisë: teoricienët anglezë e gjermanë

# ASPEKTE TEORIKLE HISTORIKE DHE KRITIKE TË PËRKTHIMIT

Nga Zija Vukaj



filluan të shtronin pyetjen nëse përkthimi ishte një veprim mekanik apo krijues, duke i dhënë përparësi hipotezës së dytë, aq sa edhe përkthyesi konsiderohej një gjeni krijues njësoj si poetët, madje edhe më shumë, duke pasuruar kulturën e sistemit pritës. Vetë Gëte, në "Divanin lindor- perëndimor" (1819), dallon tre tipa të ndryshëm përkthimesh, renditur sipas kriterëve estetike. Tipi i parë bën të njihen kulturat e huaja nëpërmjet kthimit në kuptimin tonë, i dyti është ai i përvetësimit për shkak të zëvendësimit, kur përkthyesi zëvendëson ndërtimet e sistemit të ardhjes në tekstin e nisjes, i treti dhe më fisniku, edhe pse më i vështirë për ta pranuar për kulturën pritëse dhe që gjen mbështetësit më të mëdhenj tani e tutje, është ai që jep identitetin absolut mes tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer, nëpërmjet një besnikërie absolute.

Friedrich Schleiermacher, që konsiderohet pararendësi i hermenautikës bashkëkohore, e konsideron përkthimin një dimension ngushtësisht filozofik. E një rëndësie të veçantë është eseja e tij Ueber die Verschieden Methoden des Uebersetzen, e vitit 1813, me të cilën kërkimi hermenautik gjen metodologjinë e vet. Në qendër të kuptimit të komunikimit të shkruar apo gojor nuk ka, sipas Schleiermacher, një objekt përcaktues, por mënyrën në të cilën mendimi i një individi manifestohet në gjuhë. Të kuptosh do të thotë të nisësh nga shprehja për të ndërtuar ndërmendjen e autorit; është e nevojshme të njihet e gjitha, konteksti total, për të kuptuar domethënien e pjesëve: shqiptimi duhet të jetë futur në frazë, fraza në kapitull, ky në tekst dhe teksti në veprën e autorit. Megjithatë, është e pashmangshme të fillohet nga pjesët e veçanta për të arritur tek e tëra; përshkruhet kështu një formë e parë e asaj që do të quhet "rrethi hermenautik".

III

Schleiermacher përkthen dhe komenton Shkrimet e Shenjta, duke treguar një rrugë të re, një metodë të re shpjegimi që nuk ndalet te domethënien imediate dhe që merr parasysh shumësinë e kuptimeve të pranishme në një tekst. Disa teza viktoriane mbi përkthimin bazohen mbi tendencën për të krijuar distancën hapësirë- kohë të tekstit të nisjes edhe nëpërmjet përdorimit të gjuhës dhe duket sikur pasqyrohen në debatin anglez mbi teorinë dhe praktikën e përkthimit të gjysmës së parë të shekullit njëzet. Ato kontribuojnë në veçimin e përkthimit nga veprimtaritë e tjera letrare, të paktën deri në ardhjen e Translation Studies. Historia e përkthimit tregon atë që ka pohuar André Lefevere, sipas të cilit akti përkthyes kushtëzohet nga faktorë politikë e ideologjikë dhe përkthimi, i kuptuar si rishkrim, është një instrument efikas manipulimi: përkthyesit luajnë një rol të rëndësishëm, por ndoshta të nënvlefësuar të

ndërmjetësimit, sepse nuk e krijojnë letërsinë, por e rishkruajnë dhe janë përgjegjës, mbase më shumë se vetë autorët, të pritjes dhe të suksesit të veprave letrare.

Një aspekt, sipas Lefeviere, mjaft i lënë pas dore, është se rishkruesit kontribuojnë në krijimin e imazhit të një autori apo të një vepre, mbasi ata, në shndërrimin e origjinalit, manipulojnë tekstet për t'ia përshatur ideologjisë apo konceptimeve poetike të kohës së tyre. Përkthimi i "Ditarit të Ana Frankut" nga origjinali hollandisht nga Annelise Schütz e provon këtë. Teksti gjermanisht përmban emendamente (korrektive) të natyrës private, në lidhje me seksualitetin e me natyrën ideologjike: janë lënë jashtë detaje, ndërrime emrash, janë shtrembëruar shprehjet që mund të fyejnë gjermanët. Schütz tenton të zvogëlojë bëmat naziste dhe përshkruan në mënyrë më pak dramatike kushtet e hebrenjve në Holandë, për më tepër që Ana me njerëzit e saj janë të detyruar të jetojnë në një vendstrehim të fshehtë.

Përveç kësaj, përkthimet luajnë një rol themelor për sa i përket zhbirlimit ndër sistemet letrare dhe evoluimit të letërsive dhe gjinive letrare: përmes tyre, në fakt, futen në sistemin pritës modele dhe forma të reja letrare, duke krijuar kushte të nevojshme për ndryshime të ardhshme në aspektin e tij funksional.

IV

Në shekullin XX kemi lulëzimin e kërkimeve dhe të studimeve organike mbi këtë çështje: gradualisht përkthimi nuk u konsiderua më si një degë e vogël e gjuhësisë apo e letërsisë krahasuese dhe filloi të afirmohej si një disiplinë autonome, me një fushë të vetën kërkimesh; gjithmonë vëmendja më e madhe po i kushtohej punës së përkthyesve. Në fillimet e Nëntëqindës, studimet mbi përkthimin u zhvilluan në Evropën Lindore, ku është i fortë ndikimi i formalistëve rusë, i rrethit lingvistik të Pragës dhe i teorive çomskiane: proceset e përkthimit po shqyrtoheshin si fenomene lingvistike, veprimtaria e përkthimit nisi të ndryshonte rrënjësisht. Disiplina që donte të themelohej është quajtur me emra të ndryshëm, ku secili prej tyre pasqyronte një impostim të ndryshëm teorik. Është e mjaftueshme të përshkohet historia e këtyre emrave- shkencë e përkthimit, teori e përkthimit, përkthimologji e në fund translation studies, për të njohur pikëpamjet e ndryshme me të cilat është studiuar përkthimi. Përcaktimi shkencor i është dhënë përkthimit në vitet Pesëdhjetë, në vazhdim të interesit për përkthimin automatik të teksteve jolettrare me kompjuter: teoricienët të informacionit, lingvistë, inxhinierë matematikë, mendojnë se mund t'i aplikohen përkthimit statistika dhe teoria lingvistike. Përveç vendeve të lindjes dhe Gjermanisë, janë përfshirë kësaj radhe edhe Shtetet e Bashkuara. Disa studiues, si Willard Quine, tentojnë të përshkruajnë lidhjet

ekzistuese mes logjikës formale dhe proceseve të përkthimit. Me aplikimin e parimeve të lingvistikës strukturale, teoria bëhet thelbësisht normative, sepse ka për qëllim të ngulitë norma mbi të prodhuarit e një teksti të njëjtë me origjinalin: përkthimi trajtohet si zhvendosje nga gjuha në gjuhë dhe na intereson sidomos në unitete shumë të kufizuara, si fjalë të veçanta apo fraza. Pavarësisht rezultateve zhgënjyese të makinave, kjo fazë është karakterizuar nga një impostim rreptësisht shkencor, i cili nuk mund të lihet më mënjatë. Në këtë periudhë, rëndësi të madhe marrin studimet mbi përkthimin e Biblës nga Eugjen Nida, për shkak të ndikimit të ushtruar prej tij në përparimin e studimeve mbi disiplinën.

V

Orientimi i Nida-s është i tipit lingvistikopragmatist: për të përshkruar vështirësitë që lidhen me procesin e përkthimit ai sjell probleme të shumta praktike dhe shembuj të nxjerra nga përkthimi i Biblës në gjuhë të ndryshme. Nida pohon se Dy gjuhë nuk paraqesin kurrë sisteme identike të organizimit të simboleve në shprehje të pajisura me kuptim dhe zëvendëson konceptin e identitetit me parimet e ekuivalencës formale, bazuar mbi konceptin e efektit ekuivalent dhe të ekuivalencës formale, përqendruar qoftë mbi formën, qoftë mbi përmbajtjen e mesazhit: të përkthesh do të thotë të prodhosh në gjuhën ardhëse ekuivalentin natyral më të afërt të mesazhit në gjuhën e nisjes, së pari në kuptim e së dyti në stil. Me "natyral" kemi parasysh që format ekuivalente të mos tingëllojnë "të huaja" as në formë as në kuptim. Vlen të thuhet, një përkthim i mirë nuk duhet të zbulojë formën e vet të palindur.

Në vitet gjashtëdhjetë, kërkimi i një teorie detyruese doli i papërshtatshëm dhe kemi kështu një kthesë të vërtetë, krijuesi i së cilës është Roman Jakobson, i cili në ambientin e formalizmit rus, përpunoi teori të reja, të vlefshme edhe sot dhe zbatimet e tyre janë thelluar nga studiues të ndryshëm.

Sipas Jakobsonit, përkthimi është një akt komunikimi, sidomos mes kulturave të ndryshme, mbasi qëndron në mbartjen e kuptimit të një fjale me fjalë të tjera; pa të nuk do të ishte e mundur njohja e objekteve që nuk i përkasin kulturës së vet. Prandaj studiuesi rus paraqet një skemë tripalëshe që është bërë një pikë referimi, sipas së cilës ekzistojnë tre tipa përkthimesh: endolingvistik, që qëndron në interpretimin e shenjave lingvistike përmes shenjave të tjera të së njëjtës gjuhë, interlingvistik; ose përkthim siç duhet thënë, që qëndron në interpretimin e shenjave lingvistike nëpërmjet një gjuhe tjetër, intersemiotik, kur shenjat lingvistike interpretohen përmes një sistemi tjetër jolingvistik. Ajo që i bashkon këta tre tipa përkthimesh, është pamundësia për të arritur një ekuivalencë të plotë mes sistemeve kulturore e gjuhësore mes tekstit të nisjes e atij të mbërritjes, për shkak të diversiteteve (ndryshueshmëri), aq sa as sinonimia nuk mund të jape ekuivalencë. Jakobsoni flet për "ekuivalencë në ndryshim": mënyra për të shpjeguar me fjalë të tjera kuptimin e një shprehjeje është një akt interpretimi që lëviz në varësi të atij që e kryen dhe prandaj është gjithmonë i ndryshëm nga një individ tek tjetri. Në fakt ekzistojnë interpretime të ndryshme të të njëjtit tekst, që megjithatë ruajnë atë që përkufizohet "bërthama e pandryshueshme" e tekstit origjinal; apo ajo që është e përbashkët në të gjitha përkthimet e një vepre të vetme, ajo që nuk ndryshohet në nivel domethënieje, për shembull, kuptimi i një poezie apo këndvështrimi për botën që shpreh autori në të.

Po në vitet gjashtëdhjetë, mendimi i Jurij Lotman-it u hapu rrugën teorie të përkthimit të shkollës së Tel Aviv-it, nga e cila Gideon Toury dhe Itmar Even Zoahr janë përfaqësuesit më të mëdhenj. Në fakt, sipas Lotmanit: teksti në përgjithësi nuk ekziston në vetvete, ai është pashmangshmërisht i përfshirë në një kontekst (i determinuar historikisht apo konvencional). Teksti ekziston si diçka jashtë vullnetit të elementëve strukturorë jashtëtekstuale, është i lidhur me ta si dy anët e një kundërshtimi. Mishi real i një vepre letrare qëndron në një tekst, i lidhjes së tij me realitetin jashtëtekstual-me realitetin, me normat letrare, me traditën, me sistemin e besimeve. Është i pamundur një perceptim i tekstit i ndarë nga "sfondi" jashtëtekstual.

Visar Zhiti, edhe me këtë libër, prek plagën ndër më të hidhurat të bashkëkohësisë shqiptare: krizën morale, krizën e vlerave, duke mos e humbur besimin në të nesërmen. Është përplot refleksesh të tilla koha shqiptare, ku me këtë rast, përmes depërtimit lucid në psikën e personazheve, përmes gjallërimit të përsiatjeve, dilemave, ëndrrave të tyre, Zhiti përgjon dhe dëgjon sferën më të pasigurt, më të pakapshme, më rrëshqitëse – zemrën e njeriut. Është ky një rrëfim mbi ushtrimin e dhunës dhe pasojat e saj, mbi qëndresën dhe ëndrrat, të një sistemi të kaluar por të pleksur nëpër këmbët e të sotmes, që, si prani e projekton dhe e shtyn drejt së nesërme; rrëfim që vjen sa përmes gjallërimit të kujtesës, sa përmes absurditeteve dramatike të botës shqiptare aktuale, sa përmes horizontit të mjegullt dhe kaotik të së nesërme, sa përmes britmës individuale të mekur, ngjashëm me britmën në shkretëtirë, sa përmes një besimi akoma më të vakët se një ditë do të dilet nga tuneli. Një pleksjeje e tërë ndjesish dhe vizionesh, që nga zhgënjimi dhe dëshpërimi, ulëritja e heshtur që mëton të artikulohej zë i fuqishëm i artit letrar-romanor, përsiatjet në radhë të parë të personazheve, të ëndrrave dhe klithjeve të tyre të heshtura, për pafuqinë përballë brutalitetit të djeshëm dhe të sotëm, të gjitha këto rrjedha, të pleksura në kohën dhe hapësirën që përfshin rrëfimi i romanit, rezultojnë në një vepër të përsosur letrare. Është për të nënvizuar se, rrëfimi mbase më dëshpërues, kësaj here vjen nga një krijues që ka qenë vetë viktimë, që i ka provuar dhe ka ecur me vite nëpër tunelet e burgjeve, por që, si me veprën letrare ashtu dhe me sjelljen e tij si qytetar është shquar me energji pozitive, pajtim dhe mirësi, sjellje e dëshmi që është larg mërive dhe revansheve. Nuk ka manifestuar ndjenjë të tillë as ndaj hetuesve-xhelatë që i ndesh në rrugë, në kafe. Por kur struktura të tilla arrijnë të bëjnë edhe ligjin, – këtë, pikërisht këtë s'ka mundur ta pranojë, të paktën jo pa vënë ulërimën... Tani më është qartësisht e pranueshme fuqia ngasëse e Visar Zhitit për të rrëfyer, përkatësisht për t'u çliruar nga mbamendja e burgosur, e shtresuar palimpsest, që, si synim i brendshëm, në momente i ankthshëm, mëton kthimin e drejtpeshimit të munguar, gjetjen e të humburës nëpër kohë, shërimin e çarjes në ne, të genies sonë, plasaritje që na shoqëron viteve. Në romanin më të ri vjen shpërthyes kundër së ligës që e pushton komodshëm hapësirën e përditshmërisë shqiptare, vjen mëtim drejt gjetjes së drejtpeshimit të humbur, dhe -në kundërshtim me skeptikët e shumtë – beson se letërsia ende mund të dëgjohet dhe ndikojë në gjetjen dhe ruajtjen normalitetit dhe kuptimit, në përputhje me misionin e krijuesit. Brenda ritmit të çrregulluar shqiptar, në kohë dhe hapësirë, brenda ekstremeve të skajshme që manifestojnë ata, – që nga vërvitja majave artistike-krijuese europiane (ekspozita e Evgenit në Napoli, që "ia dola të iki nga andej ku ka vetëm urrejtje...") nga njëra anë, deri tek mafia me imagjinatë më marramendëse, nga ana tjetër, Visar Zhiti, me ngasje të ethshme krijuese, gjakon pas gjetjes së humbur të vetvetes shqiptare, nëpër Arbëri dhe nëpër hapësirën europiane. Arratisjet shqiptare nëpër botë, përmes imagjinatës gjatë diktaturës dhe realisht pas saj dhe në vazhdim, në kërkim të së humburës, të vetvetes, prania e hijeve të këtij kërkimi, dashuria dhe urrejtja e pleksur si një përditshmëri bashkë, sidomos në një hark kohor kapërcyell, koha e daljes nga tuneli drejt dritës, që nuk po vjen e plotë sot e gjithëditën, jehojnë fuqishëm, si klithje ulëritëse e heshtur në romanin më të ri të këtij autori. Në këtë kohë britmash, Zhiti sjell personazhe që, si të vërtetë dhe si hije, jepen në kërkim të njëri-tjetrit e që nuk arrijnë dot të gjenden, që sillen si në një rreth

## VISAR ZHITI - NË KËRKIM TË BRITMËS SHQIPTARE

Nga Ali Aliu

të mbyllur, pa shpresa e gjasa të sigurta për t'u gjetur. Më mbresëlënësi është Martini që kërkon një të humbur pa gjurmë, duke trokitur dyerve të emigrantëve shqiptarë nëpër Europë, me një refren, "... po të keni dëgjuar për të, a nëse dëgjoni, më lajmëroni". Në këtë kërkim-golgotë, regjistrohen dukuri rrëqethëse, si për shembull: kërkuesi i Gjergj Guraziut, ndër të tjerat, do të hasë edhe në një administrator shteti, te zyra e të pagjeturve, dhe del ish hetuesi, ku do të zhvillohet edhe ky dialog: "... ti do më thuash mua persekutor, por unë të nxjerr dëshminë e persekutimit, kam vuajtur sa ti, në mos më shumë. Të kam ruajtur, kam bërë policin, spiunin në terr, në të ftohtë... Dhe mos harroni, ju keni qenë bashkëpunëtorë me ne, keni kallëzuar njëri-tjetrin...". Këtë ngarkesë ka e kaluara, e pranishme në të tanishmen, prandaj, njëri nga personazhet e romanit do të ulërijë: "Tani që shteti tjetër po bën përpara, shpesh kërkon të hapen dosjet dhe të dënojnë krimet e komunizmit... po të postkomunizmit?". Ose, " Është shtuar liria por është pakësuar morali... Në urrejtje ndihen të fortë tani njerëzit... duan të jenë individë pa qenë individualitete". Mbase është dashur të jepet në fillim të këtij shkrimi, një shënim i autorit në fund të romanit, që po e sjellim të plotë, me që

del domethënës, sidomos për ta marrë me mend, shqetësimin krijues dhe njerëzor gjatë rrëfimit. "...mbresa dhe shënime në një qytet të vogël të atdheut, në Lushnjë, pastaj në Milano, riparë dhe shtuar në Romë, kësaj vere, kur jo vetëm shekulli është tjetër. Por mua më dukej se vazhdoja të isha në "Asgjëkund", ndoshta nga që shkruaja mbi një tavolinë të vogël e të çarë në një korridor gati sa tryeza, sikur të mos ishte apartament i ambasadës, por banesë e mjerë refugjati. Prandaj, për çdo mëkat të këtij rrëfimi, fajin e ka e çara mbi tryezë, si një britmë e vdekur, e cila vijon dhe në kufirin midis vendeve ashtu si edhe në kafkën time...". Britma shtrihet në rrëfimin romanor dhe jehon e pazëshme, si vrugë e përhershme e ndërgjegjes së autorit, e nxitur nga një dialog mes Evgenit dhe Adrianit :

– E keni pare "Britmën" e Eduard Munch-ut?, e ndërpreu Adriani.  
– Ou, briti Evgeni, kam vajtur në Norvegji për të, në muzeun e tij në Oslo. Ato retë e përgjakura, ai ankh... Edhe atje pyeta për Afërditën, Gjergjin... Kam dashur dhe unë të pikturoj britmën time. Britmën pa gojë, pa trup, pa njeri, britmën erë, fantazmë.  
– Është më i tmerrshëm njeriu pa britmë – Sigurisht! Britma pa popull, sa e frikshme. Popull pa qeveri edhe mund të ketë, jam



dakord, po pa britmë? Mallkim!

Është britma shqiptare që gjakon të çlirohet, të ekuilibrohet, të pastrohet nga vuajtjet dhe mëkatet, nga frika dhe nënshtrimi, nga hakmarrja dhe urrejtja; është britma në kërkim të të patëgjurve dhe të pagjeturës, në kërkim të së humburës dhe të të humburve, në kërkim të vetes dhe vetvetes së pagjetur... Shtrihet kështu në hapësirën pafund britma e Visar Zhitit si një fluid ankthi dhe rrëqethje gjatë udhëtimit të Gjergj Guraziut dhe Afërditës natën e stuhishme shqiptare nëpër një fushë e terri të pafund, rafshit të vërshuar real e ireal. Në një vegim të tillë do të humbin ëndrrat e tyre të prangosura, ndjesitë dhe emocionet që s'arrin t'ua çlirojnë as stuhia e jashtme as ajo e brendshme; çdo gjë do të tretet në pakthim si një hije, për gjetjen e të cilave do të bredhë nëpër botë si somnabul Martini. Tretja e tyre do të mbetet një përfytyrim sa i afërt dhe i prekshëm po aq rrëshqitës, pa qenë të denjë ta kemi, ta meritojmë; vjen si një përfitim ëndëror pranë nesh, duke lënë pas vetëm misterin e natës së gjatë të stuhishme shqiptare dhe ndjekësit që së bashku do t'i gllabërojnë...

Rrëfimi në romanin më të ri të Visar Zhitit që ringjall kujtesën dhe mëton çlirim duke gërvishur skutave më të padukshme, më të errëta të botës së njeriut, kryesisht zgjedh, sa bashkëbisedimin me veten, sa rrëfim me aromën e sentencës, sa me elegancë klasike dhe me përvojë narrative të kohës, duke mos iu robëruar asnjëherë. Rrëfim që krijon atmosferë të fuqishme, tensionime dramatike që përftojnë nëpër atë hapësirë si fluid i kudopranishëm, atmosferë edhe në kuptimin e një dokumentari historik, siç është koha-kapërcyell (fundi i 80 –fillim i 90), brenda së cilës ushtrohet obduksion narrativ i idealeve të vdekur; rrëfim që sjell një tjetër pamje të kategorisë kohë, koncept që lejon prani paralele të më shumë kohëve në prezent, që përmes kësaj estetike të kohës, Zhiti, fare natyrshëm arrin dekompozimin kronologjik të narracionit dhe artikulimin e strukturës mozaik të rrëfimit, polifokalitetin, – më shumë perspektiva vrojtuese të personazheve, poetikë narrative e preferuar sot... Është në natyrën e këtij narracioni reflektiv, po ashtu, sentencialiteti që si diskurs shtrihet hapësirës kohore të pakufishme – pa referenca të domosdoshme kohore, përkatësisht ajo, sentenca, perceptohet si e gjithëkohshme. Kështu, sentencialiteti dhe përsiatja refleksive, duke qenë referencë pa kornizë kohore, përkatësisht duke u shquar si e tanishme, në fakt e universalizon dëshminë e ngarkuar në roman. Kjo frymë e bën romanin më të ri të Zhitit të përjetohet si shumëzëshmëri, si shmangie e herëherëshme nga boshti fabular, në favor të heterogjenitetit të diskursit tekstor. Gjuha që përdor personazhi nuk i drejtohet referentit, (objektit, botës, realitetit) por brenda saj përqendron vëmendjen të përcjellësi, tek qëndrimi emocional ndaj asaj që përcjell. Ngacmimet e jashtme shtyhen drejt shpalimit të relievit të brendshëm të personazheve. Gjatë depërtimeve në thellësitë e tyre, ndjehet edhe një si dilemë e largët: sa mund të jetë vetëvetja njeriu, përkatësisht sa i takon vetes e sa botës, sa përplotësohet, kuptimësohet përmes tjerëve, sa tjerët përmes tij...



## LULET E SANREMOS

Pjesë nga romani “Në kohën e britmës”  
e Visar Zhitit

**L**ulet e Sanremos, tha me vete Martini i lumtur. Mund të fillonte punë së shpejti atje, në Sanremo, të shpërndante lule nëpër qendrat ku tregtoheshin, dhe kishte filluar t'i shikonte me vërejtje rrugëve ato, shitore të drunjta, sa të bukura, mbushur me gjethnajë e petla lloj-lloj deri në çatitë e tyre, si të ishin të Edenit.

Do të shkonte me kamion në Milano dhe në qytete të tjera pranë Sanremos, më sipër, pllajave, rrafshnaltave, në kohën e borës, me lule që shkërbenin borën, diellin, zemrën, do t'i afrohej Adriatikut Verior, por Detin Ligur do ta kishte më afër. Sikur të kishte pasur patentë për automjetet, do të kishte filluar punë menjëherë, ja, sa ta merrte. Po a ta fillonte me biçikletë njëherë? Nuk do të shpërndash vetëm buqeta me lule për zonjat, kishte buzëqeshur Amedeo. Dhe e kishte regjistruar në një kurs. Por mjafton t'i hipi kamionit, i thoshte Martini, po nuk e ngava menjëherë, se bëra me mend listën e atyre që u japin makinave në qytetin tim, ka debila sa të duash, të ligj. Kur dinë t'i japin ata, them, unë menjëherë, sa ta ndez, s'kam nevojë fare për orë mësimi e prova.

Amedeoja kishte qeshur me zë. Si janë nga shtëpia, e kishte pyetur, prindërit, motrat? Mirë, mirë, të fala, ishte përgjigjur Martini.

Qenë gëzuar, kur u kishte thënë në telefon se do të fillonte punë. Ua, qe magjepsur Rezana, pse ka lule të bukura Sanremo, si këngët? Po, po, nga këngët bëhen. Edhe këngët nga lulet... Beti thoshte se kishte përmirësime ajo, ishte më e qetë. Si t'u çonte lule të Sanremos motrave? Po afronte ditëlindja e Rezanës, e Betit më pas. Një buqetë të madhe në shtëpi... Atje ende s'vënë lule. Do t'i çoj vetë. Do të hap dyqan lulesh... Dhe iu përshfaq si një pllajë gjaku një trëndafil i largët, e këputi ajo, Afërd... kur ikte me Gjergjin... ndoshta në udhëtimin e tyre të fundit... e shtypi makina... trëndafilin... Po ti nga e di? Qysh?... S'donte ta nëpërmendte as pse e dinte...

Të fillonte punë njëherë, kjo kishte rëndësi tani, përndryshe duhej të kthehej nga kishte ardhur ose të çmendej. Do t'i pëlqente të merrej dhe me biçikleta, montim, riparim, si punë shtesë. Të ikte dhe nga shtëpia e gazetarit, ata e kishin mbajtur shkëlqyer, as mund të besohej kjo mikpritje, por duhej t'i linte të qetë, me mirënjohjen më të thellë, duke mbetur mik me ta.

Po ti mos u shqetëso dhe aq, do të ikësh, i kishte thënë e zonja e shtëpisë, por këtu ka dhoma plot, të kemi pasur ndihmë... Edhe baby-sitter-in kishte bërë.

Vërtet, ç'u bë ajo? Këta s'e zunë më në gojë, do të jenë marrë vesh me të, dhe Martini nuk ia lejonte vetes të pyeste për më tej. I përshfaqej herë pas here lakuriq, siç po shkonte në vaskë atë mesnatë... sikur ikën, ashtu i duket ende. Të ketë qenë ai shkaku i largimit të saj? Sa keq, sa keq!

Kurse çupëza e vogël qe miqësuar së tepërmi me Martinin, hidhej nga krahët e s'ëmës tek ai dhe gurgullonte në të qeshura. Sa shpejt që rriten!

- Të lutem, eja pak me mua në dhomën e librave, - i tha me zë të ngrohtë e zonja e shtëpisë, aq sa dhe dy "n"-të e emrit të saj si në romane iu duk se u bënë inkandeshente.

- Patjetër, - i tha Martini, duke menduar se do të mbartte ndonjë gjësend. I pëlqente druri në studio, edhe era e librave, edhe kolltukët e zinj.

Nga një sirtar ajo nxori një Bibël.  
- Shiko, - i tha, - lule të thara nëpër fletë. Janë nga Shqipëria.



- Vërtet?

- Po, po. Babai i Amedeos, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka qenë ushtar pushtues atje... Në letrat që i çonte mamasë së Amedeos, i futte dhe nga një lule, janë nga Olimpi juaj, s'e di si quhet, e shkruan vendin. "Lulet e mia në Bibël", - mermëriti Martini. - Kur kapitulloi fashizmi dhe ushtarët italianë ndiqeshin nga nazistët e pushkatoheshin si dezertorë, babanë e Amedeos e mbajti një familje shqiptare. Jo vetëm atë, por shumë, besoj e di?

- Me mijëra, - tha Martini, - e di. S'ka ndodhur gjëkund që atë që vjen si pushtues, ta futësh në shtëpi e ta mbash si tëndin. Edhe në familjen e gjyshit tim në fshat kemi pasur dy italianë. Kur mbaroi lufta, i përcollën si vëllezër për në vendin e tyre, në Itali. Ngaçë u vendos diktatura në Shqipëri, u ndaluan dhe lidhjet me ta, letërkëmbimi. Dhe u harruam...

- Ti e di nga janë ata që mbajti gjyshi yt?

- ...italianë...

- Babanë e Amedeos e kisha dëgjuar edhe unë të thoshte se shqiptarët janë populli më i mirë në botë.

- E pse s'më ka thënë gjë Amedeoja për këtë? - po vriste mendjen Martini.

- S'e di. Jam e sigurt se Amedeoja kështu do të vepronte me ty gjithsesi. Jo se po shlyente ndonjë borxh. Nuk të ka thënë gjë, se ti i meriton të gjitha, që të..., - por heshti pa e mbaruar fjalën. Iu afrua Martinin, që po rrinte në këmbë me Biblën ende ndër duar, dhe e puthi lehtë në ballë.

- Falemnderit, - u prek Martini. - Falemnderit dhe për punën që më keni gjetur në Sanremo, - shtoi. - Jam shumë i gëzuar.

- Martin, tani do të të tregoj ç'më tha ajo shoqja ime që gjeti punën tënde. Po ta them, që të ndjellim fat sa më të bukur për ty. Dëgjo. Dikur, shumë vjet më parë, kishte punuar dhe një shqiptar tjetër në Sanremo, shpërndante lule me kamion. Ishte i arratisur politik, bashkë me të vëllanë, shkrimtar i ndaluar te ju, por i njohur, Ernest quhej, mbiemrin se si e kishte...

- Koliqi, - ia priti Martini.

- Po, bravo! Vëllai i Ernest Koliqit, pra, ishte shpërndarës lulesh. Niset nga Sanremoja me kamion për t'i çuar s'di se ku. Ndalon te një vend i bukur, me shtëpitë në kodër, dhe do që të takojë një vajzë të bukur, që ai e pëlqen, duhen, do që t'i japë lulen e saj, siç e ka bërë zakon. Ndërsa ngjitet kalldrëmit përpjetë, dëgjon kambana. Merr vesh se ajo ka vdekur papritur dhe kamabanat po bien për të. Dhe ai sjell kamionin aty e zbraz të gjitha lulet mbi të vdekurën. E mbulon. Dhe e lë atë punë... Nuk u martua kurrë. Martin, mos u trishtoh. Ta thashë për të besuar se ç'ishte e trishtë e tragjike, kaloi. Ty tani të pret tjetër gjë, të shkarkosh lulet në dasmën tënde.

- Të motrave, - uroi me shpirt Martini.

- Ne e kemi zakon, martojmë ato më parë.

- Sa bukur! Ka pasur të drejtë vjehri im që thoshte ashtu...

Botime të reja nga "Schnell"

## Arben PRENDI "I ra mjegulla Buenës" tregime

Autori Arben Prendi vjen para lexuesit me përmbledhjen me tregime "I ra mjegulla Buenës" botimi më i ri Shtëpisë Botuese Schnell. Ky vëllim me tregime është i pari për autorin.

ARBEN PRENDI (1971) prej vitit 1993, pas përfundimit të studimeve të larta, është pedagog në Departamentin e Letërsisë, në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Është bërë i njohur si poet, publicist dhe kritik letrar përmes shkrimeve të shumta në organet e përditshme të shtypit shqiptar. Ka marrë pjesë në konferenca dhe simpoziume shkencore lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu është autor i mjaft artikujve të botuar në revista shkencore si dhe i disa studimeve letrare mbi letërsinë shqiptare.

Deri më tani ka botuar:

-Të shtunën ndize një qiri. Poezi, Eurorilindja, Tiranë, 1996.

Vashat nguten me u b'gra. Poezi, Camaj- Pipa, Shkodër, 1998.

-Qirinjtë ndezun për të gjallët. Poezi, Camaj- Pipa, Shkodër, 2001.

Vepra poetike. Poezi. Fiorentia, Shkodër, 2018.

-Tekste në kontekste. Artikuj, studime letrare. Naimi, Tiranë, 2011.

-Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor. Monografi, Fiorentia, Shkodër, 2015.

-Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore. Studime letrare, Fiorentia, Shkodër, 2017.

-Fatos Kongoli. Studim. Bardboks, Prishtinë 2021.


Për ne që e shijojmë letërsinë,- shkruan autori në parathënien e librit,- ajo mbetet mister. Njeriut i feks trilli për të rrëfyer, imagjinuar dhe për t'u kënaqur estetikisht me krijimin. Për të vijuar se: Këto tregime janë shkruar në periudhën nga viti 1993 (Njollat) deri në vitin 2018 (Muri) pa ndonjë rregull të përcaktuar. Disa prej tyre e tejkalojnë emërtimin tregim, shkojnë deri në kufijtë e novelës, disa duken si fragmente

romani. Sigurisht është i njohur qëndrimi se shkrimtarët në radhë të parë shkruajnë për kënaqësinë e tyre, kështu ka ndodhur edhe me mua, madje nuk u shqetësova për botimin e tyre në kohën kur kjo përmbledhje ishte gati, në vitin 2018.

Tani më duket sikur po lexoj tregimet e dikujt tjetër, madje tek disa, kisha harruar se çfarë kam treguar dhe isha kureshtar për të mësuar se si përfundojnë. Mund të them se vetë jam argëtuar me shkrimin e tyre, ndaj edhe pjesa më e rëndësishme nuk është ajo çka kam treguar, por si e kam treguar. Jo rrallë nuk ka asgjë për të treguar, ka hapësirë për të imagjinuar, reflektuar dhe përshkruar. Sprova me ndërtimin e ligjëratës gjuhësishme dhe artistikisht, përpjekja për t'u përballur me pengesat deri ku mund të shkosh në stilizimin e fjalisë dhe frazës bëhet aventurë tërheqëse që e anashkalon subjektin, ngjarjen e mundshme apo ndjekjen e fatit të personazheve. Ndaj edhe i pushtuar nga kjo frymë aventurë gjuhësore dhe artistike nuk më ka vrarë fort ndërgjegjja për përzjerjen e dialektit me gjuhën standarde, edhe pse siç thuhet shpesh, gjuha e letërsisë përfshin të gjitha ligjërimet.

Përmbledhja përbëhet nga 28 tregime që në mënyrë artistike, komunikojnë me tema mitike, historike dhe të jetës së përditshme të shoqërisë shqiptare.

Këndvështrimi alegorik dhe simbolik i botës shqiptare përshkon prozat ku rrëfimi artistik thuret duke estetizuar temat e lidhura me: mjegullën e baladës së flijimit (I ra mjegulla Buenës), përrallat gojore (Kasollja në breg të lumit, Zana e vonueme), rënien e trojeve shqiptare nën pushtimet barbare (Çorodia), rënien e qytetit të Shkodrës nën pushtimin osman (Mbi rënien e kështjellës), librin e Gjon Buzukut (Libri), jetën dhe travajet e përditshme (Njollat, Kohë me shi, Dy rrëfime për vdekjen, Sagë familjare, Muri) si dhe me botën e ëndrrave dhe të pavetëdijes (Ajo që ndodh vazhdimisht, Në mënyrë të çuditshme, E padurueshme, Përndjekur nga ëndrrat, I sëmurë nga mendimet).



## PROGRAMI I AKTIVITETEVE

# FESTIVALI LETRAR NDËRKOMBËTAR I TË RINJVE "TIRANA GATE 2022"

Për të vitin dytë radhazi, "ExLibris" është *media partner* i festivalit ndërkombëtar të letërsisë "Tiran Gate" që do të mbahet në Tiranë nga e mërkura, 5 tetor deri të premten, 7 tetor pranë ambienteve të Muzeut Kombëtar. Të pranishëm, në tryeza e panele të ndryshme diskutimi do të jenë shkrimtarë shqiptarë, nga Evropa e deri edhe nga Ukraina.

"Tirana Gate", edicioni i dytë i festivalit letrar ndërkombëtar

Sivjet është viti i dytë në të cilin organizohet festivali letrar ndërkombëtar, "Tirana Gate" me shkrimtarë nga Ballkani si, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria dhe autorë nga Turqia, që në labirinthin e një paraleleje mes historisë personale dhe asaj kombëtare do të na rrëfejë histori shtetesh dhe qytetesh, histori qytetërimesh dhe jetësh individuale. Gjithashtu pjesë e Festivalit do të jenë autorë evropianë si nga Sllovenia, Bullgaria, Greqia, Rumania, fitues të çmimit ndërkombëtar Çmimi Europian i Letërsisë (EUPL), ku edhe Shqipëria bën pjesë me 3 autorë të saj.

Në këtë edicion, do të synohet që nëpërmjet së kaluarës të flitet për të sotmen dhe për të nesërmen në një mision për të transportuar kultura, histori, qytetërime, marrëdhënie njerëzore.

Tema kryesore e këtij festivali do të jetë "Fqinjët", ata afër dhe ata larg, me panelet e diskutimit mes shkrimtarëve evropianë dhe Ballkanit Perëndimor. Në tridhjetë vite ky rajon po përballet me histori të ngjashme, shkëputjen nga regjimet totalitare dhe histori arratie e dëbimi.

Milena Selimi, drejtore artistike e festivalit thotë se "Kultura është e vetmja hapësirë pa kufij ku mund të lëvizim pa lejekalimi, ku në vend që të kundërshtojmë mund të dialogojmë edhe nëse nuk jemi dakord. Prej këtu lind nevoja që të flasësh me Tjetrin. Të njohësh Tjetrin, do të thotë të fillosh t'a respektosh. Të respektosh do të thotë të tolerosh. Të tolerosh do të thotë të bashkëjetosh. Bashkëjetesa është një element kulture. Kapërcimi i kufijve gjeografikë, midis disiplinave dhe diskutimeve, bëhet i mundur vetëm nëse ai apo ajo që udhëton ia del të zhvendosë kufijtë e brendshëm. "Po udhëtoj brenda vetes" thotë Julia Kristeva, filozofja e shquar bullgare. Vetëm në këto kushte idetë ngrihen mbi dëshpërimin dhe ta kuptosh këtë nuk është e pamundur.

Do të flasim për Ballkanin Perëndimor duke diskutuar: A e përcakton e kaluarë të ardhmen? Njëherësh në panele të ndryshme autorët pjesëmarrës do të përballeshin për temë të tjera të rëndësishme si Vendlindja vs refuzimi kulturor, apo Meta(for)a në kohën e 'qenve' Mes 'Dëshiroj dhe "Duhet", një hapësirë për paraqitjen e mendimeve të papërpunuara, për shkrimet e pakapshme, të papajtuësme me askënd dhe asgjë, për rrëfimin e zhveshur nga "Dëshiroj" dhe "Duhet", ku shfaqen veç mendimet dhe ndjenjat. Për letërsinë që trondit e revolton 'turmën'. Tema të tjera do të jenë: Gjuha- Atdhe brenda Atdheut, në një diskutim sesi gjuha mund të vendosë kufij të caktuar, që mbeten më shumë imagjinarë, pasi autorët sot largohen nga vendi i gjuhës së fëmijërisë së tyre. Madzirov, "Gur i zhvendosur", rikthim i fuqisë, hapësirës dhe paqes. Selmani, poeti në kërkim të gjysmës së humbur, Babait dhe poetja Halili, që 'procesin e reflektimit e të shkrimit e shih si zbulesë të po asaj kujtesë që veçse është brenda nesh por e kemi harruar', do të flasim edhe për temë si "Harresa si proces i ripërtëritjes / Kujtesa si pasqyrë e ndërjegjes", etj.

Sikurse shumë aktivitete të tjera letrare e kulturore, edhe edicioni i sivjetëm i festivalit do të solidarizohet me Ukrainën, në një seksion të dedikuar asaj nëpërmjet sjelljes së disa autorëve përmes krijimtarisë së tyre. Poema dhe ditaret e luftës aktuale në Ukrainë do të komunikojnë me publikun. Letërsia si akt rezistence - Letërsia si shpëtim nga lufta. Mirëpresim autorët nga Ukraina, Halyna Kruk dhe Oleksandr Mykhed që do të përshëndesin nga Ukraina me video mesazhe, ndërsa poeti, përkthyesi dhe njohësi i çështjeve që lidhen me Ballkanin, Andriy Lyubka, pas një rrugëtimi të gjatë dhe të vështirë, (shpresojmë që gjithçka të shkojë mirë) do të jetë pjesëmarrës në festival. Së bashku me kolëgjet Lako, Madzirov, Çoku dhe Dushi do të lexojnë në hapësirën e leximit Ukraine- STOP ËAR.

Festivali ka një program të ngjeshur, që jep mundësinë e ndjekjes së autorit të dashur, shqiptar, apo fqinj. Kemi një përparësi, pasi disa nga autorët pjesëmarrës janë të përkthyer në shqip dhe lexuesi, nëse nuk i ka njohur, do të ketë një arsye më shumë për t'i njohur dhe zbuluar përmes festivalit. Kemi në shqip Madzirov, Velikic, Bajac, Kalpuzos, Reka Man- Varhegy, Jançar, Terziyski, Ayfun Tunc, etj, përkthyer jeshhtërisht nga punëtorët e palodhur të hapësirës ballkanike, Ben Andoni, Nikollë Berisha, Kristo Pulla, Maniela Sota, Milena Selimi, që bëjnë të mundur atë Trans (Port), apo rrugën e mundimshme drejt Tjetrit. Nga një gjuhë në tjetren. Nga një kulturë në tjetren.

Festivali do të mbahet në sallën UNESCO- Muzeu Historik Kombëtar në datat 5,6,7 tetor 2022, në oraret 10:00-14:00 dhe 16:30-17:30. E veçantë do të jetë gjuha e festivalit, kushtet e autorit do të flasë, dikutojë dhe lexojë në gjuhën e tij, pra do të dëgjojmë shqip, turqisht, greqisht, bullgarisht, maqedonisht, serbisht sllovenisht, ukrainisht, rumanisht, anglisht. Autori më i ri i festivalit është 23 vjeçari Andreas Dushi dhe autori më në moshë: Drago Jançar, 73 vjeçar.

këtë kohë në letërsi, botë reale? Ose realitet objektiv?

**Ora 13:30-14:00**

Autorët lexojnë / Lexime skenike

**Drago Jançar** (Slloveni); **Telemak Koça** (Greqi); **Mariana Kondi** (Shqipëri)

**Ora 13:30-14:00**

Lexime / Klubet e Librit / Gjymnazet e Tiranës / Festivali i të Rinjve

**Ora 14:00-16:00**

Pushim

**Ora 16:00-16:30**

Autorët lexojnë

**Arbër Selmani** (Kosovë); **Erina Çoku** (Shqipëri); **Lulzim Haziri** (Maqedonia e Veriut)

**Ora 16:30-17:30**

Paneli 3

Vendlindja vs Refuzimi kulturor

Pjesëmarrës: **Telemak Koça** (Greqi); **Odise Kote** (Shqipëri); **Ivana Trajanovska**

(Maqedonia e Veriut); **Majlinda Rama** (Shqipëri) Moderator: **Alban Tufa**

Gjuha: **Shqip, maqedonisht, anglisht**

Që nga vendlindja, shtresa e parë e vetëdijes, një ballafaqim i parë dhe i paharruar me botën, ka shumë rrugë për të ecur. Aty gjenden shpesh kuptimet themelore të asaj që do të ndodhë më pas në jetën e njeriut. Aty janë lindjet, vdekjet, këngët, legjendat, aty gjithçka është magjike, por njeriu kërkon të dalë nga "fëmijëria e përjetshme". Vendlindja është pase bota përpara. Një rrugëtim dhe dyzim i vazhdueshëm: dy kohë, dy botëkuptime, dy breza.

**Ora 17:30-18:00**

Autorët lexojnë

**Kalin Terziyski** (Bullgari); **Nikola Madzirov** (Maqedonia e Veriut); **Ervina Halili** (Kosovë); **Janis Kalpuzos** (Greqi)

**Ora 18:00-19:00**

Paneli 4

**Balkan Beauty, Balkan Blood** Ballkani Perëndimor: A e përcakton e kaluarë të ardhmen?

Pjesëmarrës: **Vladislav Bajac** (Serbi); **Diana Çuli** (Shqipëri); **Janis Kalpuzos** (Greqi); **Andriy Lyubka** (Ukrainë) Moderator: **Ben Andoni**

Gjuha: **Shqip, ukrainisht, serbisht, greqisht**

Çfarë ishte "e përbashkët" dhe konkretisht çfarë është "Ballkani" për Ballkanin. Sa gjerësisht dhe sa thellë duhet të jenë të përbashkëta elementet hipotetike të përbashkëta të afta për të formuar një zonë dukshëm të larmishme në një rajon "unitar" kulturor-historik? Cilat janë tiparet e dallueshme "ballkanike" - gjeografike/gjeopolitike, kulturore, historike - që e veçojnë këtë rajon nga rajonet e tjera dhe i japin atij një unitet koheziv?

**Ora 19:00- 19:30**

Autorët lexojnë

**Vladislav Bajac** (Serbi); **Diana Çuli** (Shqipëri); **Sebnem Isiguzel** (Turqi)

**E mërkurë, 5 tetor 2022**

**Ora 10:30**

Muzeu Historik Kombëtar, *salla "UNESCO"*

Ceremonia e hapjes, me pjesëmarrjen e organizatorëve, autorëve, përkthyesve dhe personaliteteve të artit e kulturës.

**Ora 11:00-12:00**

**Paneli 1**

(Ri)udhëtoj brenda vetes. / Letërsia si zë nga Unë te Tjetri. / Afër, larg, përballë, pas shpine. / Liria ime nuk ngjan me askënd Tjetër.

Pjesëmarrës: **Drago Jançar** (Slloveni); **Anna Kove** (Shqipëri); **Ylljet Aliçka** (Shqipëri); Moderator: **Arta Marku**

Gjuha: **Shqip, sllovenisht**

Kultura është e vetmja hapësirë pa kufij ku mund të lëvizim pa lejekalimi, ku në vend që të kundërshtojmë mund të

dialogojmë edhe nëse nuk jemi dakord. Që këtu lind nevoja që të flasësh me Tjetrin. Të njohësh Tjetrin, do të thotë të fillosh ta respektosh. Të respektosh do të thotë të tolerosh. Të tolerosh do të thotë të bashkëjetosh. Bashkëjetesa është një element kulture. Kapërcimi i kufijve gjeografikë, midis disiplinave dhe diskutimeve, bëhet i mundur vetëm nëse ai apo ajo që udhëton ia del të zhvendosë kufijtë e brendshëm. "Po udhëtoj brenda vetes" thotë Julia Kristeva, filozofja e shquar bullgare. Vetëm në këto kushte idetë ngrihen mbi dëshpërimin dhe ta kuptosh këtë nuk është epamundur.

**Ora 12:00-12:30**

Autorët lexojnë

**Andreas Dushi** (Shqipëri); **Mimoza Hysa** (Shqipëri); **Ivana Trajanovska** (Maqedonia e Veriut)

**Ora 12:30-13:30**

Paneli 2

Meta(for)a në kohën e "qenve" Mes "Dëshiroj" dhe "Duhet"

Pjesëmarrës: **Kalin Terziyski** (Bullgari); **Stefan Çapaliku** (Shqipëri); **Rita Petro** (Shqipëri); **Oleksandr Mykhed** (Ukrainë) Moderatore: **Milena Selimi**

Gjuha: **Shqip, bullgarisht, anglisht**

Një hapësirë për paraqitjen e mendimeve të papërpunuara, përshkrimet e pakapshme, të papajtuësme me askënd dhe asgjë, për rrëfimin e zhveshur nga "Dëshiroj" dhe "Duhet", ku shfaqen veç mendimet dhe ndjenjat. Për letërsinë që trondit e revolton "turmën". Me shkrimtarin e Çmimit Europian Terziyski, që beson se shkruan në "kohën e qenve", në atë kohë kur shkrimtarët shkruajnë vetëm gjëra të tregtueshme dhe Çapaliku, që sjell njeriun e epokës moderne ku "secili çmendet në mënyrën e vet". Me Rita Petron që beson se jeta është si stil i lirë - duhet të mbash ritmin, të dish frymëmarrjen. Në momentin që i mban të dyja, mund të ecësh sa të duash, madje edhe në jetë...! Si do ta quajmë



**E enjte, 6 tetor 2022**

Muzeu Historik Kombëtar, *salla "UNESCO"*

**Ora 10:00-11:00**

**Paneli 1**

Labirinthi i kohës

Aty ku e kaluara matet në mijëvjeçarë, historitë janë të panumërta.

Pjesëmarrës: **Dragan Velikic** (Serbi); **Mimoza Hysa** (Shqipëri); **Besnik Mustafaj** (Shqipëri)  
Moderator: **Ben Andoni**  
Gjuha: **Shqip, anglisht, serbisht**

Në labirinthin e një paraleleje mes historisë personale dhe asaj kombëtare; histori shtetesh dhe qytetesh, histori qytetërimesh dhe jetësh individuale. Çdo gjë i nënshtrohet rishqyrtimit dhe riinterpretimit. Heronjtë e djeshëm të sotëm janë tradhtarë, spiunë, ose alkoolikë. Sikur të kemi vendosur që historinë tonë personale ta zëvendësojmë me gjithçka që nuk na përshtatet me përmbajtje të dëshirueshme dhe ta shpallim atë një të vërtetë të sapozbuluar. Fitoret e së shkuarës i shohim jo si fitore e një ideologjie, por si një triumf i mentalitetit - në fakt, një pasqyrim i potencialit negativnjerëzor.

**Ora 11:15 -11:45**

Autorët lexojnë

**Virgijl Muçi** (Shqipëri); **Dragan Velikic** (Serbi); **Brajan Sukaj** (Shqipëri)

**Ora 12:00-13:00**

**Paneli 2**

Gjuha-Atdhe brenda Atdheut

Pjesëmarrës: **Nikola Madzirov** (Maqedonia e Veriut); **Ervina Halili** (Kosovë); **Ayfer Tunc** (Turqi); **Andriy Lyubka** (Ukrainë)

Moderatore: **Milena Selimi**  
Gjuha: **Shqip, maqedonisht, turqisht, ukrainisht**

Të rritesh mes dy gjuhëve, dy ideologjive, dy sistemeve, dy gjeneratave, kufijve të dukshëm, qyteteve të padukshme. Letërsia e vendeve tona rrethohet nga emra të letrave që nuk e kanë vërtetuar suksesin, bombarduar në një propagandë mediatike emrash të sotëm, të pavërtetuar për vlerën. Gjuha mund të vendosë kufij të caktuar, që mbeten më shumë imagjinare, pasi autorët sot largohen nga vendi i gjuhës së fëmijërisë së tyre. Madzirov, "Gur i zhvendosur", rikthim i fuqisë, hapësirës dhe paqes. Poetja Halili, që "procesin e reflektimit e të shkrimit e sheh si zbulesë të po asaj kujtese që veçse është brenda nesh, por e kemi harruar".

**Ora 13:00-13:30**

Autorët lexojnë

**Ayfer Tunc** (Turqi); **Besnik Mustafaj** (Shqipëri); **Ylljet Aliçka** (Shqipëri)

**Ora 13:30-14:00**

Lexime / Klubet e Librit / Gjinnazet e Tiranës / Festivali i të Rinjve

**Ora 14:00-16:00**

Pushim

**Ora 16:00-16:30**

Autorët lexojnë

**Vera Bekteshi** (Shqipëri); **Gjoko Zdraveski** (Maqedonia e Veriut);



**Azem Deliu** (Kosovë); **Alban Tufa** (Shqipëri)

**Ora 16:30-17:30**

**Paneli 3**

Harresa si proces i ripërtëritjes / Kujtesa si pasqyrë e ndërgjegjes

Pjesëmarrës: **Vera Bekteshi** (Shqipëri); **Persida Asllani** (Shqipëri); **Ag Apolloni** (Kosovë) Moderator: **Fatmira Nikolla**  
Gjuha: **Shqip**

Çështja e "përbaljes me të kaluarën" dhe pikënisja për të sotmen.

Shumë ideologji dhe shumë pak njohuri, kjo është karakteristikë e kësaj hapësire dhe nuk është aspak një pikënisje e mirë për çdo përbalje. Çështja e kërkimit të "spiunit", apo disidentit, kërkimi për të zbuluar lidhjet e ndryshme të fshehura, kombinimet e fshehta, zbardhja e rrjetit të interesave. Pa përmendur fatkeqësitë e tjera që kanë prodhuar politika të caktuara. A mundet ta rindërtojmë të kaluarën? Çfarë ndodh kur përpiqemi të rindërtojmë të re ndërtesën e së kaluarës nga përbërësit e saj të shpërndarë.

**Ora 17:30-18:00**

**UKRAINE-STOP WAR**

Fjalë dhe Luftë. Poema dhe ditaret e luftës për Ukrainën. Poema si akt rezistence.

A ofron poezia shpëtim gjatë Luftës?

Lexime të autorëve: **Halyna Kruk** (Ukrainë); **Oleksandr Mykhed** (Ukrainë); **Natasha Lako** (Shqipëri); **Andriy Lyubka** (Ukrainë); **Izet Sarajlić** (Bosnje- Hercegovinë); **Paul Celan** (Gjermani); **Nikola Madzirov** (Maqedonia e Veriut)

**Ora 18:00-19:00**

**Paneli 4**

Koha - si rrjedh ajo në letërsi nga kultura e një populli në një tjetër

Pjesëmarrës: **Tom Kuka** (Shqipëri); **Namik Dokle** (Shqipëri); **Dorian Koçi** (Shqipëri); **Sebnem Isiguzel** (Turqi) Moderator: **Luella Myftari** Gjuha: **Shqip, turqisht**

Romani historik, pasqyrë e një shoqërie, në një periudhë të plotë që vjen në jetë në një mënyrë unike, duke portretizuar paragjykimin së bashku me aventurën, aksionin, dashurinë, situatat komike dhe tragjike. Koha ka vende, mënyra, zakone, tradita, besime fetare, të vërteta personale, por gjithashtu nevojat e brezave të ndryshëm që janë thirrur për të bashkëjetuar. Njëpërmjet së kaluarës flasim për të sotmen dhe për të nesërmen. Vetëm atëherë letërsia ka vlerë.

**Ora 19:00-19:30**

Autorët lexojnë

**Anna Kove** (Shqipëri); **Ag Apolloni** (Kosovë)

**E premte, 7 tetor 2022**

Muzeu Historik Kombëtar, *salla "UNESCO"*

**Ora 10:00-11:00**

**Paneli 1**

Fjala lind përmes Heshtjes

Pjesëmarrës: **Erina Çoku** (Shqipëri); **Gjoko Zdraveski** (Maqedonia e Veriut); **Halyna Kruk** (Ukrainë); **Lulzim Haziri** (Maqedonia e Veriut); **RékaMán-Várhegyi** (Hungari) Moderator: **Milena Selimi**

Gjuha: **Shqip, maqedonisht, anglisht**

Kujtesa, e cila nuk është shuma e kujtimeve të ngjarjeve të jetuara, po është një botë e mjegullt, gjithësi fantazmagorike, e depozituar në fundpuset e shpirtit dhe me një atmosferë të atillë që përbën habitatin e natyrshëm të imagjinatës së autorit, apo të metabolizmit ndërmjet imagjinatës dhe ngjarjeve të asaj që quajmë botë reale.

**Ora 11:00 -11:30**

Autorët lexojnë

**Brajan Sukaj** (Shqipëri); **Senem Cevher** (Turqi); **Stefan Çapaliku** (Shqipëri)

**Ora 11:30-12:30**

**Paneli 2**

Be the change you want to see  
Ji ndryshimi që kërkon të shohësh

Pjesëmarrës: **Natasha Lako**

(Shqipëri); **Brajan Sukaj** (Shqipëri); **Senem Cevher** (Turqi);  
**Arta Marku** (Shqipëri) Moderatore:  
**Alda Bardhyli** Gjuha: **Shqip, turqisht**

Figurat ekstreme njerëzore duhet të përshtaten gjithmonë me çizmet e ngushta të "shpirtit të kohës". Autori drejt lexuesit, për t'u afruar me emocionet e tyre, historitë e tyre, vlerat e tyre kulturore, të shkuarën dhe të ardhmen e tyre. Liria, diçka qëduhet mësuar. Përparimi i qytetërimit sot, për fat të keq, matet nga dimension i pasurisë materiale, konsumizmi, zotërimi, individualizmi, dhe jo nga dimension i pasurisë shpirtërore, njohurisë, mirëkuptimit, dashurisë. Atëherë, si të ruajmë shtëpinë, tokën, botën dhe gjithçka tjetër në një kuptim (meta)fizik?

**Ora 13:00-14:00**

**Paneli 3**

E-book, audiobook - tendencë apo versione?!

Pjesëmarrës: **Eris Rusi** (Shqipëri); **Alban Tufa** (Shqipëri); **Luella Myftari** (Shqipëri) Moderator: **Andreas Dushi**  
Gjuha: **Shqip**

Si shkruajnë autorët e shekullit XXI, ruajtja e shkrimit, apo tendenca për teknologjinë e kohës. Si bëhemi më shpejt të njohur? Botime, apo versionet e rrjeteve sociale?

**Ora 14:00-17:00**

Pushim

**Ora 17:00-18:00**

**Paneli 4**

Trans (Port) -Rruga e mundimshme drejt Tjetrit.

Nga një gjuhë në tjetrën. Nga një kulturë në tjetrën.

Pjesëmarrës: **Ben Andoni**, **Maniela Sota**, **Milena Selimi**, **Erion Gjatolli**, **Kristo Pulla**, **Blerta Hyska**, **Anna Kove**, **Aida Baro**.

Moderatore: **Luella Myftari**

Gjuha: **Shqip**

Njeriu nuk mund t'i mësojë dot brenda një jete njerëzore të gjitha gjuhët e botës, madje as ato më të përhapurat e më të përdorshmet, shoqëria dhe tërë autoritetet e saj e kuptuan se pa përkthyesit rruga e mundimshme drejt njohjes do të ishte edhe më rraskapitëse. Umberto Eco thekson se "zanati i përkthyesit është një profesion që i përket së ardhmes", çka do të thotë se bota moderne nuk do të mund të bëjë dot pa përkthyes.

**Ora 18:00-19:30**

**Paneli 5**

Nata Ballkanike Found in Translation

Te "Nata Ballkanike", edhe këtë vit publikun e Tiranës e presin çaste poetike, momente që të mbeten në mendje, situata gazmore dhe libra që të bëjnë për vete, në natën më të bukur të leximit në Tirana Gate 2022.

Pjesëmarrës: **Gjoko Zdraveski** (Maqedonia e Veriut); **Erina Çoku** (Shqipëri); **Nikola Madzirov** (Maqedonia e Veriut); **Ervina Halili** (Kosovë); **Sebnem Isiguzel** (Turqi); **Kalin Terziyski** (Bullgari); **Lulzim Haziri** (Maqedonia e Veriut)

Disa javë më parë, i ra ziles së derës sime administratorja e re e pallatit ku unë banoj. Kishte një zë epshndjellës, vështrim prej kaprolleje dhe një mendje inxhinieri. Madje, kështu ishte në të vërtetë: inxhinierë.

- A jeni i intabuluar?<sup>1</sup>

- Nuk e di. Ndoshta. Nuk e di fare ... Nuk besoj.

- Do të thotë se jeni i njeriu i fundit i paintabuluar. Nëse nuk intabuloheni, nuk mund të fillojë konsolidimi i pallatit.

U ndjeva fajtor para të gjithë fqinjëve të mi, por nuk guxova të pyesja se çfarë do të thotë të intabulohem. Thirra në ndihmë njohuritë e mia shkencore, letrare, gastronomike, erotike. Më kot. Për ndryshe, m'u shpjegua në mënyrë të vagët se çfarë ecejake duhet të bëja dhe çfarë letrash më duheshin. Administratoren sikur e gëlltitën shkallët e pallatit, unë mbylla derën.

Mbeta duke mbajtur në krahët e mi një fjalë të panjohur dhe misterioze. E kam përsëritur ditë të tëra në padije, e zbraza nga shkronjat dhe nga tingujt. Çdo fjalor më dukej i padobishëm. Një pjesë e jetës është e përbërë nga gjërat që nuk mund t'i emërtosh. Për katër vjet e kam pasur jetën si të një disku të prishur: gjilpëra e pick-up-it kishte mbetur në të njëjtën rreth të diskut. Melodia e shkurtër dhe e përsëritur deri në nakatosje ishin fjalët me të cilat po përpiquesha të emërtoja ato që nuk mund të emërtohen. Kam jetuar, pothuajse, plotësisht i izoluar. Ndalova së shkruari pjesë teatri. Nuk iu përgjigjesha më ftesave, nuk paguaja më kuotizacione për lloj-lloj shoqatash ku merrja pjesë paturpësisht. Nuk mund ta shihja më as njerëz – sa herë që e bëja këtë gjë më dilte më keq. Shihja i vrenjtur orën që kishte ndalur në një ditë tetori të '98-ës dhe refleksi i vranësisë më bënte edhe më të vrenjtur. U mbylla në vetvete. Por tani, mbi çjerrjen e pick-up-it të prishur, më jehonte në vesh fjala e re. Nuk e kisha hasur më parë, as nuk kisha dyshuar ndonjëherë për ekzistencën e saj. Ndjeva një zhgënjim të vogël që nuk e kisha shpikur unë. Gjithsesi, nuk isha dakord me mënyrën se si e dëgjova për herë të parë. "Intabulum" tingëllon artificiale, si tepër latine dhe neologjistikë. Unë duhej të intabulohesha. Zhgënjimi im i vogël u kthye në një kënaqësi të qartë. «Intabulum» ishte fjalë vendase dhe shumë e pasur, gjë që, në fund të fundit, e bënte më universale. U mbërtheva, me gjithë fuqinë, pas kësaj fjale. Mbase këtu qendronte edhe dalja nga situata, që, ndoshta, do ta shpjegonte gjithçka thjeshtë, gjithsesi, pa përcaktuar asgjë qartazi. Aureola që e rrethonte bëhej e dendur. Bashkonte abstrakten dhe konkretën. Pikërisht ajo që më duhej! Doja të telefonoja Gabriel Liceanu<sup>2</sup>-n, që gjendej në Paris dhe t'i komunikoj zbulimin tim. Ai punon në përkthimin e *Sein und Zeit*<sup>3</sup> dhe isha i bindur se nëse do të fusja fjalën intabulum diku në të, qoftë edhe në shënimet e nëntekstit, gjithçka do të sqarohet papritmas. Asnjë kuptim i fshehur nuk mund t'i rezistonte rrezatimit të fjalës magjike. Por nuk e telefonova Gabriel Liceanu-n për arsye financiare: nëse ai nuk do t'i kapte që në fillim tingujt e „intabulum-it”, biseda do të zgjatej shumë.

Për një kohë po sodisja thjesht intabulimin, nuk kisha kohë për letra. Ç'është e vërteta, disa ditë rresht, më fanitej edhe një ide tjetër. Kisha dëgjuar në televizor se do të zhvillohej një ndeshje futbollit Rumani-Greqi (tani ndeshja është luajtur) dhe mendova se duhet organizuar një ndeshje futbollit Rumani-Greqi antike. Madje edhe e përfytyroja. Më në fund, ideja e një ndeshjeje të tillë m'u duk ide paksa jo serioze dhe iu ktheva intabulimit. Jeta më

1 Është ruajtur fjala rumanisht për efekt stilistik të prozës. INTABULÁ, në rumanisht do të thotë regjistrimi i pronësisë ose pasurisë në regjistrin e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2 Filozof i shquar bashkëkohor rumun.

3 Vepra e filozofit gjerman Heidegger *Sein und Zeit* (Qenie dhe Kohë)

## PO INTABULOHEM

tregim nga Vlad Zografi

Përktheu nga rumanishtja Luan Topciu



Vlad Zografi është dramaturg dhe romancier, eseist dhe fizikan dhe një nga intelektualët më të shquar të Rumanisë së sotme. Ai është biri i dy intelektualëve të komunitetit shqiptar të Rumanisë, me origjinë nga Korça dhe nga familja e Dhimitër Zografit, një nga nënshkruesit e deklaratës së pavarësisë së Shqipërisë. Ka lindur në vitin 1960, në Bukuresht. Në vitin 1985 u diplomua në Fakultetin e Fizikës në Universitetin e Bukureshtit. Në vitin 1994 mbrojti tezën e doktoratës në fizikë atomike në Universitetin e Parisit XI (Orsay). Është redaktor sinjor i Shtëpisë Botuese më të njohur të Rumanisë "Humanitas".

Libri i tij i parë ka qenë vëllimi me tregime "Gjuri i majtë ose i djathtë", 1993. Një vit më vonë, ai boton romanin e "Njeriu i Ri". Ka shkruar shumë pjesë teatrale si "Isabela, dashuria ime" 1996, "Pjetri ose njollat nga dielli", ka fituar çmimin e Kritikës - Seksioni rumun i Shoqatës Ndërkombëtare të Kritikëve të Teatrit - Fondacioni Teatrit XXI. Pjesë e teatrit të Vlad Zografit janë luajtur në Suedi, Francë, Gjermani, Itali, Hungari etj. Ka botuar librin me ese "Pafundësia në brendësi", Shtëpia Botuese Humanitas, 2012 i konsideruar nga kritika si një nga librat më mirë të shkruara në këtë gjini. Ka botuar romanin "Efektet anësore të jetës", Shtëpia botuese Humanitas, 2016, botuar në çekisht dhe në serbisht. Në vitin 2018 ka botuar romanin "Shtatë tetor".

stresonte. Në fakt, çfarë kërkoja? Doja të intabulohesha edhe unë si gjithë të tjerët.

I kisha lënë vetes një ditë të tërë për t'u marrë vetëm me këtë punë. Pasi kalova nëpër disa peripeci burokratike të vogla, hipa në trolejbusin 85 me të gjitha letrat që kisha me vete dhe zbrita në stacionin Gara Obor. Hyra, paksa nervoz, në administratën financiare, dhe iu drejtova një sporteli.

Kam ardhur për intabulum.

Për intabulum.

Si ta quani ju...

M'u dhanë disa formularë, m'u tha se më mungonte kopja e letërnjoftimit tim dhe se duhet ta bëja këtë punë jo aty, por në cepin tjetër të godinës. Dola që aty, ia mora cepin tjetër ku u ndodha përballë me një repart për riparimin e televizorëve të vjetër, ku shkruhej në një karton të vendosur shtrembër „Fotokopje”. Hyra. Askush. Rreth e rrotull televizorë me zorrët jashtë. Iu afrova fotokopjatorit. Pas aparatit ndodhej një mur ndarës dhe pas

murit ndarës lëvizte një fshesë. Mbeta me sytë tek zorrët e televizorëve derisa u shfaq një grua trupmadhe, e cila e la fshesën mënjane dhe më pyeti se çfarë kërkoja. Ia zgjata letërnjoftimin të hapur tek faqja që kishte fotografinë time, por ajo insistoi të fotokopjonte gjithë letërnjoftimin, duke më thënë se kështu duhej. Nuk e kundërshtova. Pagova dhe iu drejtova cepit tjetër të godinës, ku më thanë se duhej veçse faqja e parë me fotografinë dhe se duhej të kisha me vete edhe disa letra që më mungonin. Mund të vija edhe pasdite, sepse administrata financiare ishte e hapur deri në orën gjashtë pasdite.

Kur hipa në trolejbusin 69, më erdhi nëmend përsëri ideja e ndeshjes së futbollit Rumani-Greqi antike, po e hoqa menjëherë mendjen. Shikoja nga dritarja njerëzit. Zbrita, u gjenda ngjitur me njerëzit që i kisha parë nga dritarja e trolejbusit. Për katër vjet njerëzit kishin ndryshuar. Po përpiquesha të gjeja një lidhje mes asaj që

po shikoja dhe momentit të kohës ku unë isha ndalur. Tani, pothuaj, të gjithë kishin telefona celularë, u binin telefonit, ishin të telefonuar, komunikonin. Po ndjeja se po ndodhnin gjëra shumë të rëndësishme. Firma të reja, dyqane të reja, godina të reja. Gjithë llojet e afisheve më lajmëronin se edhe kultura ishte në lëvizje. Kishin dalë në horizont fondacione e fondacione, bëheshin projekte, jepeshin sponsorizime dhe bursa, organizoheshin festivale, turne dhe ekspozita. Shokët e mi kishin ikur, iknin, do të ikin drejt Amerikës, Gjermanisë, Francës. Mendova të ngjisja edhe unë një afishe ku të lajmëroja zhvillimin e ndeshjes Rumani-Greqi antike, por s'kisha kohë ta bëja tani. Nxitoja. Duhet të intabulohesha dhe kisha shumë për të bredhur. Më në fund u ktheva tek Stacioni i trenit Obor. Hyra përsëri në atelierin e riparimit të televizorëve, ku më priste e njëjta grua trupmadhe, kësaj radhe, së bashku me një burrë, me një përparëse bojë qielli, që ishte futur i tëri në kutinë e një televizori. Nga grumbulli i letrave të mia, i zgjata vetëm një, por ajo më shpjegoi se duhet t'i fotokopjoja të gjitha. Pranova. Më pas, hyra në administratën financiare, ku s'kishte këmbë njeriu. Prapa sportelit qëndronte një zotëri, i ngrysur në fytyrë, me një vështrim të mprehtë.

- Për intabulum...

- Doni të thoni intabulum.

- Po...

- Ku banoni?

- Rrugë Jean-Louis Calderon.

Në këtë moment, a pranoj, se luajta fort, sepse e shqiptova, qëllimisht, emrin e rrugës, më një theks superfrancez. Me këto tre fjalë mund të dukesh, tamam, një spiker i TV5.

- Oooo, oui? mu përgjigj zotëria me vështrimin e mprehtë dhe me fytyrë të ngrysur.

- Mais vous parlez français!

- Un peu.

I refuzoi me një gjest si i bezdisur, të gjitha kopjet që kisha bërë, përveç asaj që edhe unë e kisha marrë me mend se duhej. Pastaj, më shpjegoi, kësaj radhe në rumanisht, se vërtetimi që ai do të më lëshonte për të bërë intabulimin ishte i vlefshëm vetëm 48 orë. Dhe se në Gjykatë, aty ku bëhej beteja e vërtetë, ishin radha biblike dhe se njerëzit shkonin aty që në katër të mëngjesit, sepse hartoheshin lista paraprake...Dhe, sikur të mos mjaftonin këto, orari i punës me publikun ishte vetëm gjashtë orë në javë: të hënën dhe të mërkurën nga ora tetë e gjysmë deri në njëmbëdhjetë e gjysmë... Refuzova të shikoj përpara.

- Vous venez dimanche, huit heures, më tha zotëria.

U tremba...

- Prisni pak...kur të vij?

- Të hënë në mëngjes, në tetë, siç ju thashë pak më parë. Sporteli gjashtë. Pastaj shkoni në gjykatë...

Hipa në trolejbus. Isha i lodhur. Nuk mendova më për ndeshjen e futbollit Rumani-Greqi antike, madje as për intabulimin nuk po mendova më shumë aq seriozisht. Me të mbërritur në shtëpi fillova të urrej egërsisht kafshën e neveritshme që është shteti. Nëse një milion bukureshtarë duan të hipotekojnë pronat dhe nuk do të arrijnë dot, me herë të parë, në gjykatë, do të duhej të blinin nga e para pulla fiskale prej 20 mijë lei dhe kështu kafsha-shtet do të fitonte lehtësisht njëzet miliardë lei. Isha shumë nervoz kur më telefonoi kushëria ime nga Amerika. Ia tregova edhe asaj.

— Do ta shkruaj në Amerikë historinë tënde me intabulimin, shpresoj që të më lejosh për këtë... Ndjeva se po bija përtokë: tek "entabulare" nuk më kishte shkuar mendja. Flisja si një makinë automatike në telefon, në realitet kisha rindërtuar radhën e mendimeve të mia. Në fund, thashë se "entabulare" tingëllon si më e çmuar. Mbeta tek zgjedhja ime e parë. Versioni i ri më

kishte hutuar për një çast, por tani ndihesha më i lidhur se kurrë më parë me intabulimin

Deri të hënën, paretëdija ime gjithë përsëriti fjalën. Si e quan atë pjesë të paqajtur të jetës që, kundër një zinxhiri të vazhdueshëm krimesh, aksidentesh, marrëzish dhe verbërie, të sjell një gazmim të thjeshtë dhe të sjell më afër njerëzve? M'u kujtua testamenti i Beethovenit nga Heiligenstadt. M'u kujtohet muzika - prej katër vjetësh, pasi nuk mund të dëgjoj muzikë, më ndodh që të më kujtohet muzika. Edhe nëse asgjë nuk e lidh realitetin me fantazmat tona, gjërat vendosen disi në mënyrë të gabuar dhe keq, me të vërtetë, por ato zënë vend - pikërisht për këtë kam dashur prej kohësh të shkruaj një pjesë groteske. Dhe pikërisht kjo më dukej mua që ishte kuptimi i intabulimit.

Të hënën shkova vonë për të marrë certifikatën time pranë Stacionit Obor dhe u futa në gjykatë rreth orës njëmbëdhjetë. Lista ishte bërë qysh herët në mëngjes, por nuk ishin shumë njerëz. Unë kisha pozicionin e 148. Shkova te fotokopja, kërkova një formular kërkese dhe më thanë se duheshin dy. Mora dy. Pagova. U ndjeva shumë më i qetë sesa kur pata hyra për herë të parë në administratën financiare. Po shihja nga dritarja dhe nuk e di se si më erdhi në mendje aria nga opera ime e preferuar, *L'Incoronazione di Poppea* e Monteverdi-it. Më pas kuptova se opera duhet të quhej *L'Intabulazione di Poppea*. Ia thashë menjëherë atij që mbante listën, dhe ai më buzëqeshi shtrembër:

"Gjithsesi, me këtë nuk mbërrini në Romë.

Shumë prej atyre që ishin në listë mungonin, më erdhi radha për çudinë time shpejt. Hyra. Dera nuk mbyllej mirë, u përpoqa ta mbyll me zor. Kisha para meje një grua të re, tmerrësisht elegante. Për më tepër, kishte bërë buzët me të kuq në mënyrë të dhunshme, e pudrosur dhe me makijazh të mbingarkuar; byzylykë, unaza, vathë. Çdo gjest shkaktonte një ujëvarë tingujsh. Karrigia prapa tryezës ku ishte ulur duhej të ishte një lloj froni. Më erdhi në mendje *Poppea*. Dueti në fund të operës, një nga faqet më të bukura muzikore të kompozuar ndonjëherë.

- Ju?
- Për intabulim.
- Intabulim.
- Si thoni ...

I hapa letrat mbi tryezë. Duhet të kishit plotësuar vetëm një kërkesë. E mori dosjen time dhe e përplasi atë mbi një grumbull dosjesh.

- Ejani pas dy javësh. Tjetri.

Mendova se kishte diçka tjetër për të bërë, nuk mund të kishte qenë kaq e lehtë. Hezitova për një moment. Pastaj dola, duke e lënë tjetrin të kujdeset për derën që nuk mbyllej mirë.

Bëra rrugën deri në Shtëpinë Botuese pa asnjë mendim. Një pushim të qetë në të cilin admiroja i zbrazët botën e transformuar në katër vjet mungesë. Nuk dukej më mirë apo më keq. Ishte thjesht ndryshe nga sa e dija. Por ndihesha tashmë gjysmë i intabuluar. Në shtëpinë botuese, gjeta Dan C. Mihăilescu-un. Dan di të jetë plot me energji, të shpërthejë plot jetë pa dëmtuar frikën dhe errësirën. Unë kam humbur çdo lloj delikatese. Pimë kafënë e blerë prej tij. Nuk e kishim parë njëri-tjetrin për një kohë të gjatë.

- Ç'ke bërë ndonjë gjë tjetër? më pyeti Dan.

- Shiko, po intabulohem.
- Çfarë do të thotë?

Dhe fillova t'i tregoja për intabulimin tim.

- Dëgjo, dëshiron të shkruash për shtojcën letrare LAI?

"Po", thashë, ndoshta me vendosmëri.

(Botuar në Shtojcën Kulturore Letrare, Arte & Idei, 2002)

# PËR SHKAK TË HËNËS

*Cikël poetik nga Xhelal Tosku*



është hëna që më mbajti në katund

për shkak të katundit  
nepër net  
e bukur hëna është vetem në katund

pemët, kodrinat të gjitha në argjend

për shkak të hënës  
nepër net  
katundi është i gjithi bukuri

përrenjtë dhe fushat të gjitha në argjend

dhe plepat anës lumit dhe lumi vetë i gjithi  
në argjend

për shkak të katundit edhe hënës  
dhe sidomos për shkakun tend  
nepër net trishtimi im i gjithi në argjend

unë kurrë nuk ika nga katundi

\*\*\*

kaq e ngadaltë era kaq e lehtë  
ka rënë mbrëmja  
as edhe një fije bari nuk lëkundet  
në fund të uj'rave të lumit  
hëna si një monedhe e vogël argjendi  
të kam mbajtur të fshehur gjithmonë

\*\*\*

të gjallet çfarë dinë për jeten

çdo ditë që ikën  
më afron me ty

të kam në mes të shpirtit  
si farën që era mbjell  
në mes të tokës

të vdekurit për vdekjen asgjë nuk thonë

\*\*\*

u ngrit nga një pemë aty afër  
u ngrit nga një pemë diku

shumë larg  
fluturoi në qiell dhe humbi  
kjo është e gjitha

u shkëput nga qielli aty afër  
u vërtit nga qielli diku larg  
u rrëzua në toke dhe humbi  
kjo është e gjitha

vendose kokën në supin tim  
sepse je ti ajo që mua më mban  
dhe jo unë ty.  
dhe kjo është gjithçka

\*\*\*

ti ke qenë gjithmonë e lumtur  
unë kam pas net  
kur doja të vdisja

ti ke qenë gjithmonë e lumtur  
unë kam pas net  
kur nuk e di pse doja të jetoja

ty po të them moj ty  
që e dije se të doja

\*\*\*

nata do jetë e errët

burri nuk rri në burrë

xixëllonja ime  
çfarë të bej unë  
me driten tënde të vogël

\*\*\*

asgjë tjetër më shumë se gjethet në vjeshtë  
nuk më mësoi sa zgjat jeta  
për çdo mëngjes dhe për çdo mbrëmje  
zëri yt më shkund nga trishtimi

\*\*\*

m' thotë: dil nëqytet  
mylli sytë, mos boj dashni  
jam qorru krejt

jam bo i verben  
më man e dashuna perdore

\*\*\*

dimër dimër  
harabel i vogël  
e kam një sy që gjithmonë me qan

\*\*\*

sidomos vjeshtës  
rrezja e ndonjë ylli të largët  
qetësohej netëve në floket e tu

ti fillove të kishe frikë xhelozinë time.

\*\*\*

kaq shume lule në varreza  
dhe të vdekurit vazhdimisht i refuzojnë

\*\*\*

vetëm vdekjen kam të sigurtë  
as bari as kope  
shi  
shi  
shi  
lëkura ime nuk është atdheu i askujt

\*\*\*

bota është po kjo që ka qenë

ti zgjodhe parajsën  
unë pranova ferrin

syri yt është syri yt  
askush nuk di pse nesër unë do vdes

\*\*\*

nën diell në shi në ere  
bredh ngado  
kjo bushtër kotësie  
edhe nën yj edhe nën hënë  
dhe klyshët e saj  
që e duan me kaq endje

pres çastin tim  
t'i them lamtumirë.

\*\*\*

tani unë dua të fle  
ti mbyll sytë dhe të thërras ty  
të më vësh në gjume

nëse do më vësh dot në gjume

kur të zgjohem nëse do kem fjetur  
sapo t'i hap sytë  
patjetër fytyrën tende do kem përpara  
që nuk më hiqet dot nga sytë

\*\*\*

mbrëmja bie aromë portokalli  
pa ty vetmia zmadhohet  
më e madhe bëhet hëna mbi cati  
më bëhet sikur do vdes shpejt

\*\*\*

zot im  
unë njeri ti perendi  
kush e vret njeriun

**B**ookland. Një mbretëri më vete... Po të mos kisha qenë për orë të tëra në atë Librari s'do ta kisha shkruar këtë refleksion. Dhe pse jo një *ese*, apo *reportazh*? Përgjigja është e thjeshtë: u futëm 'në të thella' për shkak të gjëmës që i ka rënë në kokë librit. Po pse po i shihja edhe të tjerët, gjithnjë me pamjen indiferente po edhe krenare mbi hapësirën e gjerë të librarisë, duke zotëruar një mahnitje që i përfytyroja si mendime të paarrira. Këtë mundësi ta krijon vetëm një hapësirë libri si kjo ku jam! Librarja është e emocionuar, teksa e sheh mes librave për të gjitha moshat dhe interesat, nganjëherë të thotë mendja se *ato* janë ngurtësuar në mermer, madje i përfytyron me trupa të lartë e të drejtë, shoqëruar me pamjen e qeshur (do të ishte ideal një përfytyrim i tillë muzeal për librin, por *ky* nuk është muze!), prandaj bindesh se qenka më frymëzuese të shkosh drejt të panjohurës, të paktën për të mos iu larguar ëndërrimit tënd...

Megjithatë, të shumtat e bisedave me të i kemi bërë tek salla e madhe e *Librarisë Bookland*, e cila është e veshur me libra, vendosur gjithë kulturë, në një çrregullim estetik tërë zbukurimorë prej lashtësisë, çka ta bën vetvetiu të afërt gjithçka. Aty edhe mund të habitesh me njohuritë e saj për letërsinë, e cila sikur e bën më të afërt me dëshirën dhe ëndërrimin e gdhendur në fytyrë e portret dhe të gjitha këto e veshin me një lloj novatorizmi që duket i pranishëm me ty, me një poetikë të ndritshme...

Këtu në librari, nuk e di sesi, mendova se ç'nder i bën kombit, historisë dhe gjuhës shqipe ai që investon kulturë! Një librari të madhe, të imponon tjetër kulturë, i jep personalitet kulturës kombëtare, pasi mundohet t'i dhurojë frymë kësaj pjese të qenësishme të jetës tërë kompetencë e klas, për gjithë zbulimet e bëra (se me librin zbulon gjithnjë *botë të reja!*) dhe me guximin që t'i përplasat padyshim si gjëra krejt të veçanta, me një novatorizëm të jashtëzakonshëm, në radhë të parë sepse kjo gjë bie në sy. Disa edhe nuk arrijnë ta kuptojnë këtë përplasje kokëforte të kulturës, por harrojnë se, të zotëroje universin e një njeriu të ditur e të kulturuar dhe pastaj të shkelje në shtigjet e udhëzuara prej librit, do të ishte me vite dritë larg të tjerëve. Shtoj këtyre edhe një foto të Kadarese, e Migjenit, Lasgush Poradecit, po edhe të Skënder Luarasit - një nga korifenjtë e përkthimit shqiptar - gjaku të buron me shkullma, sepse të vjen mirë dhe kjo do krijonte një arkipelag dijeje të rregulluar me magji e dashuri. Në këto kushte jemi sot, them, duke biseduar me Ridën, gjithnjë e shoqëruar me hijen e një gjetjeje fantastike, duke krijuar tjetër atmosferë në Librari. Se ç'kishin bërë të tjerët deri më sot? Kishin hapur librari, biblioteka, kishin qemtuar prej librave edhe gjërat më të imta (dhe kjo ishte lufta që bënin në frontin e tyre, ishte detyra e ngarkuar!), kurse të *Librari Bookland*, gëlon nga zërat e vjetër (po edhe të rinj) që e nxitnin të personalizuar me plot durim të skajshëm duke i dhënë magjishëm një frymë të re dhe me ndjenjë e elegancë

*Refleksion pas një bisede dhe meditimi të gjatë për librin në Librarinë "Bookland"*

## BOOKLAND LIBRARI - TË TRONDIT ME NOVATORIZMIN E SAJ

*Nga Xhevair Lleshi*

të përsosur. Rrallë, shumë rrallë qëllon të jetë kështu...

Ndërkohë ujërat i trazon zilia. Pikërisht ajo është në gjendje të hapë një front lufte të papërballeshëm, por Rida, zotëron shumë intuitë, të cilën njeriu o e ka, o s'e ka. Dhe atëherë përbiron me aftësinë e shenjtëruar në përbaljen gjigante me autenticitetin, me gjërat e mëdha (se ajo është e prerë për t'i bërë ato), duke hyrë në luftë dhe duke dalë prej saj edhe më e fortë, e prerë në të gjitha gjërat që kumton. Talent, ja ç'është! Edhe kur e mendojnë që do të "mbytej" në punët e mëdha të revistës *Living*, po edhe me botimet energjike *Living*, edhe kur e ngenë në qiell, talenti gjithnjë ka një parzmorë tjetër përpos asaj që duket, jo thjesht për t'u mbrojtur, as për t'u dukur, por që tek Rida e Livingut vinte si një shqisë plus. Epo këtë mund ta kërkojë sa të duash me qiri, por nuk e gjen dot kurrë! Ajo është aq e thjeshtë, saqë të shoqëron në çdo hap, por ja që ti (natyrisht vetëm ti) nuk e sheh dot se të mungon pikërisht kjo shqisë. Ridën e shoqëron ajo gjë që i thadron kuptim veprës së saj, pasi kurdoherë e mat veten me punën vitale dhe plot hijeshi të librit, në një librari të madhe dhe kaq elegante, që është (ashtu ka për të qenë gjithnjë), një vrapim i largësive të mëdha. Ç'fat po edhe ç'punë i duhet, që personalitetin e saj t'ia japë krejt librit!

Kureshtje, polemika, debate, në libraritë dhe bibliotekat e munguara, të cilat ende (shumica) flenë nën dhë. Dhe çfarë gjumi! E pse jo? A nuk duhet që një vend kaq i vogël si ky yni, të mendojë ditë e natë për *vazhdimësinë*? Po atëherë, në një mënyrë cinike të bësh gjumin e madh dhe t'i mbyllësh sytë përpara dy fakteve jo të zakonshme: trashëgimia kulturore që vjen nga lashtësia (arkeologjia, folklori, etnografia...) dhe gjuha shqipe, letërsia shqipe, shkrimtarët shqiptarë, përkthyesit e mëdhenj të fjalës shqipe. A nuk e shihni se kjo gjuhë bashkë me institucionet e librit po vdesin? Gjuha shqipe, sepse kështu si po ndodh, largimet masive të bashkëpatriotëve tanë, të fëmijëve tanë!, me fondet e pa krijuara dhe as të imagjinuara të përhapjes dhe të mësimi të saj, kudo në botë ku ka shqiptarë, si një dorë e ngrohtë e qeverive tona në ndihmë të përsosjes së të qenit *njeri* dhe *shqiptar*, përhapjes masive të

bibliotekave të kudondodhura, po edhe të pranisë së trashëgimisë së gjetur kudo. Sa mirë do të qe! Shkollat i kemi dhe ato i përkasin komunitetit ku janë, por kërkesa për të pasur në to gjithçka shqiptare, është e detyrueshme, krahas me paketën e mbrojtjes së gjuhës shqipe, të librave shqip kudo në botë, në çdo familje shqiptare... Mos i quaj kurrë të tepërta këto! E para dhe e fundit është **libri** dhe një bibliotekë që nuk humbet kurrë kur është në një shkollë. Pra, ideja ime është: shkolla shqipe e ka të detyrueshme të ketë muzeun, bibliotekën fizike dhe atë elektronike, duke i qasur në një trung zhvillimor. Ndërkaq ai të thotë se karakteri yt duhet të bëhet një me atë që krijon. Se në këtë mënyrë i jep shumë fisnikëri kombit tënd, i jep dritë asaj që bën. Në këtë realitet Rida hedh sytë me guxim drejt të ardhmes së librit fizik dhe elektronik, vënies në punë të teknologjisë, të telefonit. Libri duhet të jetë i pranishëm te çdo telefon celular, si një program më vete. Po edhe në grupet mediatike, në portale, televizione...

Kultura jonë, mbështetur në trashëgiminë e saj ekspresive, të gjallë dhe mjaft aktive, ndjell shumë kureshtarë. Prandaj, or mik, duke qenë në zgrip është mirë të kapemi pas ndonjë rrënie apo guri dhe të gjejmë fondet e duhura nëpërmjet parave që shteti duhet t'i kursjë po edhe t'i planifikojë në dobi të bibliotekave, muzeumeve dhe ekspozitave të artit në të gjitha shkollat shqipe, kudo që janë, edhe në botë. Kjo është domosdoshmëri ekzistence, prani kulturore dhe rrezatim kombëtar. E kemi ende gjallë, ndonëse në grahamat e fundit. Ta duam sa të kemi dëshirë kur të mos jetë, aha, ka ikur vapa me gushtin! Jo ligj sponsorizimi të vësh po edhe në përrallë ta kthesh, ajo është e destinuar të vdesë! Dhe ty të rruat shteti, pavarësia, po edhe çfarëdo tjetër si fasadë, por ama pjesën tënde më të qenësishme nuk e ke më! Dhe detyrimisht brezat që vijnë do t'na mallkojnë!...

Po si mund të arrihet e gjithë kjo ngrehinë? Thjesht, duke u kujdesur. S'ka nevojë të ngresh monumente të reja, ruaji të vjetrat dhe ato sajojnë të rejtat me fytyrën e tyre, me statujat, veglat e punës, veshmbathjen, bibliotekat, ekspozitat, historinë që nuk vdes kurrë. Ne nuk e kishim

dhe u arrit të jetë e pranishme! Fitore e pallogaritshme. Tani që e patëm edhe ende e kemi (ndonëse në zgrip të madh) nuk dimë si të bëjmë me të! Nuk dimë sepse në plan të parë kemi vënë pasurimin tonë. Fundja *Bookland Librari* që kemi para syve nuk do të flejë më nën strukturat burokratike të Ministrisë së Kulturës, por do të zgjohet dhe me dhjetëra librari të tjera, kudo, me shqiptarë të shkolluar edhe sot e kësaj dite në Perëndim nuk kanë pse të lajnë enët andej-këtej, por të tregojnë se janë tonat dhe se nën dhë tek ne flitet shqip, të paktën të çojnë më tej atë që bëjnë ne deri tani. Se shembullin negativ e kemi gjallë: Veprën e madhe të rilindësve të vërtetë e propozën para syve tanë të rinjtë me të njëjtin emër!

Nuk ka nevojë të shpallim mite sot për gjuhën shqipe, për librin shqip, qoftë edhe pa e zënë ngoje këtë, se, thjesht, po s'pati shqiptarë në këto troje, gjuha shqipe do kthehet se s'bën në monument kulturore "të mbrojtur nga shteti"! Le të themi pastaj, sa të duam e ç'të duam, është gjë e vlerë - edhe duke e kërkuar nën dhë - prapë ka për të qenë punë boshe. Kurse, ndërkohë, të gjitha shumëzohen me zero! Prandaj e dua këtë skaj të botës shqiptare, librarinë tonë *Bookland*, po edhe Bibliotekën e Re Evropiane për Fëmijë, ende të ngritur në përfytyrimin tonë! Fundja, a nuk duhet të ëndërrim?...

Megjithatë do të ishte bukur sikur të ngacmoheshin nga pak këto **mite**. Do të ndienim aromën e vjetër, një amë krejt e veçantë që ta sjell edhe më pranë atë që do. E të gjitha këto që them duan mençuri dhe kjo le të jetë edhe intuitë, paramendim, shkathtësi... E shoh me ngulm dhe botuesja plot personalitet i përkëdhel. Edhe përkëdhelia e librave është e bukur. Dhe kjo padyshim ngjan me fjalën...

Ja, pse s'i vete mendja askujt që ta ringrejë një bibliotekë shkollë dhe komuniteti në ndërtesën shkollore!? Çdo burokrat këtë e quan një përrallë nga e kaluara. Sepse nuk është aq e lehtë të hysh në botën e librit. Nëpërmjet librit, tek e fundit, njohim zhvillime, kulturë, intimitet, art, dashuri. Kështu, duke bartur brenda vetes frymën e lartë të kulturës, jashtë botës sonë të zakonshme, duke e kthyer çdo libër të lexuar, në karakter, personalitet... Pikërisht kjo të jep kurajë për të qëndruar fort si legjendë e së nesërmes, ndërsa hyn dhe, pasi përsëndet, ligjëron me madhësinë e dijes, ashtu siç ndodh rëndom, pa ndierë fare krenari. E duan këtë librari, pëshpëritin për të, e shajnë me zë të ulët (sepse kjo e uruar duket kaq elegante, po edhe mjaft krenare!), nuk e durojnë, saqë shpifin për të... Pastaj e ledhatojnë me sy, e pëlqejnë. Se *Libraria Bookland* është sfidante pa dashje, por ama rrezatim energji pozitive.

Ndryshe nga të tjerët, mes këtyre librave ndihesh si bashkëbisedues, ndonëse nga larg duket sikur kanë pamje të paafërshme, të ftohtë. Pa vajtur ende te buzëqeshja e tyre. Se në buzëqeshjen njerëzve, përtej asaj maske libri ndihet një ndjenjë aristokratike, e lirë, e gdhendur, e dhënë, lirike, e dëshiruar, pse jo edhe për një grimë pritës i një urimi. Aventurë? Po edhe aventurë! E do këtë libri. "Kemi ende shumë gjëra pa bërë. Të gjitha i kam nisur por nuk e di... Ah! Edhe mëdyshem. Sepse dua të kundërshtoj fort. Edhe një libër, se ka jo pak gjëra për t'i shkuar mu në dyert e të pamundurës, që të shpien tek synimi i fshehtë..." Po edhe libri vetë aludon. Qoftë ky edhe një aludim tronditës, i frikshëm, ngazëllues! Por ama është. Të gjithë pastaj presin çdo të ndodhë. Dhe Rida nuk sprapsset. E cni pranë saj që ta shihni!

Dhe pyesim veten me një lloj naiviteti: ç'gjejmë te kjo librari krejt e veçantë? Mos vallë, përmasën e pafundme e të rrezikshme të personalitetit? Se nuk bëhen thagma me personalitetin e librit! Mirëpo këto harrohen shpejt. Dhe pastaj... E çfarë pastaj? Mos duhen investime shtetërore? Mos duhet edhe një banesë aty rrotull për të shpëtuar veprën e madhe me emrin Libër? Mu *për këtë*, librarinë e madhe dhe moderne e shigjetojnë, por Rida e ka vendosur që gjithçka të bukur ta ketë libri i mahnitshëm i shkruar në shqip...



Kur isha e vogël, takova një familjar të largët që nuk mund të shihte. E kisha parë shumë pak herë para se të rritesha, kohë kur ai ndërroi jetë, por para më tepër se tridhjetë vjetësh, kaluam një gjysmë dite bashkë në një ceremoni përshtirteje. Ishte burrë moskokçarës dhe i këndshëm që ndihej i lumtur të luante me fëmijët e mërziur. “Nuk mund të shoh, por më sill çfarëdo që të gjesh dhe unë do të hamendësoj çfarë është.” Si të ishin në një garë, fëmijët vrapuan rrotull dhomës, duke mbledhur në dorë gjithë çfarë mundën: filxhana çaji, stilolapsa, shirita letre, lodra që kishin marrë me vete, gjëra që gjenin në çantat e mamave. Pa humbur asnjë çast, ai hamendësonte – dhe nuk gabonte – dhe fëmijët mund të gërthisnin të kënaqur. Ishte zbavitëse, por për kohë më pas, s’e shqisja dot nga koka idenë e atij burri. Gjatë lojës, ç’ishte ajo që ai shihte?

Ime ëmë më tha se ai s’kishte lindur i verbër. E pyeta nëse të mos ishte i aftë të shihje do të thoshte të jetoje në një botë pa dritë dhe ajo pohoi me kokë. Paçka se ai s’shihte dot tani, ka qenë një kohë kur mundej. Me fjalë të tjera, e dinte çfarë ishte drita, kishte kujtesën e saj. Nëse do të kisha mundur ta takoja dhe një herë, kam diçka për të cilën do të doja ta pyesja. Sa ndryshonin drita që ai kujtonte nga drita që ne shihnim? Ose sa ngjasonin? Në fund, asnjëherë nuk pata mundësinë ta pyesja, por nga ajo kohë, para se të më zinte gjumi, krijova një rutinë: mbyllja sytë në errësirë dhe kujtoja dritën e ditës. Doja thjesht të dija sa dhe si mund ta kujtoja dritën kur errësira më mbështillte.

Vite më vonë, u bëra romanciere dhe ktheva faqen për të shqyrtuar pyetje të tilla. Kur pjesa dërrmuese e romanit tim *Gjinj dhe vezë* është trillim, huazova vende vende nga jeta dhe përvoja e jetës time. Të dyja, tregimtarja dhe unë jemi rritur në shtëpi të varfra në Osaka, përshebull, dhe të dyja jemi romanciere.

Të gjitha ndjesitë e narratores për gjyshen që e kishte rritur janë poashtu edhe të mijat.

Gjyshja ime vdiq në fillim të verës së 2019. Për mua ishte si një nënë që më mbrojti nga gjithë llojet e gjërave. Fëmijë, ngrija nga ideja e vdekjes së saj. Veç ta imagjinoja të zihej nga ai çast i pashmangshëm më bënte të shpërtheja në të qara. Ajo kishte shpirtin më të këndshëm; ishte, pak a shumë, e vetmja arsye pse munda ta jetoja fëmijërinë time.

Nga ajo kohë që mund të kujtoj, kam qenë e frikësuar nga vdekja e gjysës time. Tani që po bëhen tre vjetë qysh atëherë, akoma përndiqem nga kjo ndjenjë paqëndrueshmërie, sikur s’do ta ndjej më kurrë forcën për t’u përqendruar. Kur shoh fotografi, nuk më ndihmon, por ia jap së qarës. Vdiq nga mosha. Jetën e kishte plot vështirësi, por jetoi deri nëntëdhjetë e shtatë pa ndonjë sëmundje serioze. S’kishte ndonjë mënyrë më të paqtë për të ikur. Bota është plot me njerëz që kanë duruar humbjen e papritur të një njeriu të dashur, dhe pavarësisht kësaj ia kanë dalë të vijnë jetën. Kur mendoj gjithë kohën që kam kaluar me të, deri në fund, ndihem sikur nuk kam të drejt të jem e trishtuar. Vërtetë, as që ia kam idenë pse vijoj të jem kaq e trishtuar. Është një mënyrë e çuditshme për ta thënë, por nuk jam unë e rritur – është fëmija që i frikësohej vdekjes së gjyshes me secilën fije të qenies së vet. Ky fëmijë është akoma diku brenda meje, dhe është kjo pjesë imja që m’i kontrollon



## Mieko Kawakami:

# PIKËRISHT PËR ATË ÇAST

Përktheu Andreas Dushi

emocionet, më mban të trishtuar. Kështu ndihem.

Nga një moshë e vogël, fytyra dhe trupi më ngjanin aq shumë me të gjyshes, sa që kur ulja sytë tek ndërroja rrobat, e zija veten duke menduar për trupin e saj. Kur mora vendimin për t’ia shkëputur transfuzionin intravenoz të lëngjeve, çka po e mbante gjallë, kaluam gjithë natën bashkë, veç ne të dyja, në dhomën e saj në spital. Tek i shihja fuqinë t’i shkëputej dalë ngadalë nga trupi, kalova orë të tëra duke e prekur, duke i ledhatuar kokën, krahët dhe kudo. Ngjyra i kishte ndryshuar prej transfuzionit intravenoz. Kur e preka, e falënderova për gjithçka – për kohën që kishim kaluar së bashku. Ishte e ngrohtë, gjaku akoma i rridhte ndër vena, por kur mendova se si për pak ditë, trupi i gruas që tani ishte para meje do të digjej e bëhej hi – si do të ikte nga kjo jetë – as që ia kisha idenë si të ndihesha. Hera e fundit kur fola me të, atëherë kur akoma kishte vetëdije, ishte dy javë para kësaj. Po buzëqeshnim teksa bënim fotografi. I thashë se do të kthehesha shpejt, duke i bërë me dorë ndërsa i mbyllja derën e dhomës së spitalit. Ishte çasti i fundit bashkë. Fundi nuk shfaqet gjithnjë duke mbajtur fytyrën e tij. Ndonjëherë e kupton çfarë ishte vetëm pasi e gjitha ka mbaruar. Sigurisht, e dija këtë, por akoma pyes veten nëse do të mund të kisha krijuar një tjetër “çast të fundit” për ne. Nëse do ta kisha vizituar ditën tjetër, për ta parë si po shkonte. Edhe sa herë të tjera do të vijoj t’i përjetoj këto “çaste të fundit” që do t’i njoh si të tillë vetëm pasi të kthej kokën pas?

Ndërsa kaloja orët duke prekur trupin e gjyshes, duke i folur kur ajo rrinte e shtrirë krejt pa vetëdije para meje, i thashë

vetes të mos e harronte asnjëherë lëkurën që po prekja. I thashë të mos harronte mënyrën si po e prekte, si po e kapte. Doja dëshpërimisht të kujtoja çdo gjë të vetme që mund të shihja, sa më mirë të ishte e mundur. Por në të njëjtën kohë, pyesja veten nëse ndonjëherë do të mundesha ta kujtoja këtë ndjesi, çfarë po ndieja me duar në atë çast. Çfarë do të thotë të kujtosh një ndjesi. Tek e prekja, ngadalë humba orientimin. Trupi i gjyshes në banjë me mua. Kishte gjëndrra të kuqe dhe, kur isha e vogël, përherë shqetësohesha se do të vdiste nga hemorragjia po t’i plasnin. Kur iu luta t’i mbështillte me ankerplast, veç më buzëqeshi dhe më tha mos të shqetësohesha. Vërtetë, çfarë do të thotë të kujtosh njerëzit që na lanë pas, të kujtosh ndjesinë që vjen e zbehet?

Vura re se po mendoja sërish për këtë. Orët që kaloja duke prekur krahët dhe këmbët e gjyshes, gjithë natën, gjithë mëngjesin, gjithë ditën. Lëkurën e kishte të ngrohtë. Ishte gjallë dhe përfundimisht, po e prekja. Por tani ka ikur dhe nuk do të jem asnjëherë në gjendje t’ia prek sërish lëkurën. Mendoj për këtë. Dhe kthehem sërish, atëherë kur isha fëmijë, si përpiqesha të kujtoja dritën në errësirë. Mendoj për dritën që familjari im i largët mund të ketë mbajtur në mendje. Ta kujtosh dritën, është ndryshe nga ta shohësh atë? Po të kujtosh ndjesinë e lëkures së gjyshes që s’do ta prek dot kurrë më? Ndryshon nga të prekurit e saj me duart e mia?

Të jesh e zonja të prekësh dikë, të jesh e pazonja ta prekësh sërish. Dikush të jetë i gjallë, dikush të jetë i vdekur e i kallur. Të shohësh dikë në jetën reale, të shohësh dikë në një ëndërr a në një kujtim. Drita

që sheh me sytë e tu, drita në mendjen tënde. Cili është ndryshimi i vërtetë mes tyre? Është e pamundur të prekësh dikë nëse e ke humbur? Drita e humbur, është vërtetë e humbur përgjithmonë? Po nëse është një botë diku, një vend ku ata janë vërtetë njëlloj dhe ne thjesht s’mund të shkojmë dot aty? Nuk e di. Por edhe nëse një botë e tillë nuk ekziston, ose nëse ne jemi të pazotët për ta arritur, mendoj se kjo është arsyeja pse shkruaj: të krijoj një moment në të cilin mund të besojmë, me gjithë zemër, se këto gjëra janë një dhe njëlloj.

*Kjo ese është shkruar për Festivalin Ndërkombëtar të Autorëve, Toronto, 2020. David Boyd është përkthyesi nga origjinali japonisht në anglisht, version nga i cili është realizuar përkthimi i mësipërm.*

\*Mieko Kawakami është një nga autorët më të suksesshme bashkëkohore të letërsisë aziatike. E lindur në Osaka, Japoni, aktualisht jeton në Tokio. Ka botuar disa libra, por famën ndërkombëtare e ka fituar me *Gjinj dhe vezë*, për të cilin Haruki Murakami shkroi: “Nuk mund ta harroj asnjëherë mahnitjen e qashtër që ndjeva kur më së pari lexova romanin e Mieko Kawakamit, *Gjinj dhe vezë*. Rrallë lexoj ndonjë gjë nga shkrimtarët e rinj, por një mik ma rekomandoi këtë vepër dhe që nga faqja e parë, e gjeta veten të përfshirë papritmas në botën e romanit.” Vitin që shkoi, romani i saj *Qiell* ishte në listën e ngushtë të *Man Booker International Prize*. Këto dy libra, bashkë me *Gjithë dashnorët gjatë natës*, së shpejti do të botohen nga shtëpia botuese “Onufri”, duke e sjellë këtë autore edhe në shqip pas më tepër se tridhjetë gjuhëve anë e kënd botës.



Georgia O'keeffe,  
Nature Forms – Gaspé

## GEORGIA O'KEEFE: NJË FORCË E NATYRËS

*Nga Rachel Corbett*

Georgia O'Keeffe e dinte se të mësuarit përgjatë gjithë jetës ishte një nga të fshehtat më të ruajtura të rinisë. Megjithëse trupi i saj kishte filluar të përkeqësohej para vdekjes së saj në moshën 98-vjeçare – ndoshta humbja më e madhe që shikimi i saj, i cili u shua si rezultat i degjenerimit makular – artistja vazhdoi të këmbëngulte në të qenët pioniere e fronteve të reja në artin e saj, duke mënjeluar ngurtësinë mendore ku bien të tjerët në atë moshë. “Mund ta shoh atë që dua të pikturoj. Ajo gjëja që të bën të krijosh është ende aty”, - shprehje e saj që u bë e famshme në atë kohë. Kështu që pikturoi nga kujtesa dhe imagjinata dhe, duke filluar që nga vitet '70, punësoi asistentë për ta ndihmuar me procesin e saj artistik. Pastaj shkoi dhe më tej.

Më 1974, kur ishte 87 vjeçe, filloi një medium krejtësisht të ri: qeramikën. Forma e prekshme ishte më e përshtatshme me shqisat e saj të ndryshuara dhe e lejoi të përjetonte emocionin e të mësuarit të diçkaje krejtësisht të re.

Ai që e ndihmoi O'Keeffe-in të zbulonte mediumin e saj të ri ishte i besuari i saj i ri dhe miku Juan Hamilton, një skulptor i cili kishte ardhur në pragun e saj në kërkim të një pune ca vite më parë. Hamilton, atëherë 27 vjeç, kishte ardhur me mikun e tij, hidraulikun e O'Keeffe-it, por artistja ikonike nuk ishte në humor për vizitorë të papritur. Fansa dhe turistë të vendosur kishin një zakon të keq që hynin pa leje te studioja e saj e veçuar Ghost Ranch në New Mexico dhe prishnin qetësinë e saj të dashur. Kështu që i përzihte. Por

kur, disa muaj më vonë, Hamilton u kthye një mëngjes dhe trokiti në derën e O'Keeffe-it dhe sërish i kërkoi punë, ajo e pyeti nëse kishte eksperiencë në paketimin e një arke transporti. “Nuk

ishte një punë që paguhej shumë, por nuk kisha gjë tjetër në jetën time – kohët e fundit isha divorcuar dhe po filloja një jetë të re, dhe Georgia ishte një nga gratë më interesante që kisha

njohur ndonjëherë”, - tha Hamilton për “Harper's Bazaar” më 2016. Filloi ta ndihmonte me dokumentet dhe punë të ndryshme rrotull shtëpisë. “Papandehur, isha aty 10 deri në 12 orë në ditë”, - tha ai.

U bënë miq të ngushtë dhe së shpejti Hamilton filloi t'i mësonte O'Keeffe-it rrotën e qeramikës. “Kur shikimi iu bë më i vështirë, ishte mediumi që zgjodhi për shprehjen e saj artistike”, - thotë Kayla Carlsen, drejtore e Sotheby's American Art. - “Mendoj se e mori seriozisht. Ishte një proces që i dukej angazhues dhe e shijonte, dhe ishte pjellore. Ka një numër të madh veprash të prodhuara rreth vitit 1980 me ndihmën dhe frymëzimin e Juan-it”.

Në kohën e debutit të saj të parë solo në galerinë legjendare 291 të Nju-Jorkut, 1917, O'Keeffe, e bija 28-vjeçare e një fermeri bulmetesh nga Wisconsin, ishte e panjohur në botën e artit. Stieglitz, atëherë në të pesëdhjetat e tij, ishte në qendër të saj, edhe si fotograf avangardë dhe si galerist influencues i Nju-Jorkut. O'Keeffe e kishte vizituar dhe përpara galerinë 291 – aty kishte parë për herë të parë vetë pikturat e Picasso dhe Matisse – por nuk e njohu Stieglitz-in derisa mësoi se i kishte ekspozuar disa vizatime pa dijeninë e saj. Fillimisht, donte t'i hiqte, por marrëdhënia e tyre, profesionale dhe personale, do të zgjaste.

Më 1 qershor 1917, pak përpara se O'Keeffe të kthehej në Teksas, ku punonte si mësuese, Stieglitz, i cili ishte ende në një martesë të palumtur në atë kohë, i shkroi: “Sa do të doja të të fotografoja – duart – gojën – & sytë – & e veshur me të zeze – me



Georgia O'Keeffe dhe Juan Hamilton te shtëpia e O'Keeffe-it në Abiquiú, New Mexico, rreth 1980

një prekje të bardhe – & fytin – por nuk doja të të merrja kohë.” Stieglitz rrjedhimisht i mbushi mendjen O’Keeffe-it të shpërngulej në Nju-Jork vitin tjetër dhe u martuan më 1924.

Në këtë kohë O’Keeffe kishte pranuar dëshirën e Stieglitz-it për ta fotografuar dhe kaloi disa vite duke pozuar për veprën e tij eksperimentale me disa pjesë. “Portreti”, i cili tashmë varet në Galerinë Kombëtare në Uashington, DC, në fund, u zgjerua në 500 fotografi, të shkrepura përgjatë 20 vjetësh. Një prej këtyre imazheve, një studim i vitit 1933 i dorës së O’Keeffe-it, fotografuar duke kapur gomën rezervë të Fordit të saj, është në shitje si pjesë e koleksionit të Hamilton-it. Është një shkrepje veçanërisht pikante duke ditur se O’Keeffe sapo kishte mësuar të ngiste makinën.

Në verën e vitit 1929 bleu makinën e saj të parë dhe udhëtoi për në New Mexico me një mike, artisten Rebecca Strand, ndërkohë që Stieglitz qëndroi në Nju-Jork. O’Keeffe përfundoi duke jetuar aty për pesë muaj, gjithë kohën duke pikturuar peizazhin, kocka kafshësh dhe dritë. O’Keeffe u gjallërua me pavarësinë e porsagjetur dhe vazhdoi të udhëtonte shpesh. Në verën e vitit 1932, ajo dhe mbesa e Stieglitz-it bënë një udhëtim për në Quebec, Kanada, duke udhëtuar përgjatë skajit të largët lindor të Gaspé Peninsula. “Dolëm nga makina për një shëtitje dhe gjetëm një kabinë nën pemë mbi një shkëmb të madh e të lartë dhe deti me një plazh ranor poshtë që ishte aq i përsosur sa ende nuk na besohet se ishte i vërtetë”, - i shkroi Stieglitz-it në një letër. - “Nuk mund të mendosh për diçka më të përsosur – nuk mund ta imagjinoja që ekzistonte një vend i tillë – shkëmbi që lartësohej pas ishte më madhështor se çdo gjë që kam parë”. O’Keeffe e deklaroi gjirin “një vend të mrekullueshëm për të pikturuar” – dhe pikërisht këtë bëri, duke kompozuar *Nature Forms – Gaspé*. Vorbullat me blu të ftohtë të erës dhe detit janë të pagabueshme, por piktura shenjon tranzicionin gradual të O’Keeffe-it drejt abstraksionit. Për Carlsen, “format joshëse dhe të valëzuara” të kujtojnë serinë e fotografive të reve të Stieglitz-it, të quajtur *Equivalent*, në të cilat drejtoi lentin për sipër “që të kishe vetëm format në vend të ndjesisë së vendit”.

Një tjetër objekt që sjell në jetë një anë tjetër të personalitetit të O’Keeffe-it të cilin s’mund ta shohim ndryshe është një kapëse flokësh argjendi në formën e germave “O-K”. Duket identike me kapësen që i kishte bërë skulptori Alexander Calder me tunxh, por kur piktores iu bënë flokët e bardha vendosi se nuk i shkonte më, kështu që punësoi një artizan për ta kopjuar në argjend kapësen.

Te Ghost Ranch, O’Keeffe ndihej më në fund si në shtëpi. Nuk lodhej kurrë nga pikturimi i peizazheve me



Georgia O’Keeffe, *Abstraksion*, 1946



Stieglitz, O’Keeffe, *Dora dhe rrota*, 1933



Georgia O’Keeffe, *Kapësja në formë "O-K"*

shkëmbinj të kuq apo malit Pederal në largësi, të cilit i referohen si mali Saint-Victor i O’Keeffe-it – motivi i preferuar malor i Cézann-it. “Është mali im personal”, - tha njëherë për formacionin të cilin e kishte pikturuar të paktën tridhjetë herë. - “Më përket mua. Zoti më tha se nëse e pikturoja mjaftueshëm, mund ta kisha”. Bleu një pronë të dytë në New Mexico, një *hacienda* historike në qytetin e Abiquiú më 1945, por O’Keeffe nuk do të lihej për shumë gjatë e veçuar në shkretëtirë. Vitin e ardhshëm, u bë gruaja e parë me një retrospektivë në Museum of Modern Art të Nju-Jorkut dhe u kthye në qytet për hapjen. Ishte një “ekspozitë e lavdishme. Një mrekulli”, - siç tha Stieglitz.

Më vonë në atë vit, Stieglitz pati një goditje të madhe në tru dhe O’Keeffe shkoi sërish për në Nju-Jork

nga Albuquerque. Pasi ai vdiq, u kthye në shtëpi në New Mexico ku do të qëndronte për 37 vitet e ardhshme të jetës së saj. O’Keeffe nuk po kërkonte një mik tjetër kur iu shfaq Hamilton në derë atë ditë më 1973. “Nuk dëshiroj të jetoj mes shumë njerëzve – më lodhin më shumë se çdo gjë”, - tha.

Gjithsesi, marrëdhënia e tyre lulëzoi për dekada me radhë, për arsye që janë disi misterioze për njerëzit e jashtëm. “U bën shumë shpejt miq të mirë”, - tha Carlsen. - “Ai, duke kuptuar se ajo po plakej, u bë kujdestari i saj. Ndihej i nderuar që kishte mundësinë të kontribuonte në një mënyrë kuptimplotë në jetën e saj. Por kam përshtypjen se kishte shumë admirim mes tyre”. O’Keeffe e mori nën patronazh dhe e ndihmoi të gjente shfaqje në Nju-Jork. Më 1978, pati një ekspozitë te Robert Miller

Gallery. “Warhol dhe Joni Mitchell erdhën te hapja – nuk më besohej!” - tha për “Harper’s Bazaar”.

Më pak se një dekadë më vonë, në mars 1986, O’Keeffe vdiq. I la Hamilton-it shumicën e koleksionit të saj të artit, shtëpinë dhe gjërat personale, një përzgjedhje të së cilës ai më vonë ia dhuroi Georgia O’Keeffe Museum. “Ka qenë një privilegj i vërtetë të jetoja mes këtyre veprave dhe të kujdesesha për to për shumë vite”, - tha Hamilton në një deklaratë. - “Por tani është koha që t’u lejoj të tjerëve mundësinë t’i shijojnë e të mësojnë nga këto thesare. Shpresoj se do të frymëzojnë një brez të ri admiruesish dhe koleksionistësh të O’Keeffe, Stieglitz dhe rrethit të tyre të paimitueshëm, siç më kanë frymëzuar mua për shumë kohë”.

*Marrë nga Sotheby’s Përktheu Enxhi Hudhri*



Georgia O’Keeffe dhe Alfred Stieglitz



# FESTIVALI LETRAR NDËRKOMBËTAR I TË RINJVE

## "TIRANA GATE 2022"

### Fqinjët

Neighbours • Γειτονες • Sosedje • Съседи • Vecinii • Vicini • Сусіди  
Vizinhos • Voisins • Szomszéd • Суседи • Komşular • Соседи • Die Nachbarn

**5 - 6 - 7** tetor 2022

Salla "UNESCO"  
Muzeu Historik Kombëtar

Ceremonia e hapjes - 5 tetor, ora 10:30

